



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA MBROJTJES**  
**PREFEKTI I QARKUT VLORË**  
SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE  
CIVILE DHE KRIZAVE VENDORE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2018

**PLANI I EMERGJENCAVE CIVILE**  
**PËR QARKUN VLORË**

**P R E F E K T I**

\_\_\_\_\_  
**Flamur Mamaj**

## PLANI I EMERGJENCAVE CIVILE PËR QARKUN VLORE

<b>1. KONSIDERATA TË PËRGJITHËSHME</b>	
1.1 Baza ligjore .....	6
1.2 Parathënie .....	6
1.3 Qëllimi, synimet dhe parimet.....	6
1.4 Lidhja me planet e tjerë .....	7
<b>2. MENAZHIMI I EMERGJENCAVE CIVILE</b>	
2.1 Përgjegjësitë në nivel qarku .....	7
2.2 Prefekti i qarkut .....	8
2.3 Drejtuesi i operacionit në qark (DOQ) .....	8
2.3 Drejtuesit në nivel rrethi ( <i>nënprefektët</i> ) .....	8
2.5 Këshilli i Qarkut Vlorë.....	9
2.6 Përgjegjësit në nivel bashkie .....	9
2.7 Komisioni vendor i emergjencave civile (KVEQ) .....	9
<b>3. PARAQITJA E PËRGJITHSHME</b>	
3.1 Gjeografia bazë .....	10
3.2 Përbërja Administrative e Qarkut .....	11
3.3 Pozicioni i QV dhe përshkrime të shkurtra .....	11
3.4 Përshkrim i shkurtër i bregdetit dhe i zonave për rreth .....	11
3.5 Lumenjtë e përrrenjtë .....	14
3.6 Lumenjtë dhe veçoritë e tyre .....	15
3.7 Rezervuarët dhe hidrovorët .....	16
<b>4. RREZIQET E MUNDËSHME</b>	
4.1 Identifikimi i rreziqeve të mundshme .....	18
4.2 Monitorimi dhe mekanizmat aktiv .....	19
4.3 Rolet dhe përgjegjësit.....	19
4.4 Përgjegjësit në nivel qarku.....	19
4.5 Në bashki .....	19
<b>5. TËRMETET</b>	
5.1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga tërmetet .....	20
5.2 Karakteristikat kryesore .....	20
5.3 Faktorë që duhet të merren parasysh në parandalimin dhe lehtësimin .....	21
5.4 Faktorë për tu marrë në konsiderate gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes .....	21
5.5 Faktorët për tu marrë parasysh në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave civile .....	21
5.6 Faktorët për tu marrë parasysh gjatë fazës së rikthimit në gjendjen normale .....	21
<b>6. PËRMBYTJET</b>	
6.1 Vlerësimi i rreziqeve të mundshme nga përmbytjet .....	22
6.2 Një vëmendje zonës së Novoselës .....	23
6.3 Digat dhe rreziqet .....	24
6.4 Karakteristikat bazë të përmbytjeve në rast çarje të digave .....	25
6.5 Faktorët që duhet të merren në konsiderate në lidhje me parandalimin dhe lehtësimin..	26
6.6 Faktorë për tu marrë në konsideratë në fazën e përgatitjes dhe të mbrojtjes .....	27
6.7 Faktorët që duhet të merren parasysh gjatë fazës përgjigjes ndaj emergjencës.....	28
6.8 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë rikthimit në gjendjen normale.....	32

<b>7. BLOKIMET NGA DËBORA RRËSHQITJA E TOKËS</b>	
7.1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga dëbora e madhe .....	33
7.2 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës .....	33
<b>8. ZJARRET NË PYJE</b>	
8.1 Struktura e pyjeve në Qarkun Vlorë .....	34
8.2 Karakteristikat bazë .....	34
8.3 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parandalimit dhe lehtësimit .....	35
8.4 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parapërgatitjes dhe mbrojtjes .....	35
8.5 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së përgjigjes .....	36
8.6 Faktorët për tu marrë në konsideratë gjatë fazës së rikthimit në gjendjen normale .....	36
<b>9. RREZIQET TEKNOLOGJIKE/INDUSTRIALE DHE NDOTJA DETARE</b>	
9.1 Karakteristikat bazë .....	38
9.2 Faktorët për t'u marrë në konsideratë në fazën e parandalimit dhe lehtësimit .....	38
9.3 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parapërgatitjes dhe mbrojtjes .....	39
9.4 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së përgjigjes .....	39
9.5 Faktorët që duhet të merren parasysh në fazën e rikthimit në gjendjen normale .....	39
<b>10. RREZIQET NGA AKTET TERRORISTE DHE TË DHUNSHME</b>	
10.1 Sulmi Terrorist. Karakteristikat bazë .....	39
10.2 Faktorët për t'u marre parasysh gjatë fazës së parandalimit dhe lehtësimit .....	40
10.3 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së përgatitjes dhe të mbrojtjes .....	40
10.4 Faktorët për t'u marre në konsideratë gjatë fazës së përgjigjes .....	40
10.5 Faktorët për t'u marre parasysh gjatë rikthimit në gjendjen normale .....	40
<b>11. PËRGATITJA E STRUKTURAVE/TRAJNIMI</b>	
11.1 Parathënie .....	41
11.2 Qëllimi i programit të trajnimit të emergjencave civile .....	41
11.3 Planet e emergjencave dhe testimi i tyre .....	41
11.4 Metodologjia e trajnimit dhe grupet përfituese .....	41
11.5 Stërvitjet në tryezë dhe stërvitjet në terren.....	41
<b>12. PËRGJIGJA</b>	
12.1 Raportimi i situatave të emergjencës civile .....	42
12.2 Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së përgjigjes.....	43
12.3 Shpërndarja transmetimi i informacionit publik.....	44
12.4 Doganat emigracioni dhe karantina .....	45
12.5 Çështjet financiare .....	46
12.6 Raportimet dhe vlerësimet.....	47
<b>13. BAZA LIGJORE, FUNKSIONET DHE DETYRAT E INSTITUCIONEVE</b>	
13.1 Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit .....	49
13.2 Reparti Ushtarak Nr. 5010 Bunavi dhe D2D Vlorë .....	50
13.3 Institucionet shëndetësore në qark (DSHP, DSILP, Spitali Rajonal Vlorë) .....	50
13.4 Drejtoria e policisë së qarkut dhe reparti i policisë “Delta Forca” .....	51
13.5 Inspektorati rajonal i mjedisit .....	52
13.6 Inspektorati mjedisor në qark .....	53
13.7 Drejtoria rajonale e rrugëve .....	53
13.8 OSShE (Degët e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes) .....	54
13.9 Drejtoria e Ujësjellës – Kanalizimeve .....	54

13.10 Drejtoria Rajonale e Arsimit + Universiteti “Ismail Qemali” .....	55
13.11 Rajonale e Punësimit + Drejtoria e Përkrahjes Sociale .....	55
13.12 Drejtoria Rajonale e Doganave dhe Drejtoria tatimeve .....	56
13.13 Drejtoria e Tatimeve + Dogana përgjigjen për:.....	57
13.14 Drejtoria e Monumenteve të Kulturës .....	57
13.15 Dhoma e tregtisë .....	57
13.16 Dega Kryqit të Kuq Shqiptar.....	57
14. STRUKTURAT E GADISHMERISE DHE INFORMACIONET	
14.1 Organizimi dhe funksionimi i strukturave të gatishmërisë për emergjencat .....	57
14.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të gatishmërisë për emergjencat .....	58
14.3 Shërbimi i emergjencave civile në qark .....	58
15. STRUKTURAT BAZË OPERATIVE NE NIVEL QARKU MONITORUESE, VEPRUESE AKTIVE, VEPRUESE MBESITETESE	
a) Struktura monitoruese e njoftuese.....	58
b) Struktura vepruese aktive .....	58
Model kërkese .....	59
Raporti i njoftimit të parë .....	60
Raporti i të dhënëve të para për fatkeqësinë.....	61
<b>Shtojca A</b>	
Kapacitetet njerëzore dhe logjistike të institucioneve për përballim të Em:Civ .....	62
Kapacite njerëzore dhe logjistike të Rrethit Delvinë .....	63
Kapacite njerëzore dhe logjistike të Rrethit Sarandë .....	64
Kapacite njerëzore dhe logjistike të Rrethit Vlorë .....	65
Kapacite për mbrojtjen Detare .....	66
Komisioni i Planifikimit të Emergjencave Civile .....	67
Lista e institucioneve të Qarkut Vlorë .....	68
Lista e objekteve sensitiv .....	68
Lista e institucioneve të Qarkut Vlorë .....	69
Lista e kontakteve të për situata emergjencash .....	70
Lista e Kryetarëve të Bashkive.....	71
Lista e Specialitëve të Emergjencave Civile në Bashki .....	72
Komisioni i Planifikimit të Emergjencave Civile .....	74
Pikat e dobëta të Qarkut Vlorë në lidhje me Emergjencave Civile .....	75
Të dhëna për Bashkitë e Qarkut Vlorë .....	76
Praktika e monitorimit dhe veprimit në reshjet e 1- 3 Dhjetor 2017 .....	78
Mjete të transportit të mallrave, mjete gërmese, ngritëse, etj për raste emergjencash .....	79
Të dhëna të rezervuarve të Q.V. ....	81
Udhëzime dhe ligje për Emergjencat Civile .....	83
Lista e shkurtimeve .....	85
Shënimet.....	86
Përpiluesit .....	87

**Shtojca B (lidhje e veçantë)**

Ligje vendime udhëzime për Emergjencat Civile

Lista e objekteve sensitiv

Lista e monitoruesve të digave dhe pritave

Segmente rrugor në vëmendje

Lista e fshatrave sipas ndarjes së vitit 2015

Harta e ndarjes Administrative të Qarkut Vlorë

Harta e zonave të rrezikuara nga zjarri dhe rrugët

Harta e zjarreve 2017

Harta e objekteve sensitiv

Harta e zonave me rrezik shkarje

Harta e rrjetit rrugor dhe ndërtimit të kampingjeve

Harta: Dinamika e ujërave të Lumit Vjosë në zonën Novoselë

Harta e lagijes së zonës Novoselë (nga reshjet e 30 Nëntor – 3 Dhjetor 2017)

Harta e dëmeve në infrastrukturë

Harta e kilometrazheve

# PLANI I EMERGJENCAVE CIVILE PËR QARKUN VLORË

## 1. KONSIDERATA TË PËRGJITHËSHME

### 1.1 Baza ligjore

Në mbështetje të Ligjit nr. 107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, të Ligjit Nr. 8726, dt. 26. 04. 2001 “Për emergjencat civile”, përditësuar me Ligjin nr. 10137 datë 11.5.2009 dhe në zbatim të, Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, miratuar me VKM Nr. 835, datë 3 dhjetor 2004, zbatimit të rekomandimeve të ekspertëve të **Projektit PRO NEWS**, hartohet: **Plani për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile për Qarkun Vlorë.**

### 1.2 Parathënie

*Plani i Emergjencave Civile për Qarkun Vlorë (PQEC), është dokumenti kryesor që realizon bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjitha institucioneve dhe strukturave që veprojnë në qark, për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile.*

PQEC është i zbatueshëm për të gjitha fazat e ciklit të emergjencave, për parapërgatitjen, përgjigjen, rikthimin në gjendje normale dhe lehtësimin e pasojave në popullsi.

Sipas studimeve të bëra, për vlerësimin e rreziqeve në Shqipëri, Qarku i Vlorës vlerësohet si një rajon i mundshëm për një numër të konsiderueshëm fatkeqësish natyrore dhe të tjera, që mund të vijnë nga veprimtaria njerëzore. Rreziku më i madh në qark nga fatkeqësitë natyrore mund të vijnë nga tërmete të rënd por dhe nga rrëshqitjet e tokës, përmytjet, veprimet terroriste dhe me pak nga reshjet e dëborës.

Qarku i Vlorës si një rajon që laget nga deti Adriatik dhe Jon është plotësisht i ekspozuar dhe nga fatkeqësitë, që mund të shkaktohen nga veprimtaria njerëzore në det duke shkaktuar ndotje të ujit dhe të vijës bregdetare.

Qarku i Vlorës si rajon me kufij tokësor dhe detar, përkatësisht me Greqinë dhe Italinë, është vend i mundshëm për ardhje të emigrantësh nga vendet e lindjes. Në këto kushte duhen marrë në konsideratë në PQEC.

Shteti Shqiptar si anëtar i NATO<sup>s</sup> dhe kontribuues në misionet paqeruajtës në disa shtete, është në listën për sulme terroriste.

### 1.3 Qëllimi, synimet dhe parimet

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një dokumenti të rëndësishëm në mbështetje të Ligjit Nr. 8756, datë 26.04.2001 “Për emergjencat civile”, përditësuar me Ligjin nr. 10137 datë 11.5.2009, të dispozitave ligjore që kanë lidhje të drejtpërdrejte ose të tërthorte me emergjencat civile si dhe për zbatimin e kërkesave të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile.

Nisur nga realitetet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve dhe strukturave shtetërore si dhe të shoqërisë civile që veprojnë në qark, me këtë plan synohet:

- ❖ Të parandalohet, të lehtësohet dhe të riaftësohet gjendja nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgimin kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile.
- ❖ Të sigurohen kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private për veprimtarit ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit për jetën e njerëzve, për gjënë e gjalle, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin, ndaj efekteve të një emergjence civile.

❖ Të garantohet përdorimi i të gjitha burimeve të mundshme në qark dhe mbështetja e qeverisë me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

❖ Të koordinohen dhe bashkërendohen detyrat e OQV, me institucionet shtetërore, shërbimin e emergjencës, OJF dhe shërbimet vullnetare për përballimin e emergjencave civile.

Procesi i hartimit të këtij Plani për emergjencat civile është udhëhequr nga disa parime të cilat do të jenë të njëjta edhe në procesin e zbatimit të tij. Plani pasqyron kuadrin ligjor ekzistues i cili e bën të mundshëm zbatimin e tij.

• Plani përfshinë të dhëna e informacione nga të gjitha institucionet në një mënyrë të përshtatshme.

• Bashkëpunimi dhe bashkërendimi përbëjnë elementet kryesor që përshkojnë planin për të bërë të mundur shfrytëzimin e të gjitha mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese.

• Plani inkurajon iniciativa dhe nuk shndërrohet në një dokument (akt) strikt për strukturat dhe njerëzit që duhet të veprojnë.

• Plani do të mbetet një punë në progres për të qenë i përshtatshëm dhe i zbatueshëm në çdo kohë.

#### **1.4 Lidhja me planet e tjerë**

Plani në nivel qarku për emergjencat civile është dokument harmonizues, gjithëpërfshirës, i cili mbledh se bashku të gjitha institucionet dhe strukturat që veprojnë në qark. Qeverisja vendore dhe institucionet e ndryshme kanë hartuar dhe do të hartojnë planet e tyre të emergjencave civile. PQEC nuk zëvendëson planet sektorial por bën harmonizimin dhe bashkërendimin e tyre.

## **2. MENAZHIMI I EMERGJENCAVE CIVILE**

### **2.1 Përgjegjësitë në nivel qarku.**

#### **2.1.1 Prefekti i qarkut**

• **Prefekti në rolin e kryetarit të komisionit të emergjencave civile, është përgjegjës për planizimin e emergjencave në shkallë qarku, duke koordinuar veprimet e të gjitha strukturat të cilat janë përfshirë në planin e emergjencave në nivel qarkut.**

• **Prefekti kërkon shpalljen e gjendjes së Emergjencave Civile në një pjesë ose në të gjithë territorin e qarkut.**

• Në çdo rast Prefekti, nëpërmjet specialistëve të Emergjencave Civile, mban kontakt me Qendrën Kombëtare Operacionale të EmC si dhe informon, bashkëpunon dhe koordinon veprimet me Ministrinë e Mbrojtjes dhe në vartësi të situatës komunikon me Kryeministrin.

• Në të gjitha rastet kur situata emergjente rëndohet, Prefekti urdhëron kalimin në gjendje gatishmërie të strukturave qendrore, operacionale, në nivel lokal.

• Monitoron dhe menaxhon situatën emergjente nëpërmjet koordinimit të strukturave qendrore të pranishme në nivel qarku, të cilat janë përfshirë në planet e emergjencave të qarkut.

• Thërret komisionin e emergjencave civile në qark (KECQ).

• Kërkon ndihmë kur situata e emergjencës civile është përtej mundësive apo kapaciteteve të qarkut, duke kërkuar të shpallet gjendja e emergjencës civile në një pjesë ose në të gjithë territorin e qarkut.

• Cakton drejtuesin e operacionit për përballimin e emergjencës civile brenda qarkut.

### 2.1.2 Drejtuesi i operacionit në qark (DOQ)

Në situatën e emergjencës civile, burimet materiale dhe njerëzore të listuara në planet e emergjencave të qarkut vendosen nën autoritetin e drejtuesit të operacionit në qark (DOQ).

Ai/Ajo bëhet përgjegjës për menaxhimin e situatës së emergjencës civile në qark dhe kryen këto detyra:

- Vepron sipas udhëzimeve që merr nga komisioni i emergjencave në qark dhe raporton rast pas rasti dhe sa herë i kërkohet nga ky komision.
- Bashkërendon strukturat qendrore në nivel lokal, si dhe strukturat e tjera qendrore ose ndërkombëtare që vijnë në ndihme.
- Mban lidhje të rregullta dhe kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e tjerë të operacioneve në nivel vendor dhe të qarqeve fqinjë, (Fier dhe Gjirokastër), informon dhe kërkon asistencë nga KPPECQ-ja dhe DQO-ja.


### 2.1.3 Drejtuesit në nivel rrethi (nënprefektët)

Nënprefektët në rrethet Sarandë dhe Delvinë kanë këto përgjegjësi dhe detyra:

Informojnë Prefektin për mundësinë e ndodhjes apo ekzistencës së një situatë emergjente në rrethin përkatës.

Në bashkëpunim me drejtuesit e forcave operacionale, bashkërendon përgjigjen dhe kërkon ndihme për ndërhyrje të strukturave të tjera jashtë territorit të rrethit.

Raporton tek prefekti tek KPPECQ<sup>ja</sup> për situatën e emergjencave dhe aktivitetet në përgjigje të saj, bashkërendon aktivitetet e forcave që vijnë në ndihme.





#### 2.1.4 Këshilli i Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë është i përfshirë në menaxhimin e emergjencave civile duke bashkëpunuar me administratën e Prefektit, KPPECQ- në si dhe me autoritetet e bashkive. Në raste të situatave të emergjencave civile, Këshilli i Qarkut kryen këto detyra:

- Angazhon administratën dhe strukturat e tij aktive në procesin e vlerësimit të dëmeve të shkaktuara dhe të nevojave, si dhe në përballimin e situatës emergjente.
- Në bashkëpunim me strukturat e tjera lokale, përcakton vendet për krijimin e vendbanimeve të përkohshme dhe pikat e shpërndarjes, terrenet për varreza masive dhe nevojat e tjera të mundshme.

#### 2.1.5 Përgjegjësit në nivel bashkie


Bashkitë në qark kanë përgjegjësi për përgatitjen, planifikimin dhe operacionet përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin dhe freskojnë periodikisht.

Çdo bashki krijon dhe mbajnë një sistem të:

- Njoftimit të hershëm dhe të informimit të strukturave kyç;
- Alarmit dhe evakuimit të popullsisë;
- Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për tu përgjigjur në raste të emergjencave civile.
- Ndërmarrin dhe administrojnë aktivitetet e rehabilitimit për zonën e prekur nga emergjenca.

#### 2.1.6 Komisioni vendor i emergjencave civile (KVEQ) është përgjegjës për:

- ❖ Hartimin e masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile.
- ❖ Sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta.
- ❖ Vlerësimin e dëmeve dhe nevojave.
- ❖ Mbajtjen e kushteve higjienike duke siguruar furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesen për viktimat.
- ❖ Bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim shpëtimit dhe të vullnetarëve.
- ❖ Çështje të tjera për qëllimin përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.



### 3. PARAQITJA E PËRGJITHSHME

#### 3.1 Gjeografia bazë

#### 3.2 Përbërja Administrative e Qarkut

Qarku Vlorë, përbëhet nga rrethet; Vlorë, Sarandë dhe Delvinë dhe ka 192 fshatra në 7 bashki. Qarku Vlorë është rregulluar sipas ligjit 8652, datë 31/07/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". QV përfshin rrethet: Vlorë, Sarandë dhe Delvinë. Gjithë ky territor, me sipërfaqe 2706km<sup>2</sup> (shih Gjeografia e QV), përfshin 199 fshatra në 7 bashki.

Të dhëna të Qarkut Vlorë (2011)

Vlerësime sipas njësive	Sip. (km <sup>2</sup> )	Popullsia residente (INSTAT 2011)	Dëndësia	Popullsia (Gjendjes Civile)	Familje	Sasia e mbetjeve në vit (Ton)
<b>Totale Qarku Vlorë</b>	<b>2706</b>	<b>175640</b>	<b>65</b>	<b>201986</b>	<b>50961</b>	<b>46545</b>
<b>Bashkia Vlorë</b>	<b>624</b>	<b>104827</b>	<b>168</b>	<b>120551</b>	<b>29953</b>	<b>27779</b>
Vlorë	21	79513	3786	91440	22755	21071
Orikum	343	5503	16	6328	1582	1458
Qëndër	84	7621	91	8764	2134	2020
Novoselë	137	8209	60	9440	2374	2175
Shushicë	39	3981	102	4578	1108	1055
<b>Bashkia Selencë</b>	<b>567</b>	<b>16396</b>	<b>29</b>	<b>18855</b>	<b>4333</b>	<b>4345</b>
Selenicë	12	2235	186	2570	683	592
Armen	65	2965	46	3410	777	786
Vllahinë	112	3111	28	3578	798	824
Sevaster	91	1720	19	1978	412	456
Kotë	131	3516	27	4043	911	932
Brataj	156	2849	18	3276	752	755
<b>Bashkia Himarë</b>	<b>539</b>	<b>7818</b>	<b>15</b>	<b>8991</b>	<b>2674</b>	<b>2072</b>
Himarë	187	2822	15	3245	1052	748
Hor-Vranisht	234	2080	9	2392	616	551
Lukovë	118	2916	25	3353	1006	773
<b>Bashkia Sarandë</b>	<b>87</b>	<b>20227</b>	<b>232</b>	<b>23261</b>	<b>5952</b>	<b>5360</b>
Sarandë	28	17233	615	19818	5129	4567
Ksamil	59	2994	51	3443	823	793
<b>Bashkia Konispol</b>	<b>677</b>	<b>8245</b>	<b>12</b>	<b>9482</b>	<b>2199</b>	<b>2185</b>
Konispol	41	2123	52	2441	593	563
Xarrë	67	4263	64	4902	1055	1130
Markat	74	1859	25	2138	551	493
<b>Bashkia Finiq</b>	<b>495</b>	<b>10529</b>	<b>21</b>	<b>12108</b>	<b>3579</b>	<b>2790</b>
Finiq	25	1333	53	1533	376	353
Livadhja	178	1165	7	1340	447	309
Dhiver	112	1396	12	1605	620	370
Aliko	71	3849	54	4426	1262	1020
Mesapotam	109	2786	26	3204	874	738
<b>Bashkia Delvinë</b>	<b>215</b>	<b>7598</b>	<b>35</b>	<b>8738</b>	<b>2271</b>	<b>2013</b>
Delvinë	51	5754	113	6617	1694	1525
Vergo	164	1844	11	2121	577	489

## Të dhëna të tjera Qarkut Vlorë

Sipërfaqja e QV	3147 km <sup>2</sup>
Kufij tokësor të QV	54 km
Kufij lumore të QV	75 km
Gjatësi e bregdetit të QV	244 km
Rrethe e vende kufizuese	Fier, Mallakastër, Tepelenë, Gjirokastrë, Greqi
Largësia më e madhe V – J (Rrjedhja e Vjosës- Konispol)	140 km
Largësia më e madhe L – P (Sazan –Shkoze)	43 km
Gjerësi veriore	19° 29' 04 "
Gjerësi jugore	40° 28' 56"

### 3.3 Pozicioni i QV dhe përshkrime të shkurtra

QV (me rrethet Vlorë, Sarandë, Delvinë) shtrihet në pjesën jugperëndimore të vendit dhe laget nga Deti Adriatik dhe Deti Jon. Qendër e Qarkut është Vlorë, qendër industriale, tregtare dhe e ndërlidhjeve të shumta .

Sipërfaqja e territorit të QV është 3147 km<sup>2</sup>, për nga madhësia renditet i *treti* pas atij të Shkodrës dhe atij të Korçës. Dendësia mesatare në rrethin e Vlorës është 120,2 banorë/km<sup>2</sup>. Disa rrethe, si Durrësi, Tirana e Kuçova, arrijnë në 400 banorë/km<sup>2</sup>

Gjatësia e kufijve të rrethit të Vlorës është 273 km, nga të cilët 129 km janë kufij tokësore dhe 244 ujor. Në territorin e rrethit kalon Lumi i Vjosës, i gjatë 272 km. Në QV gjendet një nga majat me të larta të vendit, Mali i Çikës, me 2045 m lartësi.

Në një klasifikim të shpejtë mund të themi se ky rajon është, kryesisht, kodrinor-malor, me fusha e lugina që i krijojnë mundësi popullsisë së këtij Qarku të merret me bujqësi ose blegtori.

Në këtë rajon ndodhen vargmalet me emër dhe të krahasueshëm me vargmalet e tjerë të vendit, si ai i Kurveleshit, i Shëndellisë dhe i Malit të Gjerë.

Po në këtë rajon ndodhet dhe fusha e Vlorës (*Myzeqeja e Vogël*).

### 3.4 Përshkrim i shkurtër i bregdetit dhe i zonave për rreth

**Gjiri i Vlorës.** Rajoni i gjirit të Vlorës shtrihet në pjesën jugperëndimore të vendit tonë dhe me sakte në kufirin jugor të Ultësirës Perëndimore. Për këtë shkak, në studimin tonë kufijtë e zonës do të zhvendosen pak më në veri, duke përfshirë edhe lagunën e Nartës. Ndërsa kufijtë gjeografike të kësaj zonë fillojnë në veri, në Lagunën e Nartës, në jug shkojnë deri në Qafën e Llogorasë. Në pjesën perëndimore zona kufizohet nga deti (Adriatik dhe Jon), ndërsa kufiri lindor është vargu malor Çikë-Llogora. Brenda kësaj hapësirë Gjiri i Vlorës ka një shtrirje maksimale veri-jug prej 40 km dhe lindje-perëndim prej 21 km. Sipërfaqja e përgjithshme është 840 km<sup>2</sup>, pra 5,47% e sipërfaqes së gjithë vendit.

Në pjesën e poshtme të bregdetit gjenden dy plazhe të mëdhenj (*Plazhi i Vjetër dhe Plazhi i Ri*), që ndahen mes tyre nga porti i qytetit. Plazhet në veri të Gjirit janë me rërë të hollë dhe të dendur. Si pjesë e Gjirit të Vlorës, këto plazhe dhe gjithë vija bregdetare e Gjirit të Vlorës është shumë e ndjeshme ndaj ndotjeve. Nisur nga ky fakt është krijuar Agjencia e Mbrojtjes së Bregdetit, e cila monitoron në vazhdimësi bregun dhe pastërtinë e ujit në gji. Shpesh ka pasur aksidente detare me pasoj ndotjen e vijës bregdetare, si ajo e majit 2016, krijuar nga një difekt në një anije në kompleksin e petroliferës.

**Fusha e Myzeqesë dhe Laguna e Nartës.** Fusha e Myzeqesë shtrihet në veri të rrethit të Vlorës, duke filluar nga bregu i majte i Vjosës deri në afërsi të qytetit të Vlorës. Kjo fushë është formuar si rrjedhojë e grumbullimit të materialit aluvional. Kufijtë natyrorë të fushës janë: Lumi i Vjosës në veri, rruga Fier-Vlorë në lindje, Laguna e Nartës në jug dhe deti në perëndim. Lartësia e fushës shkon nga 0-30 m mbi nivelin e detit, por nuk mungojnë edhe kodra të shpërndara aty - këtu. Në fushë bën pjesë edhe zona e rrjedhjes së poshtme të Vjosës, që është zona më e gjerë dhe më e ulët e gjithë rrjedhjes së lumit, e njohur edhe si Ultësira e Novoselës.

Bregdeti i Lagunës së Nartës është zona më e ulët e kësaj fushe. Lartësitë më të mëdha të fushës janë katër. Klima e zonës, për shkak të afërsisë me detin, është mjaft e butë. Për shkak të lartësisë së ultë të të gjithë kësaj zone, ka projekte të veçanta për manazhimin e situatave në rast përmbytjesh.

**Gadishulli i Karaburunit,** është gadishulli më i madh i vendit. Gjendet midis Gjirit të Vlorës dhe kanalit të Otrantos, me një gjatësi prej 15 km. Ka pak bimësi, por është i pasur me kullota. Pjesa më e ngushtë dhe më e ulët e gadishullit është pllaja e Ravenës, një qendër e njohur blegtorale. Në pjesën më të lartë të gadishullit dallohen tri maja: Maja e Kores (826 m), Maja e Dafinës (732 m) dhe Maja e Ilqes (687 m). Gadishulli formon një hark të madh, të butë që i ngjan gishtit të madh të shtrire "të dorës". Ana perëndimore është shkëmbore dhe e copëzuar. Gadishulli i Karaburunit është në pjesën më të madhe me pyje e shkurre, që shërbejnë për kullosje e bagëtive dhen dhe dhi. Në këto kushte shpesh provokohen zjarre për qëllim kthimin e zonën në kullota më të përshtatshme për bagëtitë, kryesisht nga Fshati Dukat. Fikja e zjarreve është shumë e vështir për shkak të mungesës së plotë të rrugëve në vatrat e zjarrit, si dhe distancës së madhe.

**Ishulli i Sazanit.** Ishulli i Sazanit është i vetmi i vendit tonë; ka një sipërfaqe prej 6.5 km<sup>2</sup>, në formën e një rombi. Relievi është malor, dhe është i formuar nga dy maja të rrumbullakëta, që ndahen nga një ulje në të cilën është ndërtuar qendra të banuar. Ishulli është i veshur me shkurre dhe pisha. Është i pa populluar. Rreziku më i madh në ishull është prania e

municioneve të shumtë të braktisur edhe pse herë pas here ka pasur projekte për grumbullimin e tyre. Rënia e zjarrit në ishull është fenomen i rrallë por jo i pamundur. Për fikjen e tyre angazhohen forca të bazës së Pashalimanit.

**Riviera e Himarës (Bregu i Detit).** Pjesa e bregdetit Jonian, që shkon nga kepi i Gjuhëzës deri në kepin e Stillos, e gjatë mbi 100 km, formon një krahinë me vete, "Rivierën", që dallohet për klimën dhe bimësinë e saj. Zona që shkon nga Qeparoi deri në fshatin e Palasës quhet Riviera e Himarës, ose Bregu i Sipërm, dhe është zona më e populluar e gjithë Rivierës. Riviera e Himarës, në veri-verilindje kufizohet me luginën e Shushicës dhe fushën e Dukatit. Ndahet prej tyre nga Qafa e Llogorasë dhe Mali i Çikës. Relievi malor shumë i copëzuar, gërryerjet e fuqishme, përrrenjtë e thellë, si ai i Palasës, Gjipes, Vishës, Pilurit e Kudhësit, plazhet e shumta dhe gjinjtë e vegjël, fshatrat, peizazhi gjithnjë i gjelbër formojnë kornizën e mrekullueshme të Rivierës së Himarës. Për shkak të "murit" të maleve që e mbron nga erërat e veriut dhe të lindjes, klima e zonës është më e buta e gjithë Shqipërisë. Veshje e rivierës është në përgjithësi me shkurre, të cilat shpesh nga veprime të pandërgjegjshme ose interesa për ndërtime digjen. Në përgjithësi ka rrugë dhe mund të arrijnë zjarrfikëset.

**Gjiri i Sarandës.** Është një gji në detin Jon, midis kepit të Dentes, në jug, dhe kepit të Paladhes, në veriperëndim, me një largësi rreth 7.5 km e gjerësi maksimale 1 km. Është një gji përgjithësisht i thellë, me bregun e lartë e shkëmbor. Në pjesën jugore të gjirit, në veri të kepit të Dentes, gjendet kanali i Çukës. Temperatura e ujit, nga 13.2 C°, në shkurt, arrin në 24.3 C°, në gusht. Në pjesën veriore shtrihet qyteti i Sarandës. Është zonë që do kujdes të veçantë për mbrojtjen nga ndotjet detare.

**Ishujt e Ksamilit.** Janë katër ishuj të vegjël shkëmbore pranë bregut të Ksamilit, në jug të qytetit të Sarandës, me një sipërfaqe prej 8.9 ha. Ishulli më i madh gjendet 60 m larg bregut, me një sipërfaqe prej 5 ha. Ishulli tjetër ndodhet 500 m nga toka, me një sipërfaqe prej 1.3 ha, dhe në të gjendet edhe pika më e lartë prej 24 m. Dy ishujt e tjerë (1 ha dhe 0.8 ha) janë më tepër shkëmbinj të dalë mbi ujë, sesa ishuj të mirëfilltë. Brigjet e ishujve janë të copëzuar, me lartësira të vogla dhe të mbuluara nga një bimësi e dendur shkurresh mesdhetare. Mbrojtja nga zjarret në këta ishuj i janë lënë në përgjegjësi disa subjekteve tregtar që ushtrojnë aktivitetin në dy nga ishujt.

**Kepi i Stillos.** Është kepi më jugor i bregdetit shqiptar. Hyn në det 1.3 km, në drejtim të jugperëndimit. Kepi është malor, me lartësinë më të madhe 269 m, me bregun e copëzuar e shkëmbor. Deti është i thellë, që në metrat e parë pas bregut. Një rrugë këmbësorësh e lidh me kepin e Vrinës. Rreth 1 km në juglindje të kepit, ndodhet ishulli i vogël i Stillos me një bimësi të dendur shkurresh mesdhetare. Në veri të gjirit me të njëjtin emër derdhet Lumi i Pavllës. Është evidentuar si një nga zonat e mrekullueshme të QV. Gëzon status të veçantë. Ka një veshje me shkurre relativisht të larta, me rrugë të mundshme për fikjen e zjarrit nëse sinjali merret shpejt.

**Parku i Llogorasë.** Është zonë e veshur me pisha dhe lloje të tjera drurësh, bimësie dhe faune të pasur. Zona është e mbrojtur me ligj dhe ka struktura të emëruara për monitorimin e tij. Sidoqoftë përbën zonën më delikate për mbrojtjen nga zjarri. Rënia e zjarrit në këtë zonë përbën një kërcënim serioz dhe për shkak të vështirësive për fikjen e tij, duke qenë se mungojnë rrugët për mbrojtjen e vatra e zjarrit si mungesës së brezave ndarës. Në periudhën e verës funksionojnë struktura administrative shtesë për mbrojtjen nga zjarret.

**Sistemi kodrinor.** Në zonën e QV sistemi kodrinor është vazhdim i sistemit malor apo fushor dhe përfaqëson një hapësirë për kultivimin e ullinjve, hardhisë dhe agrumeve. Shumë kodra si në lumin e Vlorës, apo dhe gjatë bregut e fshatra që ndodhen në kodra rrëzë maleve janë tipike për kultivimin e frutave si dhe rritjen e të dhirtave e të leshtave. Sistemet kodrinore janë të veshura me shkurre. Shpesh vihen zjarre të qëllimshme nga barinjët për ti bërë ato të shfrytëzueshme për kullota.

**Topalltia.** Fusha e Topalltisë shtrihet në lindje të fushës së Myzeqesë, përtej rrugës Fier-Vlorë. Zona ndahet në dy pjesë: në pjesën perëndimore të kësaj zonë, në vazhdim të kodrave të Shushicës shtrihet vargu kodrinor Babicë-Qafe e Topit-Kërkove-Trevëllazër-Risili. Është veshur në me drufrutorë dhe ullinj. Me qëllim djegien e ferrave ose motiveve të tjera në verë ka pasur vënie zjarri të cilët shpesh kanë dal jashtë kontrollit.

**Vargu bregdetar dhe Riviera.** Vargmali bregdetar që zgjatet nga Qafa e Llogorasë deri në ishullin e Sazanit në drejtimin veriperëndim-juglindje, shtrihet midis fushës së Dukatit, gjirit të Vlorës dhe detit Jon, lartësia e saj shkon nga 700 në 1500 m. Ky vargmal është i përbërë nga malësia e Rimit dhe gadishulli i Karaburunit. Është i veshur me shkurre, të cilat shpesh digjen nga barinjët për hapje kullotash.

**Fusha e Vurgut (0- 30 m lartësi nga niveli i detit)** është më e madhja e jugut të QV dhe vendit. Sipërfaqja e përgjithshme është 6000 Ha. (së bashku me vargun e kodrave të cilat mbillen është 9000 Ha.). Pozicioni gjeografik i saj është midis liqenit të Butrintit dhe Kodrave të Sopikut, si dhe malit të Finiqit. Gjithë fusha mund të vihet nën ujë në saj të sistemit ujëtës. Aktualisht shumë nga këto kanale janë amortizuar dhe jo vetëm nuk vlejnë si vija vaditje ose kullimi por po futen në listën e objekteve në të emergjencës për erozionin dhe përmbytjet e mundshme.

**Bimësia.** Bimësia në QV është e shumëllojshme për shkak të formave të ndryshme të relievit, të klimës dhe të mikroklimës. Gama e gjerë e bimësisë duket edhe nga fakti që nga 208 lloje drurësh në të gjithë vendin, me tepër se 150 i gjejmë në

rrethin e Vlorës. Pyjet zëne reth 20 % të sipërfaqes se përgjithshme të rrethit. për shkak të larmisë se formave të relievit e të mikroklimave bimësia është e copëzuar e ndahet në brezat e mëposhtëm:

**Brezi i shkurreve mesdhetare.** Është zona me e ulet që shkon nga 50 - 800 m mbi nivelin e detit. Shtrirja vertikale varet edhe nga këndi i shpatave. Në këndet nga jugu dhe perëndimi, që janë të ekspozuar drejt detit, brezi i shkurreve arrin deri në 800 m, ndërsa në ata nga veriu dhe lindja deri në 600m. Nga drurët, me i rëndësishmi i kësaj zonë është valanidhi, që e gjejmë në shpatet e maleve të zonës se Himarës, Lukovës, Nivicë. Në zonën e shkurreve mesdhetare gjejmë pishën e bute, atë të egër dhe pishën e malit. Brezi i shkurreve mesdhetare përzihet shpesh me brezin e dushqeve, dhe disa herë është e vështirë të dallosh kufirin e sakte mes tyre.

**Brezi i dushqeve.** Fillon në pjesën e sipërme të shkurreve mesdhetare e në vende të ndryshme përzihet me to. Drurët përfaqësues janë lloje të ndryshme dushqesh. Ky brez fillon nga 500 m mbi nivelin e detit, në disa lugina zbret deri në 50 m mbi nivelin e detit. Në përgjithësi për shkak të shpyllëzimeve për arsye të ndryshme, në disa zona dushqet po zhduken, si në Selenice dhe Sevaster, Pylli Syri i Kaltër, Pylli i Butrintit

**Brezi i pishave.** Përfaqësohet vetëm nga pisha e zezë dhe fillon nga 600 m lartësi në zonën e Llogorasë për të arritur në 1500 m në shpatet perëndimore dhe jugore të maleve të Çikës, Llogorasë, Qorres, Lungares, Cipinit. Drurët kryesore janë pisha e zeze, bredhi e në zona me të larta lloje të tjerë pishash.

**Brezi i kullotave alpine.** Kjo zonë fillon mbi brezin e pishave dhe është e rëndësishme mbi të gjitha për blegtorinë.

**Fauna.** QV dallohet edhe për pasurinë e botës shtazore, si rrjedhoje e larmisë se bimësisë, të klimës dhe të pasurive ujore. Kafshët i gjejmë në gjithë shtrirjen e bimësisë, që nga shkurret mesdhetare deri në kullotat alpine. Në brezin e shkurreve është i përhapur lepuri, veçanërisht në zonat kodrinore. Gjuhet gjatë sezonit të gjuetisë. Dhelpra është e përhapur pranë qendrave të banuara të zonave kodrinore dhe gjuhet mbi të gjitha për lëkuren e saj. Cakalli është i përhapur në pyllin e Pisha Poros. Nga zogjtë mund të përmendim rosën e egër, që e gjejmë në deltën e Vjosës, në Pisha-Poro dhe gjatë dimrit në lagunën e Nartës e të Pasha Limanit. Një lloj që e gjejmë vetëm në rrethin e Vlorës është rosa e përhimet. Në lagunën e Nartës ndeshet edhe pelikani.

Në zonën e dushqeve gjejmë derrin e egër, megjithatë jo shumë të përhapur. për këtë arsye gjuetia e tij është e kufizuar. Lepuri dhe dhelpra janë të përhapur në gjithë zonën e dushqeve dhe veçanërisht pranë zonave të banuara. Në zonën e pishave jeton ujku, ketri, dhelpra dhe lepuri. Nga zogjtë, më të përhapurit janë gjeli dhe pula e egër, bilbili, qukapiku, etj. Mjaft e pasur është fauna detare. Kujtojmë disa lloje që kanë edhe vlerë ekonomike si sardelet, merlucin, barbutin, ngjalën.

**Klima.** QV bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare, me dimër të butë e të lagësht dhe verë të thatë. Në përgjithësi zona e QV ku regjimi i presionit të ulet zgjat pak, periudha me kohe të mirë është me e gjatë se në pjesët e tjera të vendit. Faktorët që përcaktojnë klimën e kësaj zonë janë:

1. Pozicioni gjeografik dhe në mënyre të veçante afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimës
2. Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.
4. Larmia e formave të relievit dhe drejtimi i përcaktuar mirë i vargmaleve dhe luginave.

#### Disa të dhëna mesatare për tregues të klimës për Qarkun Vlorë

Rrethi	Reshjet vjet.	Temp. mes.	Ditë me diell	Ditë me shi	Ditë të vranëta
Delvinë	1360 mm	15.2 °C	230	41	94
Sarandë	1532 mm	16.1 °C	230	41	94
Vlorë	1675 mm	16.4 °C	229	44	95

**Temperaturat dhe ndryshimet gjatë vitit.** Temperatura mesatare për Vlorën ndryshon nga 16.1 C° në 17.7 C°. Në QV mungojnë temperaturat e ulëta që regjistrohen në zona të tjera të vendit.

Temperaturat me të ulëta si në të gjithë zonën bregdetare të Shqipërisë regjistrohen gjatë janar - shkurtit.

Temperaturat e Dhjetor 2016 - Janar 2017, arritën në disa zona të banuara -8.5°13. Temperatura të matura në zona malore arritën -12°. Situata e krijuar veçanërisht në sistemin ujësjellës, nxjerr detyrimin e ndryshimit të praktikave projektuese për të parandaluar mungesën e ujit të pijshëm dhe minimizimin e dëmeve në familje. Në një vit mesatarisht kemi shtatë ditë me temperatura nën zero kur në Borsh kemi tre, në Sarandë dy dhe në Gjirokastrë dyzetë e katër. Muaji me ditë me të shumta me këto temperatura është janari (me tre). Në Qafën e Llogorasë arrii temperatura në disa ditë arrii -16°C (Janar 2017).

Vihet re edhe dukuria e diferencës së temperaturave midis Himarës, Vlorës, Borshit, Sarandës dhe zonave më në thellësi (Mali i Gjerë), ku temperaturat janë ato vendeve malore e kodrinore.

**Reshjet.** Sasia mesatare e reshjeve arrin në 1200 mm vit, pjesa me e madhe e të cilëve në nëntor-dhjetor. Në Kuc në këtë periudhë kemi 380 mm shi në krahasim me 404 mm të Alpeve shqiptare. Muajt me të thate janë korriku, gushti dhe shtatori.

Deti dhe format e relievit ndikojnë mjaft në shpërndarjen e reshjeve në rrethin e Vlorës. Luginat e Shushicës, Vjosës, Dukatit e Borshit shërbejnë gjatë gjithë vitit si zona të shkëmbimit klimaterik të zonave të bregdetit me ato në brendësi. Vargmalet që fillojnë në Karaburun dhe shkojnë deri tek Cika, pengojnë masat e ftohta të ajrit që vijnë nga brendësia e ndalojnë ajrin e ngrohte që vjen nga deti, duke ndikuar kështu në krijimin e kushteve të përshtatshme për reshjet në Kurvelesh, Shushice, Dukat etj. Kjo është arsyeja e shirave të bollshme në këto zona në krahasim me zonat e tjera të rrethit. Në zonën detare të qytetit të Vlorës sasia mesatare e reshjeve është 1000 mm/vit, në Himarë 1495 mm/vit, në Dukat 2453 mm/vit, në Orikum 1314 mm/vit. Ndërsa në zonat malore arrin: në Kuc 2670 mm/vit, Llogora 2500 mm/vit, Brataj 2051 mm/vit. Shirat janë të forta e shpesh shkaktojnë përmbytje, veçanërisht gjatë dimrit

Mesatarja e ditëve me lagështi për QV lëviz nga 105-147 ditë. Periudha më e thatë është regjistruar në vitet 1941-1945, ndërsa më e lagëta në 1937-1940. Maksimumi i reshjeve është regjistruar në Kuc me 3287 mm/vit.

**Breshëri.** Shpesh reshjet janë në formë breshëri, që është shumë i dëmshëm për bujqësinë. Me tepër breshëri regjistrohet gjatë pranverës, por nuk përjashtohen edhe stinë të tjera, siç ndodhi në korrik të 1970. Në qytetin e Vlorës mesatarisht kemi 7 ditë me breshër në vit, në Dukat 9 ditë në vit etj.

**Dëbora.** Dëbora është një fenomen jo i zakonshëm në QV nëse përjashtojmë zona të veçanta. Në Rivierë, Orikum, Himarë, Sarandë, dhe në qytetin e Vlorës dëbora është një dukuri shumë e rrallë. Në zonat malore (Çik, Mali i Kudhësit, Llogora dhe zona të tjera malore), ndërsa është një dukuri normale dhe shpesh fillon që në nëntor. Segmenti rrugor Vlorë – Sarandë, shpesh kërcënohet nga dëbora dhe acari. Në dhjetor 2016 – janar 2017, duhej nja angazhim serioz për të mbajtur të hapur dhe kaluar këtë segment pa zinxhir. Temperatura në disa ditë arriti -16°C.

**Erërat.** Pozicioni gjeografik i QV, bën që zona të jetë nën ndikimin e erërave të fuqishme, që janë të ndryshme për nga forca dhe prania gjatë vitit. Erëra të zakonshme janë puhitë detare. Efekti i tyre ndihet me tepër gjatë bregdetit. Gjatë periudhës tetor-mars mbizotërojnë erërat nga lindja, ndërsa gjatë pranverës erërat nga jugu dhe veriperëndimi dhe nga qershori në shtator ato nga veriperëndimi e perëndimi. Shpejtësia mesatare e erërave gjatë vitit është 2, 5 m/sek. Rrethi i Vlorës në përgjithësi dallohet për erërat e forta e kjo për shkak të konfigurimit të relievit dhe të gjirit të Vlorës. Si erëra të jashtëzakonshme kujtohen ato të prillit 1970, kur u regjistrua një shpejtësi prej 120 km/h.

### 3.5 Lumenjtë e përrrenjtë

Qarku i Vlorës është i pasur me ujera *rrjedhëse* që shpjegohen me relievin si dhe me reshjet e shumta në formë shiu dhe dëbore. Territori i Qarkut të Vlorës përshkohet nga rrjedhja e poshtme e lumit Vjosa, nga lumi Shushica (Vlorë), Lumi i Kalases (Delvinë), Lumi i Bisticës dhe Lumi i Pavllës (Sarandë) si dhe nga shume përrrenj me degëzime të shumta që grumbullojnë ujerat rrjedhëse sipërfaqësore dhe nëntokësore. Luginat e lumenjve të mësipërm janë të populluara me fshatra të shumta dhe toka bujqësore e këtyre luginave është shume e begate për prodhimin e kulturave të lashta. Fushat kryesore janë Myzeqeja e Vlorës dhe fusha e Vurgut (Sarandë).

Territori i Qarkut të Vlorës është shumë i pasur dhe me ujera *nëntokësore* të cilat gjenden në dy forma: ujera tokësore që dalin në sipërfaqe në formën e burimeve, si dhe ujera në formën e pellgjeve nëntokësore. Në këtë grup bëjnë pjesë dhe burimet e ujit të ëmbël që vijnë nga shtrati i detit, ku me të njohurat janë Burimi i Ujit të Ftohte (Vlorë), burimet në Orikum, burimi i Potamit (Himarë). Ndërsa në grupin e pare bëjnë pjesë burime të njohura të ujit të ëmbël si Syri i Kaltër (Delvinë) apo Përroi i Borshit (Sarandë), Buronjat (Kuc).

### 3.6 Lumenjtë dhe veçoritë e tyre

**Lumi kryesor i Vlorës është Vjosa dhe dega e saj Shushica.** Vjosa ndjek drejtimin e vargmaleve, me përjashtim të rrjedhës së poshtme të saj. Këta dy lumenj kanë ujëra të bollshëm gjatë dimrit dhe shpesh përmbysin zonat përreth, ndërsa në vere ujerat e tyre bien ndjeshëm. Shkaqet e fryrjes së tyre janë shirat e bollshëm dhe shkrirja e borës, si rrjedhojë e ardhjes së masave të ngrohta ajrore me origjinë mesdhetare.

Vjosa është lumi kryesor i Shqipërisë Jugore, i gjatë 272 km me një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 6710 km<sup>2</sup>. Vetëm lugina e poshtme e Vjosës i përket Rrethit të Vlorës ; me një gjatësi 76 km shërben edhe si kufi natyror midis Vlorës dhe Fierit. Vjosa hyn në territorin e rrethit të Vlorës pasi kalon shkëmbin e Lunecit, midis Kalivaçit e Shkozës për të vazhduar drejt kësaj të fundit. Pastaj përshkon cepin verior të Myzeqesë së Vogël dhe fushën e Topalltisë për tu derdhur në Adriatik, pranë Dëllinjës, ku edhe formon një deltë. Në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij gjerësia e lumit shkon nga 50 -80 m dhe thellësia deri në 3 m. Shtrati i lumit zgjerohet dhe ndryshon drejtim vazhdimisht, duke formuar me andre në zona të ndryshme si: në Klos, Karbunare, Delisuf, etj-. Në rrethin e Vlorës numërohen rreth 7-8 kthesa të mëdha si në Karbunare, Beshisht, Mifol, Bishan, etj. Me tipiket janë ato të Karbunares e të Bishanit. për të kaluar mbi Vjosë janë ndërtuar pasarela si në Rexhepaj, Selenicë, ndërsa Bishan (v. 2010), Novoselë (v. 1920, v.1976), janë ura lidhin Fierin me Vlorën. Prurjet mesatare të Vjosës janë 210 m<sup>3</sup>/sek. Prurjet minimale janë në periudhën korrik- tetor, ndërsa maksimalet në nëntor-mars, që në Mifol arrijnë deri në 3600 m<sup>3</sup>/sek. Shpesh në periudha shirash të jashtëzakonshëm lumi del nga shtrati dhe përmbyt fushën e Myzeqesë. Nisur nga ky fakt njësi administrative Novoselë i është nënshtruar një projekti për përbalimin e situatave emergjente.

**Shushica** është e vetmja degë e rrjedhjes së poshtme të Vjosës dhe shpesh quhet Lumi i Vlorës është i gjatë 80 km me një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës rreth 715 km<sup>2</sup>. Është rrjedhojë e takimit të dy përrrenjve (*ai i Smokthinës dhe Kuçit*) pranë

urës se Bratit. Ndikon shumë në nivelin e Vjosës dhe trajtohet në skenarët për parashikimin e përmbytyjeve të zonës Novoselë dhe Armen.

**Smokthina** është një përrua që përfundon në lumin e Shushicës. Është i gjatë 25 km dhe është një përrua tipik i zonave malore. Pranë fshatit të Bratajt bashkohet me përroin e Kuçit duke formuar kështu lumin e Shushicës. Lumi i Kuçit është dega e majtë e Shushicës dhe buron në Ku13. Gjatë rrjedhës se saj mbledh ujërat e Buronjave të Kuçit, kalon gryken e Kuçit dhe vazhdon në Kallarë. Gjatë rrjedhës se saj mbledh ujërat e shumë burimeve të zonës dhe në fund bashkohet me Smokthinën.

**Bistrica** është lum me shtrat në Sarandë dhe Delvinë, me gjatësi 31.5 km, dhe me pellg me sipërfaqe 447 km<sup>2</sup>. Ushqehet nga burime nëntokësore, me më të madhin dhe të bukurin Syrin e Kaltër, që del nga shpati i malit të gjerë. Në Krongj derdhet Përroi i Vrisit, dhe në udhë me të bashkohet përroi i Kardhiqit, dhe përrenj që në verë nuk kanë ujë. Ka prurjen mesatare 24.9 m<sup>3</sup>/sek, me mineralizim mesatar, me temperaturë mesatare 12.9 C°

**Lumi i Kalasës** është degë e Bistricës, rrjedh nga Rrethi i Vlorës për në Sarandë. është i gjatë 34 km, ka pjerrësi 30 m/km, është bazë furnizimi me ujë për vaditje dhe të kodrave e brezareve të Lukovës, Piqerasit, mbasi një sasi e tij del nga një tunel në Sasaj. Pjerrësia e madhe e lumit, prurja e madhe e tij si dhe dëmtimi i theksuar i mbrojtësve të këtij lumi kanë filluar të krijojnë probleme për komunitetin, duke rrezikuar jetën e njerëzve si dhe të mbjellat, sidomos në pjesën ku ky lum futet në territorin e Bashkisë Delvinë. Për disiplinimin e rrjedhjes së tij është duke u zbatuar një projekt i PNUD.

Në rrethin e Vlorës gjenden dy Laguna, ajo e Nartës me ujë të kripur dhe ajo e Pasha Limanit me ujë të ëmbël. Këto laguna janë shpallur zona të mbrojtura dhe përfshihen në projekte për mbrojtje në rast të ndotjeve detare ose në vetë lagunat.

### 3.7 Rezervuarët dhe hidrovorët (strukturat përgjegjëse)

1. **Rezervuari i Vllahinës (Bashkia Selenicë)**, me kapacitet të projektuar 4. 000. 000 m<sup>3</sup> ujë. (viti i

ndërtimit 1967). **Në trupin e digës është ndërhyrë nga fermerë privat duke kaluar me mjete të renda, për këtë kemi njoftuar të gjitha institucionet shtetërore, kemi bere edhe njoftim në prokurori, por këtë çështje ata e kanë pushuar. Gjate vitit 2011 kanë punuar skarpatin e jashtme të trupit të digës e cila e rrezikon shume qëndrueshmërinë e trupit të saj.** Shkarkuesi katastrofik funksionon ka nevojë për rikonstrukcion. Aftësi ujitëse e projektuar 840ha

2. **Rezervuari i Babices (Bashkia Vlorë)**, është në gjendje normale si diga, shkarkuesi

katastrofik e Saraçineskat. Kapaciteti i projektuar 2. 500. 000 m<sup>3</sup> ujë. Aftësi ujitëse e projektuar 500ha. Ky rezervuar është në administrim të shoqatës se përdorimit të ujit Babicë.

3. **Rezervuari i Harvalase (Bashkia Selenicë)**, me kapacitet 4. 500. 000 m<sup>3</sup> ujë. Aftësi ujitëse e projektuar 1200ha. Diga është në rregull por saraçineska dhe tubi i dërgimit të këtij, rezervuari duhen zëvendësuar pasi janë të amortizuar në masë 80%. Rezervuari shkarkon nga shkarkuesi katastrofik dhe të dy saraçineskat janë të hapura,por kanë probleme. Gjithashtu ka rrëshqitje të një mase dheu në hyrje të shkarkuesit katastrofik Është hartuar projekti dhe preventivi në vitin 2011. Dhe është çelur fondi dhe është duke u bere prokurimi.

4. **Rezervuari i Hasomatit (bashkia Selenicë)**, është në rregull me saraçineskat, kapaciteti është 560.000 m<sup>3</sup> ujë, Aftësi ujitëse e projektuar 840ha. Aftësi ujitëse e projektuar 150ha për vitin 2009. Rezervuari është në rregull dhe saraçineskat janë të rregullta,te hapura,rezervuari shkarkon.

5. **Rezervuari Pete (Bashkia Selenicë)**, është në rregull, saraçineskat i ka të hapura dhe

shkarkon, kapaciteti i tij është 2.600.000 m<sup>3</sup>ujë. Aftësi ujitëse e projektuar 770ha.

6. **Rezervuari Kocul (Bashkia Selenicë)**, është problematik sepse në skarpatin e jashtme fermerët kanë mbjelle vreshta e peme dru-frutore dhe ka rrëshqitje në trupin e digës, shqetësim të cilin e kemi bere prezent në të gjitha instancat shtetërore dhe prokurori por kjo është pushuar,dhe nga pushteti lokal nuk është marre asnjë mase. Në si institucion kemi bere ngritjen e kurorës, uljen e shkarkuesit katastrofik i cili shkarkon, saraçineskat janë dëmtuar nga fermerët, janë prerë akset dhe nuk funksionojnë.

7. **Rezervuari i Bunavise (Bashkia Vlorë)**, me kapaciteti 450. 000 m<sup>3</sup> ujë Aftësi ujitëse e projektuar 130ha. Është rehabilituar në vitin 2009 si ujëlëshues,saraçineska e shkarkues katastrofik. por ka filtrime në trupin e saj. Shkarkuesi katastrofik në gjendje pune.

8. **Rezervuari i Kallafetit (Bashkia Vlorë)**, nuk ka asnjë problem. Kapaciteti i tij është 660. 000 m<sup>3</sup> Aftësi ujitëse e projektuar 660ha. Sarcineskat i ka në funksion.

9. **Rezervuari Bestroves (Bashkia Vlorë)**, ka ujëlëshuesin të bllokuar dhe saraçineskën të bllokuar. Kapaciteti i tij është 236. 000 m<sup>3</sup> ujë. të rikonstruktohet ky rezervuar. Nuk paraqet problem.

10. **Rezervuari i Panajase (Bashkia Vlorë)**, është në administrim të shoqatës së përdorimit të Ujërave Panaja, kapaciteti i tij është 1.060.000 m<sup>3</sup> Aftësi ujitëse e projektuar 460ha. Gjate viti 2008-2009 është punuar nga P. M. U. për rehabilitimin e sistemit ujitës dhe zëvendësimin e saraçineskave të këtij rezervuari. Nuk paraqet problem.

11. **Rezervuari Kanina Nr. 1 (Bashkia Vlorë)**, Kapaciteti i projektuar është 142.000 m<sup>3</sup> ujë. Është nën administrimin e fermerëve qysh nga viti 1996 (privat) dhe Bordi i Kullimit e ka nën kontroll. Nuk paraqet problem.

12. **Rezervuari Kanina Nr. 2 (Bashkia Vlorë)**, kapaciteti i projektuar është 556.400 m<sup>3</sup> ujë dhe ky rezervuar administrohet nga fermerët privat qe nga viti 1996. Nuk paraqet problem.

13. **Rezervuari i Janjari (Bashkia Konispol)**, Kapaciteti sipas projektit  $V=15\,200\,000\text{ m}^3$ , skarpatet e digës janë të rregullta, është bere rikonstruksioni shkarkuesit katastrofik dhe pastrim i pjesshëm i sistemit ujitës. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

14. **Rezervuari i Vërvës (Bashkia Konispol)**, ndërtuar në vitin 1980. Kapaciteti sipas projektit  $V=400\,000\text{ m}^3$ . Skarpatet e digës nuk janë në gjendje të mirë sidomos ajo e thatë e cila ka gërryerje nga rrëketë, kurse ajo e lagur ka probleme gërryerje në pjesën e kurorës si rezultat i dallgëve dhe mos riparimit për një kohë prej rreth 20 vjet. Kurora e digës ka gërryerje. Gjate vitit 2010 është bere riparim i këtij rezervuari dhe është në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar.

15. **Rezervuari i Bezhanit (Mursi) (Bashkia Konispol)**, Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1966. Kapaciteti i projektuar është 4 500 000 m<sup>3</sup>. Kurora e digës ehte në gjendje të mirë (në kupën e liqenit janë ndërtuar objekte). Portat në V. Marrjes duhen riparuar. Nuk paraqet problem.

16. **Rezervuari i Navaricës (Bashkia Finiq)**, Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1980. Kapaciteti i projektuar është  $V=400\,000\text{ m}^3$ . Shkarkuesi katastrofik funksionon në rregull dhe nuk ka probleme. Kurora e digës është në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar.

17. **Rezervuari i Gjovrakut (Bashkia Delvinë)**, Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1968 Kapaciteti sipas projektit  $V=800\,000\text{ m}^3$  ujë. Skarpati e lagur nuk është në gjendje të mirë pasi ka ndryshim të pjerrësisë së skarpatës nga ajo e projektit nga dallgët dhe mos mirëmbajtja e tij në vite. Gjate vitit 2010 është bere riparim i këtij rezervuari dhe është në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

18. **Rezervuari i Bajkajt (Bashkia Delvinë)**, Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1976. Kapaciteti sipas projektit  $V=1\,200\,000\text{ m}^3$  ujë. Skarpata e lagur e digës ka rrëshqitje e cila rrezikon qëndrueshmërinë e digës. Shkarkuesi katastrofik ka mbushje në hyrje. Saraçineska nuk funksionon në rregull. Ushqyesi është me probleme pasi mbushet çdo vit me aluvione. Për riparimin e faqes së lagur të digës nevojiten rreth 9 000 000 leke. Si dhe një projekt nga institucione të specializuara. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

19. **Rezervuari i Katalatit (Bashkia Delvinë)**, Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1971. Kapaciteti sipas projektit  $V=80\,000\text{ m}^3$  ujë. Diga është çarë në një gjatësi  $L=10-12\text{ m}$  dhe thellësi  $H=10\text{ m}$ . Ky rezervuar ka 6 (gjashtë) vjet që ka dale jashtë funksionit.

20. **Rezervuari i Karroqit (Bashkia Finiq)**. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1964. Kapaciteti sipas projektit  $V=350\,000\text{ m}^3$ . Shkarkuesi katastrofik duhet pastruar vazhdimisht. Dhe ka gërryerje në pjesën e poshtme, e mbajmë gjithmonë në mbikëqyrje. Kurora e digës është në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

21. **Rezervuari Gravës Nr. 1. (Bashkia Finiq)**. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1964. Kapaciteti sipas projektit  $V=160\,000\text{ m}^3$ . Shkarkuesi katastrofik ka dëmtim të veshjes dhe në pjesën fundore ka gërryerje të mëdha. Ujë lëshuesi është i bllokuar prej disa vitesh dhe kanali i mbushur. Në brigje nuk ka rrëshqitje. Është duke shkarkuar.

22. **Rezervuari Grava nr. 2. (Bashkia Finiq)**. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1979. Kapaciteti sipas projektit  $V=100\,000\text{ m}^3$ . Ujë lëshuesi bllokohet vazhdimisht. Gjate vitit 2010 është bere riparim i këtij rezervuari dhe është në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

23. **Rezervuari i Sullës (Bashkia Finiq)**. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1979 Kapaciteti sipas projektit  $V=600\,000\text{ m}^3$ . Skarpatet e digës në gjendje të mirë, s'ka nivel uji.

24. **Rezervuari i Pandalejmonit. (Bashkia Finiq)**. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1983 Kapaciteti sipas projektit  $V=1\,400\,000\text{ m}^3$ . Skarpata e lagur e digës ka shkarje të pjesshme me rreth 150 m<sup>3</sup> se bashku me kalldrëmin. Kërkohe ndërhyrje për riparimin e saj e cila do të behet pasi të miratohet projekt-preventivi përkatës. Sot për sot ai nuk arrin të mbushet pasi ushqyesi është i dëmtuar dhe për tu venë në efijenc kërkon investime të mëdha. Mbushja me



anën e shirave është e mjaftueshme për kërkesat e sotme dhe si e tille mund të themi se mbahet në mbikëqyrje dhe nuk do të lejohet mbushja mbi zonën e dëmtuar. S'ka nivel uji.

**25. Rezervuari i Leshnicës (Bashkia Finiq).** Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1978. Kapaciteti sipas projektit V = 120 000 m<sup>3</sup>. Skarpatet e digës në gjendje të mirë. Kurora e digës në gjendje të mirë. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

**26. Rezervuari i Nivicë (Bashkia Himarë).** Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1964. Kapaciteti sipas projektit V= 100 000 m<sup>3</sup>. Në krahun e djathtë të digës janë bere punime nga privatet qe shfrytëzojnë ujin për peshk. Këto punime rrezikojnë qëndrueshmërinë e saj. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

**27. Rezervuari i Dhivrit (Bashkia Finiq).** Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1962. Kapaciteti i projektuar V = 130 000 m<sup>3</sup>. Skarpatet e digës në gjendje jo të mire pasi në të dy skarpatet në qendër të digës duke filluar nga kurora deri në një lartësi rreth 5m ka çarje e cila u evidentua pas sezonit të ujitjes. Është duke shkarkuar. Nuk paraqet problem.

#### **Hidrovorët**

**1. Hidrovori i Qytetit, ka instaluar 4 pompa me kapacitet 16 m<sup>3</sup>/sek dhe aftësi kulluese të projektuar 1000ha.** Ky hidrovor furnizohet me energji elektrike me dy linja të cilat here pas here pësojnë defekte, duke e lenë hidrovorin pa pune. Edhe pse ka ardh linja e 20000 kë pranë godinës se hidrovorit për mungese transformatorësh kjo lidhje nuk është realizuar. Në zbatim të V. K. M Nr. 227 date 19. 04. 2006. "Për transferimin e Truallit dhe të Objektivit Hidrovori i Qytetit Vlore", Hidrovori i Qytetit Vlore i ka kaluar në pronësi Bashkisë se Vlorës, vendim i cili ende nuk është zbatuar. Bordi i Kullimit Vlore, ka kërkuar Bashkisë Vlore, marrjen e këtij objekti vazhdimisht, me shkresat Nr. 13/6Prot. dt. 16/07/2006, Nr. 15/6prot. dt. 09/08/06, Nr. 16/6prot. dt. 18/08/2006. Nr 17/6Prot. dt 03/09/2006. Nr 31/6. dt. 28/09/2006. Nr. 24/6. dt 12/10/2006. Nr. 154. prot. dt 10/09/2007. Nr. 102. prot. dt. 04/08/2008. Nr. 102/1prot. dt. 25/08/2008. Nr. 141 prot. dt. 11/12/2008. dhe Nr. 125. prot. dt. 28/08/2009. Edhe pse kemi kërkuar në mënyre të përsëritur, Bashkia Vlore nuk ka dëshirën e mire për zbatimin e këtij vendimi. Në si Bord Kullimi Vlore vazhdojmë ta mbajmë k ët ë objekt në gatishmëri për të përballuar çdo situatë qe do të krijohet gjatë periudhës se dimrit por mungesa e investimeve e ka çuar në pike kritike për përballimin e reshjeve të mëdha. Në zbatim të V. K. M. nr. 227. date 19. 04. 2006. "Për transferimin e Truallit dhe të Objektivit Hidrovori i Qytetit Vlore", në si Bord Kullimi nuk na jepet mundësia ligjore për rikonstruksionin e këtij hidrovori, theksojmë se 2(dy) pompat "Ganz i Madh" janë në fazën urgjente të zëvendësimit të tyre. Panelet elektrike gjithashtu janë shume të amortizuara.

**2. Hidrovori i Akernise (nën administrimin e Bordit të Kullimit) : Ka të instaluar 5 pompa nga të cilat 4 janë në gatishmëri të plote me kapacitet 15 m<sup>3</sup>/sek dhe aftësi kulluese të projektuar 4600ha.** Pompa Nr. 5 është jashtë punë ka defekte në panelin elektrik+elektromotor. pompa. Aktualisht furnizohet me energji elektrike vetëm me një linje e cila kalon nga argjinatura e Selevecit dhe është me probleme pasi shtyllat janë të spostuara nga pozicioni vertikal i tyre dhe telat mbajnë shtyllat e jo shtyllat telat. Por deri tani hidrovori furnizohet me energji elektrike.

**3. Hidrovori i Orikumit ka të instaluar 3 pompa të cilat janë në gjendje punë vetëm 2, dhe aftësi kulluese të projektuar 350ha.**

Në këtë hidrovor kemi pasur defekte të përsëritura të bazamenteve dhe akseve të pompave. Furnizimi me energji elektrike është

problem sepse në linjën e furnizimit me energji ka edhe konsumator privat të cilët ndikojnë negativisht në punën e këtij hidrovori.

Ky hidrovor duhet të bëhet i ri pasi është hartuar dhe Project-preventivi.

**4. Hidrovori Gorice – ka të instaluar 2 (dy) pompa me kapacitet 4,5 m<sup>3</sup>/sek. dhe aftësi kulluese të projektuar 660Ha.**


Pompat dhe panelet elektrike janë të amortizuara, pësojnë here pas here defekte të cilat riparohen dhe vihen në pune. Nuk ka problem për sa i përket furnizimit me energji elektrike.

**5. Hidrovori i Çukës (Bashkia Sarandë)** është në punë me 4- elektropompa dhe ka mbajtur deri tani në gjendje të mire (pa probleme) kullimet në fushën e Vurgut. Gjendja ndiqet vazhdimisht.

**6. Hidrovori i Butrintit janë instaluar 3 (tre) pompat të reja (Bashkia Sarandë)** Hidrovori i Butrintit është në punë me 1- elektropompë dhe ka mbajtur deri tani në gjendje të mire (pa probleme) kullimit në fushën e Vrinës. Gjendja ndiqet vazhdimisht.

Në territorin e Bashkisë Finiq ndodhet dhe Hidrocentrali i Bisticës, i cili është marrë në koncesion. Nga shkarkimet e imponuara nga rritja e nivelit të ujit shpesh janë krijuar probleme në tokat e njësisë Finiq

## Skema e mbi mënyrën e grumbullimit e informacionit në qark



## 4. RREZIQET E MUNDËSHME

### 4.1 Identifikimi i rreziqeve të mundshme

Në nivelin vendor, përgatitja dhe mbrojtja kërkon njohjen sa më mire të rreziqeve dhe të pasojave të mundshme që sjellin ato. Në bazë të studimit të bërë në vitin 2003, rreziqet e mëposhtme evidentohen si rreziqet më kryesore që kanë prekur ose mund të prekin Qarkun Vlorë.

- Rreziqet sizmike
- Rreziqet nga përmytjet
- Rreziqet nga dëborë
- Rreziqet nga rrëshqitja e tokës
- Rreziqet nga zjarret në pyje
- Rreziqet teknologjike, industriale dhe reagimet gjatë ndotjeve detare
- Rreziqet nga aktet terroriste

Identifikimi i rreziqeve dhe ndërgjegjësimi i strukturave përkatëse për pasojat nga dukuri të mundshme rreziku, sjell marrjen e masave përgatitore për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë.

### 4.2 Monitorimi dhe mekanizmat aktiv

Monitorimi sistematik i rreziqeve, kërkon përcaktimin e saktë të roleve dhe përgjegjësi të strukturave të emergjencave. Institucionet monitoruese në qark kanë detyrë të japin informacion periodik dhe specifik, Prefektit të Qarkut (specialistit të emergjencave) dhe OQV. Kërkesat për monitorim përfshijnë:

- Monitorimin e aktivitetit sizmik dhe hidrometeorologjik.
- Monitorimin e nivelit të ujit brenda kapaciteteve të sigurisë së digave.
- Monitorimin e zonave me rrezik rrëshqitje.
- Monitorimin e reshjeve lokale të dëborës, shpejtësinë e erës/drejtimit dhe kushtet e temperaturës, të cilët ndikojnë në bllokimin e rrugëve, ndërprerjen e përpunimit të anieve e trageteve në portet detare.
- Monitorimin e trashësisë së konsoliduar të dëborës në faqet e thepisura me pjerrësi prej 30 gradësh dhe me tepër.
- Monitorimin e kushteve dhe rreziqeve të rënies së zjarreve në pyje në zonat në rrezik.

- Monitorimin e funksionimit të kushteve të sigurisë në objektet industriale dhe ndërtesat.
- Monitorimin e ndotjes së mjedisit në tërësi.
- Monitorimin e ndotjes së ujerave detar dhe të lagunave.
- Monitorimin e kushteve të higjienës epidemiologjisë.
- Monitorimin e sëmundjeve në bime dhe kafshe.

### 4.3 Rolet dhe përgjegjësit

Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të strukturave të emergjencave civile janë detyrime që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore.

### 4.4 Përgjegjësitë në nivel qarku

Prefekti (*specialisti i emergjencave civile*):

- Njoftojnë në mënyre të vazhdueshme DPPEC- ne, për ndryshimin e të dhënave të pikave të kontakteve të KPPECQ- se, për strukturat e emergjencave civile brenda qarkut, për zyrtaret e caktuar si përgjegjës për çështje të emergjencave civile të bashkive dhe pikat kyç në sektorët publik, private dhe vullnetare.
- Sigurojnë që sistemet e paralajmërimit të publikut dhe të komunikimit janë funksionale.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth gjendjes ushqimore si dhe të dhënat në lidhje me ilaçet rezerve në institucionet shtetërore dhe ato private, në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë detajet e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel qarku.
- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat për llojet e makinerive dhe vendndodhjen e makinerive të renda, të zotëruara si nga sektori shtetëror, ashtu edhe nga ai privat në nivel qarku.
- Bëjnë veprimet e duhura për sjelljen e mjeteve të renda të transportit dhe vendosjen e makinerive të renda në zonat që mund të izoloohen, në se është e nevojshme.
- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera në nivel qarku, për tu mbrojtur nga dukuri të mundshme rreziku duke përfshirë:
  - ❖ Marrjen e masave për të siguruar pastrimin e kanaleve dhe të kolektorëve;
  - ❖ Njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit, zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta;
  - ❖ Ndërgjegjësimin e komunitetit për ruajtjen e ushqimit të nevojshëm, të ujit dhe të rezervave të tjera materiale;
  - ❖ Marrjen e masave për hapjen e rrugëve ekzistuese dhe të rrugëve alternative, në se është e nevojshme.

### 4.5 Në bashki

Strukturat e caktuara me përgjegjësitë për emergjencat civile në bashki:

Njoftojnë në mënyrë të rregullt prefektin e qarkut (sektorin e EC- ve) për të gjitha ndryshimet e pikave të kontaktit në njësinë përkatëse, si për kryetarin e bashkisë, punonjës të emergjencave civile në bashki, anëtarin e KVEC- se në bashki dhe kontaktet e tjera kyç në sektorët publik, vullnetare dhe private.

Sigurojnë funksionimin e sistemit të paralajmërimit dhe të komunikimit të publikut.

Kontrollojnë dhe freskojnë inventarin e logjistikës së transportit, duke përfshirë numrin e makinave, gjendjen e tyre teknike, disponueshmërinë e karburantit dhe rezervën e tij në nivel bashkie.

- Kontrollojnë dhe freskojnë të dhënat rreth llojeve dhe vendndodhjes së makinerive të renda të zotëruara si nga sektori shtetëror, ashtu edhe ai privat, në nivel bashkie.

- Kontrollojnë marrjen e masave të tjera për mbrojtjen nga dukuri të mundshme nga rrezikun në nivel bashkie ose duke përfshirë:
  - Marrjen e masave për të siguruar pastrimin kanaleve dhe të kolektorëve nga mbeturinat dhe materialet inerte;
  - Njohjen e komunitetit me rrugët e evakuimit, mjetet për komunikimin gjatë emergjencave, mjetet e informimit dhe zonat e mbrojtjes dhe vendstrehimet e sigurta;
  - Ndërgjegjësimin e komunitetit për domosdoshmërinë e ruajtjes së ushqimit, ujit dhe rezervave të tjera materiale.

## 5.TËRMETET

### 5.1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga tërmetet

Qarku Vlorë është një zonë relativisht aktive, si rrjedhojë e zonave sizmoaktive që gjenden në të. Vlera maksimale është regjistruar në Llogora me një magnitudë 5.8 gradë. "Rrënjët" gëlqerore të zonës kanë luajtur një rol të rëndësishëm në amortizimin e valëve sizmike. Megjithatë, duhet të vlerësojmë kuotat e mundshme që shkojnë nga 5 në 7 gradë. Panorama e plote gjeologjike është pasqyruar në hartën bashkangjitur.

Historikisht, Qarkut Vlorë, është i tillë; Qarku Vlorë, është prekur nga tërmetet në vitet 1831, 1851, 1866, 1893, 1962. Tërmetet kanë prekur dhe kanë shkaktuar dëme në njerëz dhe në objekte banimi në fshatrat; Kuç, Dukat, Tërbaç, Palas, Dhërmi, Smokthinë, Velçë, Brataj, Lepenicë, Tragjas, Himarë dhe në qytetin e Vlorës.

### 5.2. Karakteristikat kryesore

Në përgjithësi, tërmetet bien pa paralajmërim, por mund të pasohet nga një seri lëkundjesh të tjera, shtrirja kohore e të cilave mund të zgjasë për ore, dite ose jave të tëra.

- Lëkundjet pasuese janë të një shkallë me të vogël se e para, por mund të shkaktojnë ndikim të madh, veçanërisht tek strukturat që janë dëmtuar tashme.
- Tërmetet godasin nga thellësi të ndryshme dhe kanë kah lëvizje horizontale, vertikale ose të kombinuara.
- Në përgjithësi, e matur në shkallën Rihter, madhësia e një tërmeti nuk tregon intensitetin (*efektin sipërfaqësor*) e tij në një vend të caktuar.
- Dëmtimet e shkaktuara nga tërmetet varen nga këta faktorë: Madhësia në shkallë Rihter, thellësia e vatrës, karakteristikat e truallit ku mbështeten objektet, cilësia e strukturave të prekura, intensiteti dhe numri i pasgoditjeve, pas goditjes kryesore, efektet dytësore që shfaqen në truall etj.
- Numri i viktimave nga tërmetet varet shumë nga aftësia që kanë objektet e ndërtimit për tu rezistuar goditjeve sizmike si dhe nga koha lokale në të cilën ndodh goditja.
- Edhe efektet dytësore mund të çojnë në pasoja serioze si rrëshqitjet e tokës, dalja në sipërfaqe e thyerjeve tektonike, lëngëzimi i trojeve, përmytjet që vijnë nga dëmtimi i ujëmbledhësve, shkarkimit të mbetjeve toksike nga zonat industriale etj.
- Shkatërrimi i papritur i një dige kryesore nga goditjet sizmike do të sillte pasoja katastrofike për komunitetin që jetojnë afër saj.

### 5.3 Faktorë që duhet të merren parasysh në parandalimin dhe lehtësimin

- Një tërmet ose dukuri tjetër sizmike është e pamundur të parandalohet, por në zonat me rrezik të lartë mund të merren masa për të kufizuar efektet negative që lidhen me cenimin e jetës dhe të pasurisë.
- Investimet, bashkërendimi dhe fushatat e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe të publikut inkurajojnë lehtësimin dhe uljen e rreziqeve.
- Përmirësimet, pranimi dhe zbatimi i kodeve dhe i standardeve të ndërtimit për të përballuar

lëkundjet sizmike ulin dëmet në njerëz dhe në pasurinë private dhe publike

- Ndërtimet e reja të një rëndësie të veçante duhet të bëhen në mënyrë të tillë që të përballojnë goditjet e forta sizmike.

- Sensibilizimi i strukturave në nivel lokal është i rëndësishëm për të zhvilluar strategji për zbatimin e kodeve ekzistuese me synim përmirësimin e tyre.

- Objektet e rëndësishme që paraqesin rrezik, si diga, infrastruktura publike dhe private duhet të mirëmbahen në gjendjen ekzistuese dhe të po të jetë e nevojshme të bëhen përmirësime strukturore.

#### **5.4 Faktorë për tu marre në konsiderate gjatë përgatitjes dhe mbrojtjes**

- Në përgjithësi, në rastet e tërmeteve ose goditjeve sizmike, paralajmërimi në kohe nuk është i mundur, por mund të bëhen përgatitje të veçanta në zonat e identifikuara si zona me rrezik të lartë sizmik.
- Ndërgjegjësimi i publikut për momentet e para të tërmeteve është shumë i rëndësishëm për shpëtimin e jetës. Shkollat, administrata publike, spitalet, industria private medja lokale dhe publike duhet të shpërndajnë mesazhe të thjeshta e të kuptueshme.
- Planifikimi i përballimit të emergjencave në nivel lokal dhe për çdo institucion si dhe autoriteti përkatës duhet të rriten pasi një gjë e tillë është e lidhur drejtpërdrejtë me bashkërendimin rajonal, me mobilizimin e burimeve nëpërmjet Planit të qarkut për emergjencat civile.
- Planet e Përballimit të Emergjencave, duhet të praktikohen nëpërmjet stërvitjeve stimuluese dhe në terren.
- Parashikimi i vendeve për evakuim në planet e emergjencave civile në bashki. Vendet për kampingje duhet të jenë të tillë që të ofrohet struktura e nevojshme për një jetese ose rehabilitim të shpejtë. Kapacitet transportuese dhe trajnimi i personelit.
- Të gjitha strukturat e emergjencave, linjat e komunikimit, rolet dhe përgjegjësitë duhet të qartësohen, të përgjithësohen dhe të testohen në bazë të planeve për të siguruar një përgjigje efektive të vazhdueshme.
- Në planet e bashkive janë të përcaktuara, vendet për evakuimin e popullsisë dhe ndërtimin kampingjeve. **Në shtojcë, janë listuar kapacitetet njerëzore, teknike si dhe vendet me kapacitete përkatëse.**

#### **5.5 Faktorët për tu marrë parasysh në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave civile**

- Veprimet e menjëhershëm të kërkim-shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komuniteti i prekur ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjaret të afërmit ose fqinjët.

- Trajtimi i menjëhershëm mjekësor i të plagosurve do të jetë mjaft i domosdoshëm, kjo kërkon një plan për trajtimin e viktimave në masë dhe nëse është e nevojshme evakuimin për trajtim mjekësor jashtë zonës se prekur nga tërmeti.

- Vlerësimi i shpejte rreth humbjeve, dëmtimeve dhe nevojave.

- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të dëmtuara, duhet të filloje sa me shpejte operacionet e kërkim-shpëtimit duke pasur parasysh se 24- 48 orët e para është koha gjatë se cilës mund të shpëtohen pjesa më e madhe e njerëzve.

- Në vartësi të shumë faktorëve operacioni i kërkim - shpëtimit munde të vazhdoje në mënyrë të suksesshme për deri në 65 orë, ose me shume orë pas ngjarjes. Nëse është shkaktuar një dëmtim struktural i konsiderueshëm dhe nëse një numër i madh njerëzish kanë mbetur brenda, mund të kërkohet mbështetje edhe nga struktura të tjera në qarqet fqinjë ose nga qendra.

- Ardhja e skuadrave të kërkim- shpëtimit do të shkaktojë një ngarkesë të konsiderueshme mbi infrastrukturën e transportit ajror dhe rrugor si dhe kërkon angazhim për ti shpërndarë ato në zonat e prekura sa me shpejtë që të jetë e mundur,

- Skuadrat ndërkombëtare të kërkim- shpëtimit mund të vijnë edhe me spitale fushore. Për këtë, ka çështje specifike që duhet të qartësohen parapranimi/kërkimit të një spitali fushor, të cilat duhet të bëhen nëpërmjet drejtuesit të operacionit të qarkut me drejtuesin DQO.

- Rreziqet dytësore dhe dëmtimet strukturore të ndërtesave publike (*spitale, shkolla, ndërtesa administratash etj*) duhet të vlerësohen duke u siguruar se ato mund të funksionojnë pa pasur rreziqe.
- Vlerësimi dhe kujdesi i vazhdueshëm për nevojat për ujë të pijshëm, strehë të sigurt, furnizimin me ushqime dhe artikuj të tjerë jo ushqimore si dhe regjistrimin dhe kërkimin e personave që mungojnë.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, porti komunikimi dhe infrastruktura tjetër duhet të vihen në funksion sa me shpejte që të jetë e mundur.
- Për rastet e viktimave në masë (qindra të vdekur) duhet të merren hapa specifike në mënyre që të menaxhohet si duhet një situatë e tillë.

## **5.6 Faktorët për tu marre parasysh gjatë fazës së rikthimit në gjendjen normale**

- Shërbimet publike bazë, që përfshijnë furnizimin me ujë të pijshëm, ujërat e zeza, akset kryesore të rrugëve dhe furnizimin me energji, duhet të jenë të sigurta.
  - Vendime të shpejta duhet të merren në lidhje me ndërtesat kryesore të ndërmarrjeve publike duke përfshirë dhe ndërtesat e shëndetësisë dhe shkollat.
  - Vendime të shpejta duhet të merren, gjithashtu edhe me strehimin e sigurt për popullsinë e prekur. Përdorimi i çadrave të jetë për një kohë të shkurtër.
  - Ndërtesat industriale dhe objektet bujqësore që janë dëmtuar ose shkatërruar. Restaurimi i këtyre burimeve është shumë i rëndësishëm për rimëkëmbjen e ekonomisë dhe për punësimin e komunitetit.
  - Një tërmet i fuqishëm i lë efektet e tija për një brez ose edhe për më tepër dhe rajoni i prekur do të ketë nevojë për mbështetjen ndërkombëtare për një afat më të gjatë derisa të bazohet në forcat e tija. Planifikimi për riaftësim duhet ta reflektojë këtë gjë.
  - Rikthimi në gjendjen normale është mundësi për lehtësimin dhe parandalimin Përveç presioneve të mëdha për të siguruar strehim dhe shërbime sa me shpejte të jetë e mundur, duhet të merren parasysh edhe çdo mundësi për të ndërtuar instalime të reja të një standardi që të përballojë goditjen sizmike, duke bere ndërtimin në një zonë të studiuar me kujdes, përfshirë këtu edhe shërbimet publike.
- Mirëmbajtja e strukturave ekzistuese duhet të inkurajohet në rastet e riparimeve, veçanërisht për shkollat e spitalet. Në rastin e strukturave shëndetësore duhet të sigurohet një funksionim i plotë për gjatë të gjitha fazave, duke përfshirë instalimin e rrjetit afatshkurtër të furnizimit me ujë dhe mjetë për tu përdorur në rastet e nevojshme, si gjeneratorë dhe ndriçim në rastet e emergjencave.

## **6.PËRMBYTJET**

### **6.1 Vlerësimi i rreziqeve të mundshme nga përmbytjet**

Territori i Qarkut Vlorë, përshkohet nga një sërë lumenjsh, të cilët janë pasuri për rajonin por shpesh bëhen dhe kërcënim për jetën dhe pasurin e banorëve të zonës.

Lumi kryesor i Qarkut të Vlorës është Vjosa dhe dega e sajë Shushica. (*të dhëna për këtë lumë do të trajtohen më poshtë*).

**Lumi i Shushicës** është i gjatë 80km me një sipërfaqe pellgu ujëmbledhës rreth 715 km<sup>2</sup>. Në rast prurjesh të shumta gërryen sipërfaqe të tokës bujqësore në Drashovicë, në Peshkëpi (*ku bashkohet me përroin e Vllahinës*), në Armen, Llakatund dhe rrezikon toka bujqësore deri në bashkimin e saj me Vjosën. Në përmbytjet e vitit 2015 nga lumi i Shushicës, u krijuan dëme në argjinatura e tokë bujqësore. Dëmtimet ishin më të shumta veçanërisht në toka në territorin e fshatit Armen. Në vitin 2017 dhe në vitin 2018 nuk pati dëme nga dalja e këtij lumi.

**Bistrica** është lum me shtrat në Sarandë dhe në Delvinë, me gjatësi 31.5km dhe me pellg me sipërfaqe 447km<sup>2</sup>, rrezikon fushën e Vurgut.

**Lumi i Kalasës**, është i gjatë 34 km, ka pjerrësi 30/km, gjë që ka krijuar probleme për komunitetin e fshatrave, në derdhjen e saj, duke rrezikuar jetën e njerëzve si dhe të mbjellat. Nda dalja nga shtrati i këtij lumi nga reshjet e dhjetorit 2017, u dëmtua Ura e Vanës, si të mbjella. Ka dhe lumenj të tjerë si Pavlla e madhe, Pavlla e Vogël, Lumi i Delvinës, të cilët kur kanë prurje të mëdha shkaktojnë dëme kryesisht në tokën bujqësore që janë në afërsi të rrjedhjes.

## 6.2 Një vëmendje zonës së Novoselës

Zona Novoselë, me fshatrat; Novoselë, Fitore, Bishan, Poro, Dëllënjë, Mifol, Aliban, Akëri, ka sipërfaqen 137km<sup>2</sup>, 8209 banor rezident, 9440 banor sipas gjendjes civile, 2374 familje (*regjistrimi i vitit 2011*). Është zonë që kërcënohet nga reshjet Nëntor - Mars, veçanërisht nga dalja nga shtrati i Lumit Vjosë.

Lumi i Vjosës është i gjatë 272 km, me një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 6710 km<sup>2</sup>. Prurjet mesatare të Vjosës janë 210m<sup>3</sup>/sek. Prurjet minimale janë në periudhën Korrik-Tetor, ndërsa maksimalet në Nëntor-Mars. Prurjet në fshatin Mifol, në momente përmbetje arrijnë deri në 3600m<sup>3</sup>/sek.

Vjosa hynë në territorin e rrethit të Vlorës pasi kalon shkëmbin e Lunecit, midis Kalivaçit e Shkozës për të vazhduar drejt kësaj të fundit, pastaj përshkon cepin verior të Myzeqesë se vogël dhe fushën e Topalltisë; për tu derdhur në Adriatik, pranë fshatit Dëllënjë, ku edhe formon një delte.

Lumi i Vjosës në fshatrat që përshkon, gjatë stinës së dimrit, me një frekuencë pothuajse një herë në pesë vite, del nga shtrati dhe ka shkaktoar dëme në të mbjella, gjënë e gjallë, por ka rrezikuar dhe jetën e banorëve që kanë shtëpitë afër shtratit të lumit.

Më 31 Dhjetor 1970 –1 Janar 1971, lumi i Vjosës përmbyti gjithë zonën në kufi me Fshatin Nartë; 14000 ha. Përmbytja shkaktoi pothuaj të njëjtat pasoja dhe dëmtime (*dëmtime e shkatërrime të argjinaturave, kanaleve ujitëse, urave, stacioneve të pompave etj.*), madje në disa zona të përmbytjes dëmet u llogaritën edhe më të mëdha se ato të shënuara nga përmbytja e Vjosës në Dhjetor 1962- Janar 1964.

Pasojat e përmbytjes të Vjosës me periudhe përsëritje një herë në një 100 vjet Llogaritën: 8 fshatra, mbi 1469 ndërtesa, sipërfaqe ndërtimi 120380m<sup>2</sup>, 9440 banorë. Kryesisht përmbytjen fshatrat që përfshihen në zonën nga Ura e Mifolit (*ura mbi Lumin Vjosë*) deri në derdhjen e saj në det.

## Probleme për të mbajtur në konsideratë nga Institucioni i Prefektit



**Në se reshjet e rëna në sipërfaqen ujëmbledhëse të Lumit Vjosë, kalojnë 60-70mm shi në 6 orë, DHE nëse era frynë nga deti, DHE ka baticë, duhen të vihen në gadismëri, strukturat e emergjencave civile.**



**Niveli i ujit nga niveli i detit në këmbën e urës së vjetër mbi lumin Vjosë, është 1m më pak se niveli i ujit nga niveli i detit matur në hidrometrin në këmbën e urës Memaliaj.**



**Nëse niveli i ujit nga niveli i detit në këmbën e urës së vjetër mbi lumin Vjosë, është rreth 4m, dhe në zonat Leskovik, Këlcyrë, Gjirokastër, bien reshje, mblidhet Shtabi i Emergjencave Civile. Jepet ALARMI**

**Në shtojcën A, janë të dhënat e reshjeve dhe kuotave në hidrometrin e vendosur në këmbën e Urës Memaliaj dhe në Qytetin e Përmetit. Kujdes! Shifrat e dhëna në këta hidrometra janë relativ dhe nuk shprehin nivelin e ujit nga niveli i detit,**

Kjo situatë përbën atë që quhet **Etapa I** “Alarm për rritjen e gatishmërisë”.

Informacioni i marrë konfirmohet nga më shumë se dy burime, dhe pasi vlerësohet, nga

Institucioni i Prefektit:

1. Informon Ministrinë e Mbrojtjes (*Drejtorinë e Emergjencave Civile*) për situatën që është krijuar. Informon anëtarët e Shtabit të Emergjencës për situatën e krijuar dhe në se situata përkeqësohet mbliidhet Shtabi i Emergjencës Civile. **[Kujtesë! Nga llogaritjet e bëra dhe nga eksperiencia e deritanishme, fronti ujqorë i krijuar nga reshjet; nga Gjirokastra (Viroi) arrin tek ura mbi Lumin Vjosë në Fshatin Novoselë për rreth 12 orë. Fronti ujqorë i krijuar nga reshjet; nga Memaliaj (Ura) arrin tek ura mbi Lumin Vjosë në Fshatin Novoselë, për rreth 7-8 orë.].**
2. Informon popullatën për situatën e krijuar.
3. Informon strukturat vendore, Bashkinë Vlorë, Bordin e Kullimi, Kryqin e Kuq, Rezervat e Shtetit, Delta Forcë, Spitalin, Repartin Bunavi. Njoftohen kryetarët e fshatrave në rrezik.
4. Strukturat vendore nxjerrin persona që monitorojnë nivelin e ujit te ura e Mifolit (Novoselës). Mban nën vëzhgim trasenë e hekurudhës në pjesën Ura-Mifol (Lopa), duke "patrulluar" nga rreziku i çarjes së trasesë. Mbajnë kontakt të vazhdueshëm me monitoruesin e Q. Memaliaj, i njohur në listat e sinjalizimeve.

**Kujtesë!** Në vitin 2005 traseja u ça në afërsi të Stacionit të Trenit dhe uji rrezikoi Fshatin Novoselë, Stacionin e Pompave të Ujit, të pijshëm si dhe arat për rreth kjo ndodhi dhe në reshjet e Dhjetorit të vitit 2017, por u kap në kohë. Detyrë! Duhet lënë një mjet (*ekskavator*) dhe materiale të ngurta për të mbyllur çarjen nëse është e nevojshme.

Kontrollon, 2 portat që bëjnë, të mundur bllokimin e ardhjes së ujit nga pjesa lindore e trasesë në pjesën Ura-Mifol (Lopa). Nëse portat nuk funksionojnë bëhet bllokimi i përkohshëm me materiale të ngurta.

5. Informon institucionet shkencore.
6. Kontrollon mjetet e komunikimit, megafon, celular, radio, telefona, sirena, mjete ndriçuese me bateri.
7. Kontrollon nëse mjetet e transportit janë në gatishmëri.

Nëse gjasat janë që situata të përkeqësohet vlerësohet si e nevojshme për të kaluar në **Etapën 2** "*vendosja e gjendjes së gatishmërisë*". Kjo bëhet kur një ngjarje e afërt konsiderohet e pashmangshme dhe që mund të shoqërohet me dëme në njerëz dhe materiale.

Sipas praktikës së bërë në vitet 2015, 2017 dhe 2018, mjetet e Stukturave Operative dhe Mbështetëse, rreshtohen përball Njësisë Admionisitrative Novoselë, në pritje të detyrave për futjen në veprim. Ndërsa inspektohen nyjet më jetime (kanale, ura e t) dhe ndërhyhet për bllokim apo bllokim.

#### Dëmet në Shkurt 2015

Nr.	Njësitë	Fshati	Nr. fermerve dëme në bujqësi ose blegtori	Vlera e dëmeve në bujqësi (lekë)	Vlera e dëmeve në blegtori (lekë)	Nr. i Familjeve me dëme në orendi dhe banesa	Vlera e dëmeve në orendi e paisje (lekë)	Vlera e dëmeve në ndërtime (lekë)	Persona përfitues nga Kryqi i Kuq
1	Nj. Ad. Novoselë	Novosele	95	3475860	130600	47	8678800	3244500	96
2		Fitore	161	20854050	129000	93	21662970	12879000	140
3		Bishan	100	8598380	432100	19	3626300	2235000	104
4		Akerni	41	12086300	20300	4	808600	358000	96
5		Aliban	10	722500	180000	0	0	0	44
6		Poro	83	4465850	849000	10	1346000	0	47
7		Dëllënj	35	1376600	0	0	0	0	12
8		Delisuf	37	1412750	0	0	0	0	23
9		Mifol	49	2409410	0	17	2779300	1646000	28



10		Trevëllazër	38	1647810	0	0	0	0	0
<b>Shuma Novosele</b>			<b>649</b>	<b>57.049.510</b>	<b>1.741.000</b>	<b>190</b>	<b>38.901.970</b>	<b>20.362.500</b>	<b>590</b>
1	Armen	Armen	10	290830		0			
2		Karbunar	15	348960		0			
<b>Shuma Armen</b>			<b>25</b>	<b>639.790</b>					
1	<b>Shuma Selenicë</b>		<b>15</b>	<b>1.748.130</b>		0			

Dëmet në sera

1900000

Totale

689 59.437.430 3.641.000 190 38.901.970 20.362.500 590

**Totali i dëmeve (në lekë) në bujqësi, blegtori, biznese, banesa dhe orendi 122 342 900**

**Tabela e vlerësimit të dëmeve nga reshjet e 3 Dhjetor 2017 )**

Nr.	Kategorizime	Njësia	Bashkitë							Shuma (2017)	Shuma (2015)
			Vlorë	Selenicë	Himare	Sarandë	Delvinë	Finiq	Konispol		
1.	Familje te evokuara	numër	70	10	1	5	0	0	0	<b>86</b>	507
2.	Banesa me prezencë uji brenda banesës	numër	155	0	0	16	0	0	0	<b>171</b>	
3.	Numri i banesave me prezencë uji në oborr. (jo brenda tyre)	numër	240	10	5	16	0	0	0	<b>271</b>	602
4.	Sipërfaqe e tokës së përmbytur më shumë se 24 Orë (në ha)	ha	300	80	20	0	0	0	0	<b>400</b>	1800
5.	Sipërfaqe e tokës përshkuar nga uji më pak 24 orë	ha	900	0	35	600	0	0	0	<b>1535</b>	3000
6.	Dëme në shpend	krerë	0	20	0	0	0	30	0	<b>50</b>	4000
7.	Dëme në biznese (jo bujqësor)	numër	3	0	0	0	0	0	0	<b>3</b>	46
8.	Dëme në biznese dhe sera e kultura bujqësore të vlerësuara	numër	2	0	0	2	0	1	0	<b>3</b>	260
9.	Fam. kanë marrë ndihma ushqimore, vesh. etj. nga donator lokal	numër	200	0	0	0	0	0	0	<b>200</b>	687
10.	Segm. rrugore me prezencë uji (të kal. me makina të larta)	Km	2	0.2	5	0	0.5	0	0	<b>8</b>	3?
11.	Segmente rrugore të pakalueshme nga prezenca e madhe e ujit	Km	0	0.2	0	0	0	0	0	<b>0.2</b>	3
12.	Familje që përfituan nga KRYQI i KUQ	numër	190	30	0	0	0	0	0	<b>250</b>	597
13.	Familje që përfituan nga donator të tjerë	Numër	192	0	0	0	0	0	0		266
14.	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) për <b>verifikim_Banesa</b>	Numër	195	1	3	16	4	6	3	<b>228</b>	
15.	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të <b>verifikuara Banesa</b>	Numër	190	1	3	16	16	6	3	<b>185</b>	
16.	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) për <b>verifikim_Tokë Bujq</b>	Numër	20	15	2	0	0	0	0	<b>27</b>	
17.	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të <b>verifikuara Tokë Bujq.</b>	Numër	2	15	2	0	0	0	0	<b>17</b>	46
18.	Numri kërkesave/ankesave (me	Numër	3	0	0	2	0	0	0	<b>5</b>	260

	shkrim) për verifikim_Biznes									
19.	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të verifikuara_Biznes	Numër	3	0	0	2	0	0	0	5
20.	Numri shkollave, çerdhe, kopshte të përmbytura më shumë se 1-2 ditë	Numër	0	0	0	0	0	0	0	0
21.	Numri shkollave, çerdhe, kopshte të përmbytura më shumë se 2 ditë	Numër	0	0	0	0	0	0	0	0
22.	Banesa të dëmtuara rëndë me rrezik shembje, rrëshqitje etj (ta pa banuara)	Numër	0	1	5	0		2	0	7
23.	Kërkesa të vlerësuara (për në këshillin bashkiak)	Numër	0	0		6	0	0	0	0

Qeveria Kuvajtiane ka parashikuar: 2000 batanije +1000 kuti ushqimesh (25kg) + 300 pako detergjent (3kg), 50 soba, 50 frigorifer. Njësitë janë në proces të bërjes së listave për ndarje. Qeveria e Izraelit (*nëpërmjet ambasadës*), ka parashikuar rreth 5 000 U\$, ndihma (dyshek, televizor, frigorifer). Njësit janë në proces të bërjes së listave për ndarje.

Janë dhëna ndihma nga nxënësit e shkollave të Qytetit Vlorë për Njësinë Novoselë = 112 pako. Janë çuar në Shkollën Fitore të Njësisë Novoselë, si fshati më i Dëmtuar.

### Monitorimi i situatës dhe veprime gjatë reshjeve; 30 Nëntor – 1, 2 Dhjetorit 2017

Data	Ora	Niveli i ujit në latë[m]			Veprime
		Përmet	Memaliaj	Novoselë	
30/11/2017	11.00	0.3	1.0	3.6	Shënim: Në datën 29 Nëntor 2017. mbledhet Shtabi i Em. Civ. Ndahen detyrat
30/11/2017	16.00	0.4	2.0	3.6	Vendim: Të evakohet gjëja e gjallë. Të dalin mjetet nga katet e nëndheshme
30/11/2017	24.00	1.5	3.8	3.6	Krijohen grupet monit. <b>Moti në Novoselë me reshje të lehta. Nuk ka baticë dhe erë</b>
01/12/2017	03.00	2.8	5.0	3.8	Shkarkohen buletinet dhe ndërtohet tabelat shifrore për krahasim të dhënash
01/12/2017	06.00	3.2	5.5	3.8	Monitorim: Përcillet buletini në njësit vendore deh strukturat përgjegjëse
01/12/2017	08.00	4.0	6.0	4.0	Monitorim: Azhurnohen listat e kontakteve dhe u vihen në dispozicion personave
01/12/2017	11.00	4.5	6.5	4.25	Monitorim: Tendenca në rritje. Jepet urdhri për grumbullimin mjeteve te P. Shtetit
01/12/2017	13.00	4.8	7.6	4.5	Monitorim: Kërkese QKOEK për mjete me shasi të lartë.
01/12/2017	15.00	5.3	7.62	4.55	Monitorim: Punë në terren për inspektimin e të gjithë kanaleve.
01/12/2017	17.00	6.6	7.65	4.8	Monitorim: Kontroll për evakuimin e gjësë së gjallë. Veprime dhe forcërisht
01/12/2017	18.00	7.0	7.75	5.5	<b>Konkluzion:</b> Jemi në kushtet e një kërcënimi i cili do ti kalojë nivelet e vitit Shkurt 2015
01/12/2017	19.00	7.4	8.0	6.0	Urdhër: Grumbullimi i mjeteve te Njësia Novoselë. <b>Alarm!!! Thirrje popullatës!</b>
01/12/2017	19.35	7.5	8.1	6.5	Uji lag tregun e gjase së gjallë. Shtabi vepron në Njësinë Novoselë. Evakuohen 7 familjet
01/12/2017	21.00	7.6	8.2	7.0	<b>Alarm!!!</b> Koha për veprime konkrete. Evakuim të popullatës së F. Fitore. <b>Mbyllen shkollat</b>
02/12/2017	24.00	7.7	8.3	7.8	<b>Alarm!</b> Evakuim qoftë dhe me forcë. Evakuohen 50 familje nga F. Fitore (te të afërmit)

02/12/2017	03.00	8.0	8.5	7.9	Çahet traseja hekurudhore (diga) në F. Mifol (Iejleku). Përforcohet. Uji rrjedh në drejtim
02/12/2017	08.00	7.5	9.0	8.0	Uji mbrin në F. Bishan. Lag me qindra hektar. Raport QKOEK dhe ZOS 2 herë në ditë
02/12/2017	09.00 175	6.2	8.5	8.1	Uji në të njëjtat kuota. Merren masa për furnizimin me bukë dhe ushqime për familjet
02/12/2017	12.00	5.5	7.0	8.0	Mbytet vendi i quajtur Bishti i Malit (Armen). Dëme të tjera në infrastrukturë. Raportime
02/12/2017	13.00	5.3	6.0	7.9	Uji në të njëjtat kuota. Merren masa për furnizimin me bukë dhe ushqime për familjet
02/12/2017	17.00	5.0	5.4	7.8	Uji në të njëjtat kuota. Merren masa për furnizimin me bukë dhe ushqime për familjet
02/12/2017	19.00	4.8	5.0	7.7	Strukturat në terren: Ka një tendencë të lehtë të uljes së nivelit të ujit.
02/12/2017	23.20	4.6	4.8	7.6	Mbrijnë ndihmat e para nga dhoma e tregtisë dhe deputeti
03/12/2017	03.00	4.3	4.7	7.5	Niveli fillon të ulet. Grupe verifikimi në terren
03/12/2017	06.00	4.0	4.6	7.0	Grupe verifikimi në terren. Drejt. Shëbimit Publik në veprime dezinfektimi.
03/12/2017	09.00	3.0	4.5	6.5	Grupe verifikimi në terren. Drejt. Shëbimit Publik në veprime dezinfektimi.
03/12/2017	11.00	3.0	4.3	6.0	Grupe verifikimi në terren. Drejt. Shëbimit Publik në veprime dezinfektimi.
03/12/2017	13.00	2.8	4.0	5.5	Hapen shkollat. Aksione rehabilitimi
03/12/2017	15.00	2.8	3.8	5.0	Aksione rehabilitimi. Lumi shkon në shtratin e vetë
03/12/2017	18.00	2.8	3.8	4.5	Aksione rehabilitimi.
03/12/2017	20.00	2.8	3.8	4.5	Aksione rehabilitimi

**Shënim:** Nga monitorimi i situatës rezulton se maksimumi i prurjeve në Urën Memaliaj, arrinë në Urën Novoselë për afërsisht 7 -8 orë. Maksimumi i prurjeve në Urën Përmet, arrinë në Urën Novoselë për afërsisht 11-12 orë.

**Tabela e vlerësimit të dëmeve nga reshjet e 3 Dhjetor 2017 )**

Nr.	Kategorizime	Njësia	Bashkitë							Shuma
			Vlorë	Selenicë	Himarë	Sarandë	Delvinë	Finiq	Konispol	
1	Familje te evokuara	numër	77							77
2	Banesa me prezencë uji brenda banesës	numër	77							77
3	Numri i banesave me prezencë uji në oborr. (jo brenda tyre)	numër	120							120
4	Sipërfaqe e tokës së përmbytur më shuma se 24 Orë (në ha)	ha	40							40
5	Sipërfaqe e tokës përshkuar nga uji më pak 24 orë	ha	300			5	2			357
6	Dëme në shpend	krerë								
7	Dëme në biznese (jo bujqësor)	numër								
8	Dëme në biznese dhe sera e kultura bujqësore të vlerësuara	numër								
9	Fam. kanë marrë ndihma ushqimore, vesh. etj. nga donator lokal	numër								
10	Segm. rrugore me prezencë uji (të kal. me makina të larta)	Km	0.2				0.1			0.3
11	Segmente rrugore të pakalueshme nga prezenca e madhe e ujit	Km								
12	Familje që përfituan nga KRYQI i KUQ	numër								
13	Familje që përfituan nga donator të tjerë	Numër								
14	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) për <b>verifikim_Banesa</b>	Numër								
15	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të <b>verifikuara_Banesa</b>	Numër								
16	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) për <b>verifikim_Tokë Bujq</b>	Numër								
17	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të <b>verifikuara_Tokë Bujq.</b>	Numër								
18	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) për <b>verifikim Biznes</b>	Numër								
19	Numri kërkesave/ankesave (me shkrim) të <b>verifikuara Biznes</b>	Numër								
20	Numri shkollave, çerdhe, kopshte të përmbytura më shumë se 1-2 ditë	Numër								
21	Numri shkollave, çerdhe, kopshte të përmbytura më shumë se 2 ditë	Numër								
22	Banesa të dëmtuara rëndë me rrezik shembje, rrëshqitje etj (të pa banuara)	Numër								
23	Kërkesa të vlerësuara (për në këshillin bashkiak)	Numër								

## Të dhëna të përmbytjeve në zonën e Komunës Novoselë

Viti	Milimetra shi në 24-orshin e fundit (të përmbytjes)	Niveli i ujit (max në lartësinë të Ura e vjetër (ura e Memalaj)	Niveli i ujit (max në lartësinë të Ura e Përmetit	Niveli i ujit (në metra) të Ura e vjetër (ura e Mifolit)	Banesa të përmbytura	Sipërfaqe e përmbytur (Ha)	Dëme			Era	Batica
							Familje të evakuara	Tokë e përmbytur (mbi 24 orë)	Dëme në banesa		
1962-1963										P	Po
1970-1971								14000		P	Po
2005										P	Po
2010										P	Po
2015	110	>7.5	?	6	507	1800	324	1200		P	Po
2017	120	>7.5	>8				77	200	111	V_P	Jo
2018	120	8	>8				70	150		V_P	Jo

**Tabela e kuotave**

Vendi	Pika referuese	Lartësia nga niveli i detit (m)
Ura e vjetër mbi Lumin Vjosë	Mesi i urës (pika e sipërme)	6.3
Ura lidhëse Levan – Novosele	Mesi i urës (pika e sipërme)	8.2
Ura mbi autostradën Levan Vlorë	Mesi i urës (pika e sipërme)	8.5
F. Novoselë	Porta e komunës	5.2
F. Fitore	Shkolla	5.8
F. Bishan	Shkolla	4.8
F. Poro	Shkolla	2.4
F. Zhuka	Shkolla	2.2
Maja e Akërnisë	Maja më e lartë	25.1
Maja e Mesjasë	Maja më e lartë	16
F. Alibani	Shkolla	7.4
Alibani (grekaj)	Maja më e lartë	7.3
Hekurudha	Në afërsi të komunës	8.1
Pompat e Ujit Novosele	Bazamenti	6.2
F. Mifol	Shkolla	7.1

### Dukuri për tu marrë në konsideratë për parandalime dhe aktivizime gjatë daljes nga shtrati të Lumit Vjosë

Monitorimi dhe vlerësimi i situatës, nëse është në përkeqësim ose përmirësim, gjithmonë vlerësohet nga niveli i ujit në urën e vjetër mbi lumin Vjosë. Kjo për arsyen se lartësia e saj 6.3m mbi nivelin e detit (në pjesën e sipërme të saj) mund të shërbej si krahasim për situatën në zonë, duke e krahasuar me lartësinë që kanë mbi nivelin e detit, fshatrat e zonës (shih tabelën e lartësive) apo diferencën që kanë në lidhje me lartësinë urës. Duhet marrë në konsideratë dhe rrymat që krijohen nga dinamika shumë komplekse gjatë përmbytjeve sidomos pas ndërtimit të autostradës Fier-Vlorë

Duhet marrë në konsideratë këto element të rinj që janë shfaqur pas ndërtimit të autostradës

Fier-Vlorë.

1. Seksioni ujëmbledhës (*largësia e këmbëve të urës*) të ndërtuar mbi autostradë është shumë më e vogël se seksioni urës së vjetër dhe urës mbi të cilën kalon dhe hekurudha.
2. Vetë ngritja e autostradës në pjesën e zonës së Novoselës (Fshati Bishan) edhe pse ka tombino ose nën kalime që ndryshojnë rrjedhën normale të ujërave duke i përqendruar në disa vende dhe kërcënuar veçanërisht fshatin Fitore dhe Bishan.

**Dinamika e rrjedhjes së ujërave.** Nëse Lumi Vjosë del nga shtrati, uji fillimisht përmbyt tregun e gjësë së gjallë në këmbën e Urës së Novoselës, disa banesa mbi këtë urë mbush sipërfaqen e tokës në Fshatin Mifol. Traseja e hekurudhës Fier – Vlorë (*në pjesën lindore të Fshatit Novoselë*) shërben si një pritë e mrekullueshme duke mbrojtur Fshatin Novoselë dhe tokat nën trasenë hekurudhore. Uji përmbyt më pas fillon lagjen dhe përtmbytjen banesave të F. Fitore dhe më pas tokat në kthesën e F. Bishan.

Traseja e hekurudhës Fier-Vlorë, pa takuar urën mbi Lumit Vjosë është projektuar e tillë që të mos pengojë rrjedhjen e ujërave që rrjedhim mbi shtratin e këtij lumi pasi është projektuar dhe ndërtuar në formën e një ure.

E njëjta zgjidhje është bërë dhe në ngritjen e autostradës, por hapësirat për kalimin ujit janë më të vogla dhe seksioni ku kalon uji i Lumit Vjosë, në urën e autostradës është më i vogël se ai i urës që bashkon Levanin me Fshatin Novoselë. Kjo bënë që uji të “pengohet” dhe të rrisë nivelin e tij, duke shtuar kërcënimin për përtmbytjen e fshatit Ferras dhe arat e këtij fshati. Ndërtimi i urës mbi autostradë ka shfaqur një dukuri tjetër të ndryshimit të rrymave duke kërcënuar fshatin Bishan (*gjë që u duk në përtmbytjet e vitit 2015*)

Në vitin 2005, traseja kompakte e hekurudhës e projektuar si digë për të mos lejuar ujin që të vërshoj mbi fshatin Novoselë, në afërsi të stacionit të trenit pësoi një çarje dhe uji i bllokuar nga traseja vërshoi dhe përmbyti Fshatin Novoselë, stacionin e pompave dhe tokat që ndodheshin poshtë trasesë. Reagimi me mjete qe shumë i shpejt duke shmangur një dëm të jashtëzakonshëm në jetë njerëzish dhe pasuri të banorëve. [**Konkluzion!** Duhet mbyllur portat e dy kanaleve vaditës (shih hartën pikat 14 dhe 15), me portat e destinuar për këtë qëllim ose me inerte nëse dështon zgjidhja e parashikuar. Lind nevoja që në të tilla situata të mbahet nën vëzhgim kjo trase si dhe dislokimi në afërsi të stacionit të trenit të mjeteve gërmues dhe transportuese për të ndërhyrë nëse është e nevojshme]

Ujërat që janë mbi shtratin e lumit në anën e fshatrave që i takojnë në juridiksion Qarkut Fier, rrjedhin dhe përmbytin arat në këto fshatra, duke mos u penguar, pasi e tillë është projektuar hekurudha në pjesën e hekurudhës kur vjen nga Levani për në Novoselë. Ujërat pengohen me përplasjen në ngritjen e autostradës duke rritur nivelin e ujit dhe shtuar rrezikun për përtmbytje të tokave dhe banesave të cilat para ndërtimit të autostradës rrezikoheshin më pak. Kjo ndodh për shkak se autostrada është projektuar e tillë vetëm me dy nën kalime.

Një pjesë e ujërave që përshkojnë tokat e fshatit Frakull e etj. ribashkohen përsëri me rrjedhën kryesore të Lumit Vjosë duke kërcënuar fshatrat Fitore, Bishan etj.

Sipas planeve të parapërgatitura, nëse kalohet në Etapa 3 “*Aktivizimi*”, personat që do të evakohen nga banesat e tyre, mund të transportohen me mjete e ushtrisë, publike, private, ose të biznese, për në; ish qytezën ushtarake të aviacionit (Akërni), në Fshatin Mifol (në afërsi të Fabrikës së tullave dekorative) ose në Qendrën Stërvitore Bunavi.

Gjëja e gjallë evakohet nëpërmjet ndihmës së PMNZH, Forcave të Armatosura, Delta Forcë etj. me kontributin dhe të banorëve që kanë cilësi më vitale dhe që njohin vendin nga mund të kalohet.

### **Kujdes!**

Për të mbrojtur fshatin Novoselë, si dhe fshatin Fitore, tokat në afërsi të Stacionit të Pompave (*në afërsi të Stacionit të Trenit*), nga ujërat që mund të çajnë trasenë hekurudhore ose portat në dy vende (*në kohë normale qëndrojnë të hapura*), duhen mbyllur portat që të mos lejojnë ardhjen e ujit të grumbulluar nga traseja e hekurudhës në anën lindore të fshatit Novoselë si

dhe mbajtja nën vëzhgim nga rreziku i ndonjë çarjes së trasesë.

### 6.3 Digat dhe rreziqet

Digat futen në objektet që duhet të mbahen në monitorim për shkak të dëmeve që mund të sjellin, në rast çarjesh por dhe për mund të jenë objekt i goditjes për qëllime terroristë. Lëvizja e lirë e popullsisë mos bindja ndaj ligjeve, ka sjellë që nën diga të bëhen ndërtime, mos funksionimi i shkarkuesve katastrofik të emergjences fare lehtë, këto rezervuarë mund të kthehen një rrezik shumë i madh katastrofik me bazë përmbytjen.

Në qarkun e Vlorës janë 33 rezervuarë nga këta 18 në rrethin e Vlorës dhe 15 në rrethet Sarandë e Delvinë. Aktualisht në Vlorë shfrytëzohen 9 rezervuarë, rezervuarët: Babicë, Kallafet, Kanina- 1, Kanina- 2, Petë, Harvala, Hasamat, Tërbaç.

Pesë rezervuar kanë dalë jashtë funksionit pasi janë mbushur me materiale të ngurta.

Dy rezervuarë, i Vllahinës dhe i Bunavisë, kanë të dëmtuar infrastrukturën e shpërndarjes.

Në Sarandë e Delvinë gjenden këta rezervuarë:

Janjari, Bexhani, Pandlejmon, Sullës, Vec, Karroq, Grava- 1, Grava- 2, Leshnicë, Dhivër, Nivicë, Bajkaj, Gjovrak, Katalat. 50% e këtyre rezervuarve kanë dëmtime si; janë mbushur me aluvione, bllokuar ujëmbledhësi, dëmtime në digë, rrëshqitje të faqes së lagur, dëmtime në faqen e thatë të digës, kapërcen uji mbi kurorë etj.

Kjo situatë kërkon ndërhyrje sa me shpejtë që të jetë e mundur për të parandaluar katastrofa të mundshme.

#### Hidrovoret

**Vlora** 4 hidrovore:

- Akërnisë	5 pompa kapacitet	5m <sup>3</sup> /sek	sip.kullues	6500ha
- Qyteti i Vlorës	4 pompa kapacitet	16 m <sup>3</sup> /sek	sip. kullimit	1500 ha
- Gorica	2 pompa kapaciteti	8 m <sup>3</sup> /sek	sip. kullimi	100 ha
- Orikumi	4 pompa kapaciteti	4 m <sup>3</sup> /sek.		

**Saranda** 2 hidrovore:

- Cuka	5 pompa kapaciteti	7.5 m <sup>3</sup> /sek.	sip.kullimi	920ha
- Butrinti	2 pompa kapaciteti	2 m <sup>3</sup> /sek	sip. kullimi	710 ha

### 6.4 Karakteristikat bazë të përmbytjeve në rast çarje të digave

- Përmbytjet e menjëhershme ndodhin në një kohe të shpejte, ato janë shkatërruese dhe gjithçka mund të ndodhe vetëm në pak orë.

- Viktimat në njerëz dhe dëmet në përmbytjet e menjëhershme shpesh lidhen me shume me shpejtësinë e rrjedhës së ujit, masën e përmbytjeve të ngurta dhe shkatërrimin e masave parandaluese, me tepër se sa nga thellësia e ujit të grumbulluar si rezultat i përmbytjeve.

- Sidoqoftë, nëse ujë i grumbulluar nga përmbytjet mbulon një sipërfaqe me të madhe, ndikim fillestar mund të jetë më i vogël, por një thellësi me e madhe e ujit mund të ketë ndikim shume të madh mbi njerëzit që jetojnë në zone, mbi pronën e tyre dhe do të marre me shume kohe për tu rikuperuar.

- Edhe me plane të suksesshme evakuimi, ujërat e përmbytjeve që qëndrojnë për një kohe të gjatë i lenë njerëzit të shkëputur nga shtëpitë dhe shkaktojnë humbje në gjënë e gjallë, dëme në të mbjella, si dhe sjellin dëmtime të konsiderueshme në infrastrukture.

- Në rastin e digave ujëmbledhëse, sipas situatës, duhet të merren vendime për të hapur portat të cilat shoqërohen me përmbytje lokale gjë që është me e lehte se shkatërrimi katastrofik i strukturës ujëmbledhëse.

- Përmbytjet e vazhdueshme shkaktojnë rënie ekonomike të popullsisë. Disa zona të tilla mund të bëhen të pa përshtatshme për ndërtime të përhershme.

- Në Qarkun Vlorë sistemi i lumenjve kryesisht Vjosa, përben kërcënimin me të madh për përmbytjet.

### **6.5 Faktorët që duhet të merren në konsiderate në lidhje me parandalimin dhe lehtësimin**

- Përmbytjet e menjëhershme lidhën me ndryshimin klimaterik, degradimin mjedisor dhe urbanizimin në rritje.
- Përmbytjet e menjëhershme mund të shkaktohen nga mosmirëmbajtja e kanaleve dytësore ose tretësore, të digave, pritave, argjinaturave etj.
- Pritat kryesore ekzistuese si rezultat i prurjeve të mëdha mund të vendosen në më të presion të madh se sa ishte parashikuar, duke çuar në përmbytje, prishje dhe efekte të tjera në zona që nuk kanë përvojë në mbrojtjen nga përmbytjet ose përballimin e tyre.
- Digat e larta përfaqësojnë rrezik specifik të përmbytjeve nëpërmjet prishjes.
- Menaxhimi i derdhjeve të ujit, kanaleve, lumenjve dhe strukturave të lidhura me ujin shpesh ndahen ndërmjet shume institucioneve dhe strukturave. Bashkërendimi dhe vendimmarrja në nivel lokal është e domosdoshme për të afruar tregues të matshëm gjatë shfaqjes së problemeve si dhe për të parandaluar përmbytjet nga ujërat e grumbulluara në nivele me të larta.
- Zona pa përvojë në lidhje me problemet e përmbytjeve tani do të bëhen me të rrezikshme.
- Planifikimi, përdorimi i tokës dhe sjellja e njerëzve duhet të reflektojnë në drejtimin e duhur për uljen e rrezikut të përmbytjes.

### **6.6 Faktorë për tu marrë në konsideratë në fazën e përgatitjes dhe të mbrojtjes.**

- Informacioni i bashkërenduar, sistemi i paralajmërimit i vendosur më parë dhe plani i informimit publik janë shumë të rëndësishëm për të shpëtuar jetë dhe prona në zonat me rrezikshmëri të lartë.
- Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për një plan evakuimi nëse do të jetë e nevojshme, si dhe duhet të jenë të ndërgjegjshëm për zonat e identifikuara të strehimit të sigurt.
- Plane specifike për evakuim të shpejtë të popullsisë që jeton në afërsi të digave të mëdha janë masa shumë të rëndësishme sigurie.
- Planifikimi duhet të përfshijë si prioritet ofrimin e shërbimeve bazë publike duke përfshirë ujin dhe shërbimin shëndetësor parësor. Publiku duhet të këshillohet të konsumojë ujë të pastër ujë ose ta zije atë për 10 minuta dhe që të mos inkurajojnë fëmijët që të luajnë në ujërat e përmbytjes.
- Shërbimet dytësore dhe tretësore të kujdesit shëndetësor duhet të kenë plane gatishmërie duke marrë në konsideratë një numër të rritur pacientesh si rezultat i efekteve të përmbytjeve si dhe për sigurimin e sistemit të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm për një kohë të caktuar.
- Në varësi të kushteve dhe situatave të paparashikuara, në nivelin lokal duhet të mirëmbahen inventarë me makina të larta, barka të përshtatshme shpëtimi dhe pajisje të tilla si mushama shiu, pompa uji dhe rezervuarë të cilët mund të përdoren gjatë situatave të përmbytjeve.
- Kontaktet me shërbimin më të afërt të kërkim- shpëtimit personat me rrezik dhe informacione të tjera të jenë të përditshme.

### **6.7 Faktorët që duhet të merren parasysh gjatë fazës përgjigjes ndaj emergjencës**

- Nevoja e menjëhershme është evakuimi në kohe dhe i organizuar të popullsisë së prekur ose të kërcënuar në zonat e sigurta dhe, nëse është e nevojshme dërgimi i tyre në streha të sigurta.
- Dhënia dhe marrja e informacionit për popullsinë e dëmtuar është shumë e



rëndësishme në këtë fazë. Personat që mungojnë duhet të identifikohen me emër dhe vendndodhja e tyre e fundit duhet të jetë e saktësuar. Nëse është e nevojshme, duhet të ndërmerren operacione kërkim- shpëtimi sa më shpejt që të jetë e mundur.

- Furnizimi me pajisje për strehim, ujë të pijshëm, racione ushqimi dhe batanije dhe m)ha të ngrohta do të nevojiten shumë shpejt për popullsinë e prekur. Në këtë kuadër duhet të përcaktohet një plan i barabartë shpërndarjes dhe kriteret të qarta për gjithë.
- Vlerësimi i mjedisit dhe ndikimi i tij mbi shëndetin duhet të bëhet menjëherë duke përfshirë zonat dhe burime të tjera të kontaminuara dhe publiku duhet të informohet sa më mirë të jetë e mundur mbi rreziqet dhe faktorët që duhet të mbahen parasysh gjatë procesit të kthimit të tyre në shtëpi.
- Në këtë periudhë mund të jetë ende e nevojshme të ofrohen furnizime të përkohshme me ujë (duke përfshirë dhe furnizimin me autobote e çisterna) për në periudhë afatshkurtër për popullsinë e prekur, edhe kur ata janë kthyer në shtëpi.

### **6.8 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë rikthimit në gjendjen normale**

- Dëmtimi fizik i ndërtesave dhe infrastrukturës duhet të vlerësohet dhe të analizohet si një bazë për rimëkëmbjen. strukturat e dëmtuara të furnizimit me ujë dhe e mbrojtjes së tij duhet të riparohen dhe të rikthehen të paktën të njëjtin standard si përpara përmblytjeve, dhe mundësisht të zhvillohen për të përballuar përmblytje edhe më të madhe në të ardhmen.
- Vetëm pasi zona të jetë konsideruar e mbrojtur dhe e sigurve, mund të fillojë rikonstruktimi dhe rehabilitimi i shtëpive dhe i ndërtesave publike.
- Rehabilitimi është një mundësi për të përmirësuar funksionet fizike dhe strukturore të ndërtesave. Ndërtimi i mureve dhe argjinaturave pritëse mund të ulë rastet e përmblytjeve serioze.
- Përmblytjes duhet t'i bëhet një rishikim në nivelin lokal, duke nxjerrë në pah shkaqet, qofshin ato natyrore ose njerëzore si dhe për mënyrën e drejtimit dhe të zhvillimit të operacioneve për përballimin e emergjencës.
- Përfundimet që do të dalin gjatë rishikimit, do të çojnë drejtpërdrejtë në iniciativa për parandalimin dhe lehtësimin e situatave duke përfshirë identifikimin me të mirë të përgjegjësive për mirëmbajtjen e kanaleve, të stacioneve të pompimit, dhe në përgjithësi, të masave mbrojtëse dhe parandaluese.

## **7. BLOKIMET NGA DËBORA RRËSHQITJA E TOKËS**

### **7.1 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga dëborat e madhe**

Dëborat është një fenomen jo i zakonshëm në qarkun e Vlorës nëse përjashtojmë zona të veçanta. Në Rivierë, Orikum, Himare, Sarandë dhe në qytetin e Vlorës, dëborat është një dukuri shume e rrallë. në zonat malore (Çike, Mali i Kudhësit, Llogora dhe zona të tjera malore), është një dukuri normale dhe shpesh fillon që në nëntor. Trashësia e dëborës në zonat malore të qarkut, kryesisht në zonat që rrezikohet të bllokohet qarkullimi me mjete si në Qafen e Llogorasë dhe në Qafen e Muzinës në disa raste ka arritur deri në 50 cm.

Strukturat planifikuese, menaxhuese dhe vendimmarrëse kanë nevojë për këto informacione:

- Zonat ku pontecialisht pritet bllokimi dhe kushtet në të cilat ndodhet bllokimi.
- Nëse bllokimi ndodhe, sa do të zgjatë ai.

Trashësia e mbulesës së dëborës prej 10 cm sjell një shtresë akulli me trashësi 5 mm, që është e mjaftueshme për të ndërprerë trafikun normal dhe prek, madje pengon në zonat malore operacionet e emergjencës. Megjithatë, grumbullimi i dëborës rreth 25- 30 cm e bllokton tërësisht qarkullimin e makinave të zakonshme. në raste se nuk bëhet pastrimi rregullisht prej dëborës, sidomos në Llogora dhe në Qafen e Muzinës trafiku për mjetet e zakonshme edhe mund të ndërpritet përkohësisht deri në pastrimin e segmentit të rrugës së bllokuar. Eksperienca e dhjetor 2016 - janar 2017, tregoi se në rast se ka vlerësim të situatës arrihet të

mbahet në kontroll dhe normalitet të të gjithë sistemit rrugor të qarkut. Në 11 Janar 2017, nga acari që përfshiu gjithë rajonin u shënuar **temperatura minimale -14C°** në Qafën e Llogorasë (1027 m) duke zgjeruar pranin e dëborës dhe akullit nga 11Km në 32Km (*deri në fshatin Palasë*)

## **7.2 Vlerësimet e rreziqeve të mundshme nga rrëshqitjet e tokës**

Në qarkun Vlorë ka disa zona që karakterizohen nga paqëndrueshmëria e tokës dhe që shkaktohen nga veprimi mekanik i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, rrëshqet, veprimi sizmik, ndërhyrjet ndërtimore në sistemin e kodrave që rrethojnë qendrat urbane, ndërtimi i rrugëve, shpyllëzimet pa kriter etj.

Paqëndrueshmëria e tokës në qark vjen kryesisht pas shirave të rrëmbyeshëm.

Sipas llojit të paqëndrueshmërisë së tokës, kemi këto veçori:

Rënia e shkëmbinjve është karakteristike e zonës Vlorë-Orikum, Palasë-Vuno. Në këtë segment rrugor në afërsi të Jonufrës (*Hotel Nimfa*), si rezultat i ndërtimeve abuzive, në shpatin e Malit Shashicë, është dëmtuar struktura dhe sa herë që bie shi ka rënie të formacioneve shkëmbore duke bllokuar dhe rrezikuar qarkullimin.

Rrëshqitjet me zhvendosje ose fundosje, janë evidente përgjatë vargut të kodrave që quhet ndryshe kurora e Vlorës. Segmenti rrugor fshati Dukat- Llogora, dhe rruga Lezhan- Mallkeq (segmenti në afërsi të Ujëmbledhësit të Harvalasë).

## **8. ZJARRET NË PYJE**

### **8.1 Struktura e pujeve në Qarkun Vlorë**

Pyjet yjet në Qarkun e Vlorës zënë një sipërfaqe rreth: 59108 ha.

Rrethi i Vlorës ka rreth:	30000 ha pyje të ndare:
Halore:	5200 ha;
Fletorë trungista:	2600 ha;
Fletorë cungishte:	6600 ha
Shkurre:	14500 ha

Zonat kryesore në rrethin e Vlorës me pyje janë:

Pish Poro me sipërfaqe:	1200 ha halore
Parku Kombëtar Llogara:	1010 ha halore
Pylli i Sodës:	531 ha halor
Ana e Lumit Vjosë:	150 ha halore
Himara:	269 ha trungishte
Brataj- Kuç:	1300 ha trungishte nga këto: 480 ha halore

Në rrethin e Delvinës pylli në zonën e Syrit të Kaltër ka një sipërfaqe: 180 ha (*kryesisht me dushk*)

Në rrethin e Sarandës, rajone të pyllëzuara janë; Mali i Miles, Qafa e Soronës, Pylli i Stavroit, Mali i Lasaresë, Pylli i Kakomesë, Mali i Sarandës

Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit zjarret në pyje në Qarkun Vlorë, janë shtuar jo si numër, por është rritur shume dhe sipërfaqja e prekur nga zjarri. (*Bashkangjitur është tabela me zjarret deh dëmet përkatëse*)

Në vitin 2017 është dëmtuar një sipërfaqe prej 1922ha kullota, 1009ha pyll, 1454 rrënjë ulinj dhe 1154 të tjera (arrë, lajthi etj) me një dëm ekonomik 8 129 522 752 lekë, përjashtuar shepnzimet për avionët dhe forcat e armatosura të nagazhuar për fikjen e zjarreve.

Shkaqet kryesore të zjarreve janë veprimtaria njerëzve, djegia për kullota. Zjarret e vëna në vitin 2017, nuk përjashtojnë mundësin e akteve për dëmtimin e turizmit, akteve terroriste dhe

piromania. Shumica e dëmeve ndodhin në pyjet halor. Keqpërdorimi i pyjeve nga njerëzit shoqëruar me shpyllëzim gjatë viteve të fundit dhe praktikat e kullotjes, kanë shkatërruar pjesën më të madhe të pyjeve.

#### **Dëmet nga zjarret gjatë vitit 2017**

Zjarre gjithësej	156
Forca të angazhuara	1783 (administrata + forcat zjarrfikse)
Forcat e armatosura	>200
Aksione me Avion	15
Fluturime për fikje	>200 (një fluturim për fikje llogaritet me kosto mbi 500 Evro)
Kullota të djegura	1922Ha
Shkurre	50 Ha
Sip. Pyje	1454Ha

Kullotja e pakufizuar dhe zjarret e pa kontrolluara, të shkatërruar aksidentalisht dhe shpesh për shkak të djegies me qëllime për pastrim kullotash, vazhdojnë të ndodhin në qark.

Qarku i Vlorës vitet e fundit ka qenë me problematiku në shkallë vendi, përse i përket dendësisë së zjarreve duke pasur mesatarisht 50 zjarre në vit.

Masat për menaxhimin e zjarreve, që duhet të përforcohen nga shërbimi pyjor tashëm kaluar në administrimin e bashkive, në qark janë:

Vënia në punë e një sistemi vrojtimi dhe sinjalizimi, vigjilencë për raste zjarri gjatë gjithë periudhës së shtimit të rrezikut të zjarreve dhe ndërtimi i pritave kundër zjarreve mbeten detyra në vazhdimësi.

Në pyjet me rrezik zjarri kryesisht në Parkun e Llogorasë, në pyllin e Pish Poros, të Sodës dhe të Syrit të Kaltër ka rrjet vrojtimi e sinjalizimi që përdoret nga shërbimi pyjor gjatë stinës së zjarreve. Infrastruktura në dispozicion dhe pajisjet për shuarjen e zjarreve do të vijë duke u përmirësuar. Në shtojcë

#### **8.2 Karakteristikat bazë**

Zjarret shpesh janë ngjarje të një shkallë më të vogël, që kanë një ndikim dramatik mbi jetën dhe pronën. Përfshirim përbejnë zjarret që mbulojnë sipërfaqe të mëdha shkurresh ose pyje ku përfshihen dhe zona të banuara, pasi këto të fundit mund të shkaktojnë shkatërrim në një zonë të gjerë.

Shkaqet kryesore të zjarreve vijnë nga njerëzit duke përfshirë neglizhencën, aktivitetet bujqësore të kontrolluara jo ashtu si duhet si për shembull djegia e kullotave, aksidentet dhe vëniet e qëllimshme të zjarrit.

Si rezultat zonat specifike të rrezikut janë lehtësisht të identifikueshme ndërkohe që parandalimi, lehtësimi, mbrojtja dhe parapërgatitja janë të mundura dhe mund të kenë efekte të ndjeshme për uljen e rrezikut.

Në këto rastet e zjarreve që përfshijnë sipërfaqe të tëra, rezultatet janë shumë të vështira për t'u kontrolluar, qofshin këto zjarre të shkaktuara nga njerëzit ose zjarre natyrore dhe drejtimi i erës është një faktor i veçantë në paparaslehtëshmërinë e tyre.

Në qarkun Vlorë rreziku më i madh i zjarreve të pyjeve është evident në fund të pranverës dhe gjatë periudhave të verave të thata. Që prej 1992- it rreziku i zjarreve të pyjeve në Qark është rritur në mënyrë të konsiderueshme si në shpeshësi ashtu dhe në përfshirje të zonave të prekura.

#### **8.3 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parandalimit dhe lehtësimit**

Faktorët e parandalimit si fushatat e ndërgjegjësimit publik dhe institucional mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në uljen e rrezikut. Këto fushata mund të ndërmerren në nivel rajonal ose në nivel lokal, sipas nevojave specifike të rreziqeve në zonën përkatëse.

- Publiku dhe institucionet duhet të jenë të ndërgjegjshëm për legjislacionin ekzistues që

ndalon ndezjen e zjarreve në zonat me rrezik të larte dhe rregullat duhet të jepen si mesazhe të thjeshta.

- Një sistem serioz patrullimi ndihmon në vendosjen e ndërgjegjësimit dhe zbatimin e legjislacionit.
- Mund të nevojiten ndryshime në praktikën bujqësore për sa i përket rreziqeve në rritje.
- Alternativa, opsione dhe udhëzime mund të jenë të nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin për mos djegien e kullotave në periudhat kur rrezikshmëria është e lartë.

#### **8.4 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parapërgatitjes dhe mbrojtjes**

- Inkurajimi dhe zbatimi i masave ekzistuese të mbrojtjes si për shembull barrierat për parandalimin e zjarrit, kullat për monitorimin e pyjeve dhe një sistem patrullimi i përforcuar për pyjet është çelësi për mbrojtjen e zonave të mëdha nga zjarret.
- Mbështetja dhe përforcimi i një rrjeti permanent ekzistues të mbikëqyrjes sinjalizimit (*me disa kulla zjarri në rrethe*) jep këtë përgjigje esenciale të hershme.
- Investimet, trajnimi dhe përdorimi racional i teknikës, mund të çojnë në përballim të situatës përpara se kjo e fundit të mos mund të kontrollohet nga njeriu.

#### **8.5 Faktorët për t'u marrë parasysh gjatë fazës së përgjigjes**

Shpejtësia e përgjigjes është faktori përfundimtar në parandalimin e zjarrit në një pyll të vogël ose zjarrit në shkurre për të mos marre përmasa e një emergjence civile.

- Drejtimi i zjarrit është shume i paparashikuar dhe e gjithë popullsia vendase ose e përkohshme në çdo rast duhet të përgatitet për t'u evakuar. Evakuimi duhet të bëhet mundësisht sipas planeve të gatishmërive ekzistuese dhe të testuar.
- Duhet të identifikohen dhe të parapërcaktohen zonat e sigurta për evakuimin së bashku me rrugët e sigurta për të shkuar në ato zona që ekzistojnë ose që janë dhënë si mundësi.
- Publiku dhe institucionet duhet të mbahen të mirinformuara nëpërmjet mjeteve të nevojshme (si për shembull stacioneve lokale të radiove) dhe duhet të lejohen ose të inkurajohen që të kthehen në shtëpitë e tyre kur situata të jetë përsëri absolutisht e sigurt.
- Në emergjencat e zjarreve të një madhësie të konsiderueshme, kërkohet ndihmë në qarqet fqinjë dhe në qendër.

#### **8.6 Faktorët për tu marrë në konsideratë gjatë fazës së rikthimit në gjendjen normale**

- Dëmtimet në lidhjet e transportit, energjisë elektrike dhe telekomunikacioneve duhet të jenë me përparësi për t'u rregulluar, sapo situata të jetë e sigurt për të bërë një gjë të tillë.
- Situata duhet të monitorohet nga afër për shpërthime të papritura të vatrave të zjarrit fillestar ose të zjarreve dytësore, që ndodhin nga i njëjti shkak fillestar ose nga materialet djegëse që zhvendosen nga era.
- Kthimi i situatës në normalitet sjell mundësi për të mësuar nga një rishikim i plotë i shkaqeve dhe ndikimit të asaj se çfarë ndodhi, duke analizuar rëndësinë e paralajmërimit në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme si dhe përgjigjen e duhur.
- Humbja ekonomike që vjen si rezultat i zjarrit, duhet të paraqitet me koston e mundshme të lehtësimit kundrejt një situatë të përsëritur, si mjet për të kërkuar investime për parandalimin.
- Etapa e menjëhershme e pas ngjarjes, mund të paraqesë një mundësi për të aplikuar për burime shtesë për parandalimin, lehtësimin dhe mbrojtjen.

## **9. RREZIQET TEKNOLOGJIKE/INDUSTRIALE DHE NDOTJA DETARE**

### **9.1 Karakteristikat Bazë**

Situatat e emergjencave teknologjike mund të vijnë nga shkaqe të ndryshme të objekteve

industriale, si për shembull prishja e minierave, rafineri, depozita të karburanteve dhe të materialeve të rrezikshme të tubacioneve ose të instalimeve të ndryshme, në komplekse industriale ku përdoren lende të cilat, në gjendje të lire ose në këmbim me njëri tjetrin, mund të shkaktojnë zjarre, ndotje, eksplozion etj, ose nga një efekt dytësor i një fatkeqësie natyrore si për shembull një goditje sizmike, rrëshqitje dhe ose përmbytje serioze.

Qarku Vlorë, si rajon i kufizuar me det çdo dukuri nga të lartë përmendurat e japin efektin në ndotjen e ujërave të lumenjve përenjëve të cilat përfundojnë në det. Ndotjet detare mund të vijë dhe si rezultat i aksidenteve detar, neglizhencave, veprimtarive të pandërgjegjshme të efektivave të anijes, deri në veprime terroriste, Masat për parandalimin, ndërhyrjen dhe normalizimin situatës e zë një plan i veçantë i përpiluar me asistencën e QNOD-s. Plani ka saktësuar skemën e lajmërimit, ndarjen e përgjegjësive si dhe kapacitetet që ofrojnë të gjitha strukturat.

**Ka një plan të veçantë bërë në bashkëpunim me Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, që vlerëson masat si para ndotjeve detare, si dhe ndanë përgjegjësit në rast se jemi para një situatë emergjente.**

Një ndër shtatë vatrave më të ndotura në nivel vendi ish zona e ish fabrikës së Sodës. Tashme si rezultat i një projekti është bërë grososja e zhivës sidoqoftë nuk përjashtohen dhe vatra të vogla që nuk janë arritur të kapen.

- Rreziqet teknologjike janë shqetësime për emergjencat mjedisore dhe për emergjencave potenciale civile.
- Përfshirja e një rreziku teknologjik brenda një situatë ekzistuese të një fatkeqësie natyrore mund të krijojë një mjedis shumë të papërshtatshëm për fazën e përballimit.
- Kërcënimi drejtpërdrejt mund të marrë formën e zjarreve, shpërthimeve, ujit të kontaminuar rëndë, rrëzimit të ndërtesave, prishjes së minave ose ndërtesave të tjera të ngjashme, dhe lirim të gazrave helmuese.
- Kufizimet ekonomike mund të mos lejojnë përshtatshmërinë dhe rritjen e sigurisë së burimeve ekzistuese industriale, por parapërgatitja dhe organizimi për mbrojtjen dhe përballimin mund të ulin në mënyrë të ndjeshme efektet e një emergjence të një natyre të tillë.
- Në qark megjithëse prodhimi industria! ka renë ndjeshëm që prej vitit 1991, përsëri rrezikshmëria ekziston, po të kemi parasysh ndotjet nga industria nxjerrëse e naftës në Gorisht dhe ujërat që shoqërojnë këtë lloje industrie.
- Në rajonin e Qarkut Vlorë, shqetësim është ndotja e ujërave nëntokësor dhe sipërfaqësor nga pesticide e ndotje të tjera.
- Zona të ndotura ku në mënyrë kategorike nuk duhet pasur kontakt me to në një distancë 400 m, janë zonat ku derdhën ujërat e zeza në det, në Vlorë e Sarandë. Masat që do të merren në të ardhmen për përpunimin e ujërave të zeza do ta zgjidhin përfundimisht ndotjen e kësaj zonë me prioritet turizmin detar.

## **9.2 Faktorët për t'u marrë në konsideratë në fazën e parandalimit dhe lehtësimit**

- Identifikimi i zonave të rrezikuara në nivel lokal, është i rëndësishëm për të planifikuar masat e nevojshme.
- Planet e Emergjencave civile dhe të gatishmërisë të niveleve të ndryshme duke përfshirë dhe sistemin e lajmërimit- evakuimit të punonjësve brenda objekteve dhe komunitetit në afërsi të tyre, jenë të dobishme në një situatë të tillë
- Një plan në nivel qarku dhe bashkie, me kërkesa për instalime të sigurt ndihmon për caktimin e përparësive sipas rrezikut që paraqesin për popullsinë dhe mjedisin. Përveç burimeve të kufizuara, në këtë mënyrë, të paktën kërcënimet më të mëdha mund të reduktohen një nga një në varësi të fondeve të caktuara për këtë qëllim.

### **9.3 Faktorë për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së parapërgatitjes dhe mbrojtjes**

- Përballimi direkt i fatkeqësive teknologjike është një punë shumë e specializuar të cilën mund ta bëjnë vetëm njësi të kualifikuara ose me përvojë.
- Përvuqevakuimit të planifikuar të popullsisë mund të dalin dhe detyra të tjera që mund të mos jenë parashikuar. Parashikimi i efekteve dytësore të mundshme duhet të jetë bazë për planifikimin e ndikimit maksimal të fatkeqësisë. Mjaft struktura mund të përfshihen në sigurimin e popullsisë dhe të mjedisit. Në këtë drejtim koordinimi i fortë i përgjigjes është shumë i rëndësishëm..

### **9.4 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së përgjigjes**

- Evakuimi i menjëhershëm i popullsisë së prekur dhe popullsisë që ka mundësi të preket, është shumë i rëndësishëm. Sistemet e paralajmërimit publik dhe të informacionit duhet të mirëmbahen dhe të funksionojnë gjatë të gjithë kohës.
- Inspektoratet dhe policitë përkatëse duhet të jenë të pranishme gjatë vlerësimit dhe përballimit të situatës së krijuar.
- Sipas situatës, mund të kërkohet prania e skuadrave shumë të specializuara të kërkim-shpëtimit për të nxjerre njerëzit e bllokuar nga fatkeqësia.
- Duhet të merret në konsideratë edhe evakuimi i shpejtë në objektet shëndetësore i personave që kanë nevojë për trajtime të ndryshme, duke përfshirë djegiet ose komplikacione të tjera të cilat janë planifikuar në mënyrë specifike.
- Kërkohet një vlerësim i menjëhershëm teknologjik për të përcaktuar efektet ekzistuese dhe efektet potenciale, duke përfshirë dhe ndotjen e mjedisit.
- Shkaku fillestar i ngjarjes duhet të stabilizohet dhe duhet të bëhet i sigurt ose më i sigurt përpara ndodhjes së fatkeqësisë. Skenari i përsëritjes duhet të shmanget.
- Shkaku fillestar i ngjarjes duhet të stabilizohet dhe të bëhet i sigurt ose më i sigurt se përpara ndodhjes së fatkeqësisë.
- Efektet dytësore duhet të minimizohen, duke synuar koordinimin me të mirë të mundshëm të strukturave dhe institucioneve përfshira.
- Shërbimi shëndetësor, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit mund të kërkojnë mbështetje shtesë të menjëhershme. Burimet e mundshme të mbështetjes duhet të jenë një element kyç në planet e gatishmërisë në nivel lokal dhe rajonal.

### **9.5 Faktorët që duhet të merren parasysh në fazën e rikthimit në gjendjen normale**

- Popullsia e evakuuar duhet të mbahet e informuar mbi rreziqet derisa kthimi të jetë i sigurt. Këtu përfshihen rreziqe si ai i lidhur me zona të kontaminuar.
- Sipas situatës mund të ketë raste kur një popullsi e ka pasur të pamundur që të kthehet në shtëpi e siguruar, dhe në këto raste duhet të parashikohen mundësi alternative të përshtatshme.
- Është shumë e rëndësishme që të vlerësohen ndikimet e konsiderueshme në numër, ndikimet afatgjata mjedisore, dhe ndikimet mbi kafshët e egra, gjënë e gjallë, burimet ujore, dhe të mbjellat.

## **10. RREZIQET NGA AKTET TERRORISTE DHE TË DHUNSHME**

### **Sulmi Terrorist**

Shteti Shqiptar si anëtar i NATO-s, kontribues në misionet paqeruajtëse në disa shtete, është në listën për sulme terroriste. Qarku Vlorë, si pjesëmarrës në misionet paqeruesjtëse me trupa dhe me anije patrullimi, mund të jetë në shënjestër nga aktet terroriste. Nisur nga përmasat që ka marrë terrorizmi në arenën ndërkombëtare, nuk përjashtohen mundësitë e “importimit” nga jashtë të koncepteve për veprime terroriste.

- Prania e armëve dhe mjeteve të tjera luftarake në familje nga hapja e depove në vitin 1997, përbën një kërcënim për akte terroriste të shkarkuara kundër individëve ose grup individësh.
  - Aktiviteti i paligjshëm dhe kriminal i grupeve të ndryshme shoqërohet dhe me akte të dhunshme kundër individëve ose institucioneve
- Në planet e emergjencave civile përballja me terrorizmin përbën një skenar të mundshëm që trajtohet në skenarët gjithë vjetor.
- Në bashkëpunim me strukturave vendore që përgjigjen direkt (*Policia e Shtetit, Policia Bashkiake, Shish etj*) është bërë një ndarje përgjegjësisë dhe detyrash në lidhje me objektet sensitiv dhe vendeve të mundshme të ekspozimit.

### 10.1 Karakteristikat bazë

Ekspertiza për aktet terroriste dhe parandalimi i tyre realizohet nga një punë shumë e specializuar, ku përfshihen shërbimet e inteligjencës (shërbimet sekrete), njësi të specializuara të policisë dhe forcave të armatosura dhe shpesh edhe rrjetë ndërkombëtare të specializuara. Si rezultat, këto çështje janë jashtë përgjegjësive dhe parametrave të punës së atyre që merren me çështjet e emergjencave civile.

Sidoqoftë, në rast të ndodhjes së ndonjë akti terrorist mbi objekte ose mbi njerëzit, atëherë janë mekanizmat e përballimit të emergjencave civile të cilat duhet të përgjigjen në të njëjtën mënyrë si në rastet e fatkeqësive natyrore.

Eksplodimet mund të kërkojnë ndërhyrjen e menjëhershme të grupeve të kërkim- shpëtimit dhe menaxhimit të dëmtuarve në mase për të shpëtuar jetët e njerëzve në të njëjtën mënyrë si në rastin e një tërmeti të vogël. Në mjaft situata kërcënuese terroriste janë dashur evakuime të shpejta dhe masive të njerëzve për tu siguruar nga kërcënimet e mundshme madje edhe nga një paralajmërim.

Sidoqoftë ka faktorë të veçantë shtesë që duhet të merren parasysh, duke përfshirë sulmet dytësore pas një sulmi që nga pamja e jashtme duket si kryesor, si dhe ngjarje jo të zakonshme si për shembull sulmet me arme të shkatërrimit në mase (ASHM), për të cilat nuk ka shume përvojë.

Duke u nisur nga natyra e tyre, sulmet terroriste zakonisht ndodhin pa paralajmërim, ose me një lajmërim në momentin, e fundit, por mund të pasohen nga një numër ngjarjesh të lidhura, dhe ndonjëherë dhe të koordinuara që shkaktojnë panik dhe stresse të mëdha.

### 10.2 Faktorët për t'u marre parasysh gjatë fazës së parandalim dhe lehtësimit

- Parandalimi është detyrë e strukturave dhe institucioneve të specializuara.
- Sidoqoftë, detyra për të koordinuar strukturat peri përballimin e emergjencave civile do të jetë kurdoherë detyrë e strukturave të shërbimit të emergjencave civile.
- Si rezultoi koordinimi i përballimit të situatës mbetet çelësi i suksesit, ndërkohë që rrjedha koherente e informacionit dhe fushatat e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe e strukturave përkatëse janë kurdoherë të domosdoshme. në këtë mënyrë duhet të inkurajohen strukturat përkatëse dhe publiku i gjerë që të jenë sa me të përgatitur për çdo emergjence civile duke bere që të lehtësojë ndikimin mbi jetën dhe pronën.
- Sulmet terroriste janë kaq shume të pa parashikueshme kështu që para pëlqehet planifikohet në të njëjtën mënyrë si për çdo emergjence civile tjetër në mënyrë që të jetë e mundur që të kalohet në këto plane, nëse një situatë e tillë bëhet realitet. Procedurat e evakuimit, planet, informimi i publikut, identifikimi i strehimit të sigurve dhe asistencë humanitare për emergjencat, mbështetja logjistike dhe të gjitha përgjegjësitë e tjera të lidhura me to duhet të merren nga Zyra e emergjencave civile dhe nga planet e emergjencave (gatishmërisë) të përgatitura në nivel lokal.

### **10.3 Faktorët për t'u marre në konsiderate gjatë fazës së përgatitjes dhe të mbrojtjes**

- Sulmet terroriste shpesh nuk kanë paralajmërime, megjithëse mund të ndodh të bëhen lajmërime në minutën e fundit. Në raste të tillë mobilizimi i shpejtë i forcave operacionale duhet të aktivizojë strukturat përkatëse si dhe për rastet e fatkeqësive natyrore. Zakonisht përparësi kanë evakuimi i shpejtë dhe i sigurt dhe izolimi i zonës së kërcënuar.
- Për ndërgjegjësim publik në lidhje me kërcënimet terroriste është e nevojshme të merret një vendim nga instancat e larta qeveritare. Marrja e këtij vendimi për rritjen e gatishmërisë pra rritja e vigjilencës dhe e njohurive të publikut mbi atë çfarë duhet të bëhet në raste të tilla, ka një rëndësi shumë të madhe pasi në këtë mënyrë shpëtohen jetë njerëzish. Këto aktivitete duhet të bëhen në të njëjtën mënyrë si për rastet e tërmeteve ose të përmbytjeve. Si rezultat duhet të ndërmerren të gjitha mënyrat për angazhimin e përbashkët të publikut dhe institucioneve në këtë drejtim. Shkollat, administrata publike, spitalet, subjektet private, media lokale dhe publike duhet që të angazhohen për të transmetuar mesazhe të thjeshta dhe koherente nëpërmjet të gjitha mjeteve të komunikimit, duke u bazuar në njoftimet zyrtare.
- Planifikimi për përballimin e emergjencave në nivel vendor përfshirë dhe planet specifike të përgatitura të përgatitura për fatkeqësitë natyrore, do të aplikohet dhe në rastin e një akti terrorist.
- Praktikimi dhe testimi i planeve nëpërmjet stërvitjeve është me shumë vlerë edhe në një situatë sulmi terrorist.

### **10.4 Faktorët për t'u marre në konsideratë gjatë fazës së përgjigjes**

- Veprimet e menjëhershme të kërkim - shpëtimit ndërmerren kryesisht nga komunitetet e prekura, ku pjesa më e madhe e njerëzve shpëtohen nga familjet, miqtë ose fqinjët.
- Trajtim i menjëhershëm mjekësor do të nevojitet për t'ia ofruar të plagosurve. Një fatkeqësi e një përmase të madhe do të kërkojë angazhimin e gjerë jo vetëm të kapaciteteve lokale por edhe atyre kombëtare.
- Bëhet gjithashtu dhe një vlerësim i shpejtë i sigurisë së objekteve si dhe për dëmet dhe nevojat me emergjente.
- Mbajtja e rendit publik dhe dhënia e një informacioni të janë shumë të rëndësishëm për të vendosur qetësinë dhe për të ulur përshtjellimin e mëtejshëm që të mos shkaktohen viktima të tjera.
- Mund të jetë e nevojshme që të evakohet e gjithë popullsia nga zona e prekur OSE nga zona të tjera që mund të jenë me rrezik të lartë. Në këtë situatë nevojitet mbajtja nën kontroll e rendit publik, dhënia e informacioneve të qarta, dhënia e mesazheve dhe udhëzimeve për popullsinë si dhe informimi për zonat e sigurta të identifikuara më parë.
- Edhe gjatë trajtimit të menjëhershëm mjekësor dhe operacioneve të kërkim shpëtimit mund të vlerësohen dhe rreziqe dytësore për objektet e dëmtuara.
- Kjo lidhet me vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave dhe regjistrimin ose gjurmimin e personave që mungojnë.
- Mbështetja logjistike është shumë e rëndësishme për një përballim të suksesshëm. Rrjeti rrugor, portet, telekomunikacionet dhe infrastruktura tjetër duhet që të funksionojnë sa më shpejt dhe sa më mirë që të jetë e mundur me gjithë kufizimet.
- Nëse njerëzit mbeten brenda strukturave të prishura, skuadrat e specializuara të kërkim- shpëtimit pasi të sigurohen duhet të fillojnë operacionet menjëherë. Pjesa më e madhe e personave që shpëtohen do të jetë gjatë 24-48 orëshit të parë pas ngjarjes.

### **10.5 Faktorët për t'u marre parasysht gjatë rikthimit në gjendjen normale**

- Siguria, eliminimi i materialeve të rrezikshme ose pastrimi i zonës nga ndotjet si dhe sigurimi i strukturave të dëmtuara duhet të garantohen përpara se popullsia të kthehet e sigurt në zonën e prekur.
- Shërbimet publike bazë ku përfshihen uji i pijshëm, ujërat e zeza, përdorimi i rrugëve



dhe furnizimi me energji duhet të sigurohen dhe të ruhen sa më shpejt të jetë e mundur.

- Duhet të merren vendime të shpejta në lidhje me objekte bazë publike (duke përfshirë ndërtesat e shkollave dhe spitaleve) që mund të jenë shkatërruar ose dëmtuar rëndë. Ndërtesat që nuk riparohen, duhet të prishen plotësisht dhe duhet të merret në konsideratë zëvendësimi i tyre i përkohshëm ose i përhershëm.

- Duhet të merren vendime të shpejta për strehimin e sigurt të popullsisë së prekur. Mund të nevojitet që njerëzit të vazhdojnë të qëndrojnë në strehimet e përkohshme edhe për një fare kohe.

Një emergjencë me përmasa të madha shpesh shoqërohet me ndihmë ndërkombëtare ose mbështetje të mundshme financiare ose materiale. për strukturat shtetërore, është e rëndësishme të vendoset ritmi i jetës ashtu siç ishte.

## **11. PËRGATITJA E STRUKTURAVE/TRAJNIMI**

### **11.1 Parathënie**

Trajnimiti stërvitjet e ndryshme janë aspekte mjaft të rëndësishme për ngritjen dhe për forcimin e sistemit të shërbimit të emergjencave civile. Aktivitetet, trajnimet bëjnë të mundur parapërgatitja, lehtësimi, përgjigjja dhe aktivitet e rikthimit në gjendje normale të jenë sa më eficientë. Trajnimet do shërbejnë si mjet mjaft rëndësishëm për përmirësimin e planeve të emergjencave civile në qark dhe bashki.

### **11.2 Qëllimi i programit të trajnimit të emergjencave civile**

Trajnimiti ka si qëllim forcimin e kapaciteteve lokale dhe institucionale për një menaxhim sa më efektiv të situatave emergjente. Ky qëllim do të arrihet nëpërmjet aktiviteteve trajnuese që do të organizohen kryesisht nga Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile në bashkëpunim me zyrën e Emergjencave Civile të institucionit të Prefektit të Qarkut.

### **11.3 Planet e emergjencave dhe testimi i tyre**

Testimi përdoret si mjet i vlerësimit të efektivitetit dhe zbatueshmërisë të seksioneve të veçanta të një plani ose të planit në përgjithësi.

Në vartësi të ndryshimeve dhe kërkesave të realitetit, testimi dhe vlerësimi i planeve të emergjencave civile do të bëhet në këto mënyra:

- Testimi dhe Vlerësimi i elementeve të veçantë të planeve të emergjencave.
- Testimi i planeve të emergjencave civile, bazuar në rreziqet e mundshme nga të cilat Qarku Vlorë është më i prekshëm.

### **11.4 Metodologjia e trajnimit dhe grupet përfituese**

Metodologjia e trajnimit përzgjidhet nga një sere faktorësh si situata reale, niveli i audiencës, nevojat e komunitetit në zonat e rrezikut të lartë, çështjet parësore të emergjencave civile, të cilat mund të zhvillohen nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

- seancave teorike,
- seancave plenare,
- punës me grupe,
- stërvitjeve në tryeze,
- stërvitjeve në teren me pjesëmarrjen e forcave operacionale dhe të komunitetit.

Grupet përfituese të këtyre aktiviteteve përfshijnë: forcat operacionale dhe personelin e planifikimit dhe të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të gjithë personelin e institucioneve shtetërore dhe OJF të lidhura me çështjet e emergjencave civile në qark.

### **11.5 Stërviatjet në tryezë dhe stërviatjet në terren**

- Stërviatja në tryezë është aktivitate i mire për trajnimin e stafeve të te gjitha niveleve, si operacionale ashtu edhe vendimmarrës. Qëllimi i saje është të nxjerrë në pah problemet ekzistuese në bashkërendim, të zhvilloje fantazinë për zgjidhjen e skenarëve të ndryshëm, identifikimin e problemeve, dhe nevojën për rishikimin e planeve konkrete dhe përgatitjen për stërviatje të tjera në tryeze ose në terren.

- Stërviatja në terren është niveli me i larte i stërviatjes dhe kërkon planifikim të mire të burimeve dhe kapacitete të shumta për ta përgatitur e zhvilluar në këto stërviatje bëhet testimi i planeve të miratuara. Mobilizimi fizik dhe lëvizja e personelit dhe e kapaciteteve janë të nevojshme për të demonstruar aftësitë e bashkërendimit, të përgjigjes dhe të rikthimit në normalitet pas situatës se emergjencës.

## **12. PËRGJIGJA**

### **12.1 Raportimi i situatave të emergjencës civile**

Është detyrë e çdo strukture shtetërore, jo shtetërore dhe qytetari në qark dhe më gjerë, që në mënyrë të menjëhershme, të informojë tek njësite vendore: bashki dhe qark, në administratën e prefektit në lidhje me situata reale apo të mundshme për emergjenca civile. Pas marrjes së njoftimit, autoritetet zyrtare duhet të kenë si përparësi përcjelljen e informacionit në QKOEK.

### **12.2 Rolet dhe përgjegjësitë gjatë fazës së Përgjigjes**

Menjëherë pas informimit rreth ndonjë situatë emergjente ose ngjarje të mundshme të cilat munde të shkaktojnë një emergjence në nivel qarku, bashkie ose , Prefekti, punonjësit e emergjencave civile dhe kryetari i bashkisë përkatëse, ndjekin këtë radhe pune:

#### **Organet e Qeverisjes Vendore**

Gjatë fazës së përgjigjes, rolet dhe përgjegjësitë për çdo aktivitet janë si me poshtë:

#### **Aktivizimi dhe bashkërendimi i forcave operacionale të nivelit vendor:**

Aktivizimi i FO në nivelin vendor, bëhet nga drejtuesit e organeve të pushtetit vendor, ndërsa bashkërendimi i strukturave të Shërbimit të Emergjencës civile si: PSH, MZSH, FA dhe SFJU, në nivel qarku është nën përgjegjësinë e Prefektit të Qarkut i cili këshillohet nga KQEC<sup>se</sup>.

#### **Aktivizimi dhe bashkërendimi i strukturave aktive vepruese dhe mbështetëse në qark:**

Në raste se nuk janë mobilizuar ende, Drejtuesi i Operacionit u kërkon institucioneve përkatëse aktivizimin e strukturave vepruese aktive (SVA) dhe menaxhon situatën nëpërmjet drejtimit të strukturave operacionale të shërbimit të emergjencave civile të aktivizuara. Drejtuesi i operacionit mbështetet dhe vepron sipas udhëzimeve të KQEC<sup>se</sup>.

#### **Operacionet e kërkim- shpëtimit (SAR)**

Grupet e qarkut të kërkim shpëtimit sigurohen nga repartet ushtarake, nga Drejtoria e Policisë, "Delta Forca", MZSH, Grupe vullnetare etj. Operacionet e kërkim shpëtimit mbështeten nga grupet kombëtare të kërkim- shpëtimit.

#### **Vlerësimi i nevojave:**

Bashkërendimi për Vlerësimin e nevojave për ngjarje apo emergjenca të shkallës se ulët, është përgjegjësi e Prefektit të Qarkut si dhe e kryetarit të bashkisë të prekur nga fatkeqësia.

Për emergjenca të shkallës se lartë, bashkërendimi është përgjegjësi e KNEC nëpërmjet grupeve të përbashkëta të Vlerësimit. Prefekti angazhon specialistet në qark për bashkëpunim me këto grupe si: punonjësit e emergjencave civile, punonjësit e bashkive dhe personelin e

degës të KLKSH.

#### **Vlerësimi i dëmeve (në aspektin e dëmtimeve të infrastrukturës dhe objekteve të ndërtimit)**

Vlerësimi i dëmeve në infrastrukture dhe objektet e banimit për emergjenca të shkallës se ulët bëhet nga administrata e Prefektit e mbështetur DPPEC dhe për emergjencat e shkallës se lartë nga grupet e përbashkëta të vlerësimit.

#### **Qendra rajonale operacionale e emergjencave civile (QROEC)**

QROEC është qendra kryesore për menaxhimin e informacionit. Ajo mbledh, përpunon, analizon dhe shpërndan informacion për përballimin e emergjencës. Mbështetje dhe informacion për QROEC-në, sigurohet nga të gjitha institucionet e qarkut dhe publiku i gjerë.

#### **Sigurimi i informacionit për qendrën rajonale operacionale të emergjencave civile dhe për QROEC- në**

Është përgjegjësi e të gjitha institucioneve, strukturave, autoriteteve lokale përkatëse dhe subjekteve të sektorit private dhe kur është e nevojshme edhe e publikut të gjerë të siguroj informacion të vazhdueshëm nga terreni për QROEC dhe QKOE13. Kjo i mundëson zyrës së emergjencave dhe DPPEC për të bërë propozime të drejta sipas përkatësisë Prefektit të Qarkut dhe MPB.

#### **Ekipi i menaxhimit të emergjencës**

Me shpalljen e gjendjes së emergjencës civile, pranë QROEC, mbledhet Ekipi i Menaxhimit të Emergjencave civile (EMEC) i cili sipas situatës dhe llojit të emergjencave, përket nga përfaqësues të institucioneve në qark të cilat organizohen në seksionet përkatëse përshkruara në seksionin 2. 4. Pranë këtij ekipi mund të punojnë, ndihmojnë dhe përfaqësues të degës së KKS, të QJF- ve etj. Ky ekip përgatit tërë procesin e marrjes së vendimeve nga DOQ dhe KQEC.

#### **Njoftimi i hershëm (i pari) informimi dhe këshillimi i publikut**

Përgjegjësia kryesore për informimin e popullsisë, në vartësi të shpejtësisë dhe shkallës së emergjencës, është e drejtuesve të organeve të pushtetit vendor të bashkive, Prefektit, SEC, si dhe të FO në teren. Njoftimi, informimi dhe këshillimi i publikut në qark bëhet kryesisht nga media private në të gjitha nivelet (elektronike dhe e shkruar), sistemi shkollor, vullnetaret e KKS, organizatat e Shoqërisë Civile si dhe mjete e burime të tjera.

#### **Lehtësirat/pajisjet e transportit të emergjencës duke përfshirë transportin gjatë emergjencës se njerëzve, evakuimit, grupeve të Kërkim-Shpëtimit, artikujve të ndihmës, depozitave të ujit dhe naftës.**

Në nivel qarku e bashkie, zyrat e emergjencave civile mbajnë inventarin e kapaciteteve të disponuar nga subjektet shtetërore dhe ato private. Kërkesat për transport në situata të emergjencave civile i drejtohen DQO. Një përmbledhje e kapaciteteve të qarkut është bashkangjitur këtij Plani.

#### **Lehtësirat e transportit ndërkombëtar për emergjencat (Ajri dhe Deti)**

Aktivitetet në përgjigje të emergjencave qark të cilat kërkojnë përdorimin e lehtësirave portale, bashkërendohen nga DOQ. Drejtorit në Portet Detare Vlorë e Sarandë, sigurojnë mbështetjen teknike të menjëhershme dhe direkt. Mbështetje sigurohet nga të gjitha institucionet që kryejnë aktivitet në port si Drejtoria e Policisë së Qarkut, Drejtoria Rajonale e Doganave, Kapiteneria etj. Një përmbledhje e funksioneve të secilit institucion në lidhje me menaxhimin e emergjencave civile është e listuar në Shtojcën 12.

#### **Hyrja për në zonat e prekura nga emergjenca**

Bashkërendimi i aktiviteteve për hyrjen në zonat e prekura në qark nga emergjenca, sigurohet

nga DOQ, DOB/DOK, të mbështetura dhe në bashkëpunim me DPPEC, DQO. Hapja dhe pastrimi i rrugëve nacionale është përgjegjësi e Drejtorive Rajonale të rrugëve Vlorë e Gjirokastrë. Pastrimin e rrugëve rurale bëhet nga Drejtoritë e Rrugëve Rurale ndërsa bashkitë, përgjigjen për rrugët që kanë në inventarin e tyre. Për pastrimin e rrugëve rurale dhe të rrugëve që janë në inventar të OQV sipas nevojës mund të kërkohet dhe mbështetja e Drejtorive Rajonale të rrugëve.

### **Kontrolli i kufijve në kohe emergjence**

Përgjegjësit për kontrollin, zbatimin e rregullave doganore, për kalime të paligjshme, për emigracionin dhe kontrollin e kufijve, janë të Drejtorisë së policisë së Qarkut (*Policisë Kufitare*), të Doganave, të kapitanerisë së Porteve të cilat veprojnë sipas udhëzimeve të organeve qendrore të vartësisë, bazuar në konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare.

### **Shërbimi shëndetësor parësor**

Drejtoritë e Shëndetit publik në qark përkatësisht në rrethet Vlorë, Sarandë dhe Delvinë, janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimit të urgjencës dhe Shërbimit Shëndetësor Parësor nëpërmjet qendrave shëndetësore, të cilat janë funksionale. Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga DOQ.

### **Shërbimi shëndetësor dytësor dhe tretësor**

Shërbimi Shëndetësor dytësor dhe tretësor në qark është në përgjegjësi të Drejtorive të Shëndetit Publik dhe të drejtorive të Spitaleve. Ky shërbim në Qarkun Vlorë realizohet me 3 spitale, Spitali Rajonal Vlorë, 2 Spitale përkatësisht në rrethet Sarandë e Delvinë, 71 ambulanca, 4 laborator klinik të specializuar dhe 2 bankave të gjakut.

Kapacitetet shtesë sigurohen nga D2D, Qendra e Bunavisë dhe subjektet private. Kërkesat dhe nevojat koordinohen nga DOQ. Një liste me kapacitetet e mundshme është në seksionin Shtesë

### **Menaxhimi i të dëmtuarve/viktimave në mase**

Menaxhimi i viktimave dhe të dëmtuarve në mase në momentet e para drejtohet nga strukturat e para reaguese që janë forcat operationale të shërbimit të emergjencave civile që janë me të afërta me vendin e ngjarjes. Ndihma e pare bëhet nga strukturat e shërbimit shëndetësor që ndodhën me afër zonës të prekur nga emergjencat, të mbështetura nga Repartet ushtarake, Drejtoria e Policisë, MZSh, Dega e KESh dhe vullnetar të kualifikuar nga sektori private. Evakuimi i të dëmtuarve për në shërbimin dytësor dhe tretësor është përgjegjësi e Drejtorive të Shëndetit Publik të rretheve dhe bashkive të prekura nga emergjenca. Kapacitetet përforcohen nga Drejtoria e Policisë e Qarkut, Reparti i Policisë “Delta Forca”, nga forca të specializuara të reparteve ushtarake të dislokuara në qark nëpërmjet grupeve të shpëtimit në det, evakuimit, urgjencës dhe KESH. Për identifikimin dhe menaxhimin e viktimave në masë, përgjigjet Këshilli i Qarkut Vlorë, bashkitë e prekura nga emergjenca, Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë dhe Drejtoria Rajonale e shfrytëzimit të automjeteve.

### **Sigurimi i shërbimit të shëndetit publik:**

Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe Drejtoritë e Shërbimit Parësor, kanë përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë të ujit të pijshëm dhe higjienës si dhe për zbatimin e programit të MSH për vaksinimin e popullatës. Këto institucione mbështeten dhe bashkëpunojnë dhe me struktura të tjera shtetërore që veprojnë në qark.

### **Sigurimi dhe rivendosja në funksionim e shërbimeve jetike komunale**

Sigurimi i burimeve alternative me ujë duke përfshirë fuqizimin me autobote dhe të ambalazhimin dhe riparimin e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm është përgjegjësi e Drejtorive të ujësjellësve në rrethe. Këto institucione mbështeten nga organet e qeverisjes

vendore dhe repartet ushtarake të dislokuara në qark.

Sigurimi i burimeve alternative të energjisë dhe riparimet e sistemit të furnizimit me energji elektrike janë përgjegjësi e ndërmarrjeve elektrike dhe TECI-it e cila realizohet nëpërmjet aktivizimit të grupeve të përgjigjes se menjëhershme (*Grupi i eliminimit të avarive*), bashkëpunimit me bashkitë dhe të kontraktuarit që kryejnë këto shërbime.

Sektori privat; Shoqëritë e Tregtimit të Karburanteve dhe Gazit, kanë përgjegjësi të ngjashme për stacionet në pronësi të tyre, për masat e sigurisë dhe të furnizimit me gaz.

DBU në bashkëpunim me Drejtoritë e Pyjeve, ka përgjegjësi për sigurimin dhe shpërndarjen e lëndës drusore për ngrohje, mbështetur për transport nga Drejtoria Rajonale e Shfrytëzimit të Automjeteve dhe OQV.

### **Evakuimi i popullsisë civile:**

Në nivel qarku, përgjegjësia për evakuimin është e Prefektit, në nivelin vendor e kryetarit të Bashkisë. Gjatë situatave të emergjencës, forcat operacionale në terren (Rep. Usht. Drejtoria e Policisë, Stacionet e MZSH- ve etj.) mund të vendosin evakuimin e menjëhershëm për territore të kufizuara, në vartësi të situatës, rol të rëndësishëm luajnë forcat operacionale, strukturat vepruese aktive të rep. usht. të Drejtorisë së policisë, kontaktet me sektorin privat dhe KSSH.

Në fazën e evakuimit një rëndësi të veçante merr informimi publik për rrezikun dhe masat që duhen marre për të lëvizur në zona të sigurta.

### **Sigurimi i digave, pritave, kanaleve, lumenjve, liqeneve etj:**

Përgjegjësia për kontrollin, mirëmbajtjen, sigurinë dhe riparimin e digave e dambave, pritave, kanaleve, lumenjve dhe liqeneve është si me poshtë:

Drejtoritë e Ujërave në rrethe, pritat bujqësore, stacionet e pompimit, sistemet e kanalizimeve primare dhe rezervuarët.

Mbështetja sigurohet riga:

- Agjencia Rajonale e Mjedisit, Sistemi i lajmërimit, Komiteti i Basenit Ujëmbledhës të Vjosës dhe nga bashkitë për sistemet e kanalizimeve dytësore dhe tretësor.
- Mbështetje me rrjetë dhe pajisje të renda, në se është e nevojshme, sigurohet nga Repartet ushtarake, Drejtoria e Policisë se Qarkut, sektori privat.
- Shoqata e fermerëve, Përdorues të Ujit.
- Kontraktorët shfrytëzues të burimeve ujore dhe rezervuarëve.

### **Identifikimi dhe sigurimi i strehimeve të përkohshme.**

Caktimi i objekteve dhe rajoneve për sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta, drejtohet nga autoritetet e bashkive, Këshilli i Qarkut dhe Prefekti, të mbështetur nga DPPEC/DQO. Ndihe jepet nga strukturat që kanë kapacitete në ndërtesa apo terrene për vendstrehime të përkohshme ku përfshihen, shkollat, rezervat e shtetit, Institucionet Sportive, Sektori i Policisë se Burgjeve (evakuimi dhe strehimi i personave të paraburgosur dhe të burgosur) dhe Dega e KSSH.

### **Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime të brendshme**

Bashkërendimi për sigurimin, furnizimin, magazinim in dhe shpërndarjen e artikujve të ndihmës në qark bëhet nga DOQ/KQEC.

- Sigurimi dhe furnizimi me artikuj të ndihmës bëhet nga: DBU, DPSh, Rep. Ushtarake, Rezervat e Shtetit, KQSH nëpërmjet organeve qendrore.
- Shpërndarja e ndihmës në qark bashkërendohet nga Prefekti (DOQ), dhe në nivel bashkie, nga Autoritetet lokale/DQB, në bashkëpunim të ngushte me strukturat e DSHP (për ndihmën me ilaçe), strukturat e Drejtorisë Rajonale të Punësimit, të Përkrahjes Sociale,

vullnetaret e Degës së KKSH dhe kontraktor.

### **Menaxhimi i artikujve të ndihmës emergjente nga burime ndërkombëtare**

Kërkesa për ndihme MPB dhe KNEC, bëhet nga KQEC/DOQ.

Transportimi dhe shpërndarja e artikujve të ndihmës në nivel qarku bashkie dhe bashkërendohet nga Prefekti i qarkut dhe organet e pushtetit vendor, në bashkëpunim të ngushtë me Strukturat e shëndetësisë (për ndihme në ilaçe), të punësimit dhe çështjeve sociale, vullnetaret e KKSH në nivel qarku dhe kontraktohet.

### **Telekomunikacioni i Emergjencës.**

Drejtoritë e Telekomunikacionit ka rolin dhe përgjegjësitë bashkërenduese në telekomunikacion për emergjencat në qark, duke u mbështetur në ndihmën e strukturave të pajisura me rrjetë telekomunikimi.

Këtu përfshihen:

- Rrjeti i radiokomunikimit i reparteve ushtarake
- Rrjeti i radiokomunikimit i Strukturave të Drejtorisë së Policisë së qarkut
- Rrjeti i radiokomunikimit i doganave dhe policisë tatimore
- Rrjeti i radiokomunikimit i policisë pyjore
- Rrjeti i radiokomunikimit i MZSH
- Rrjeti i radiokomunikimit i Degës së KKSH

Ndihme shtesë sigurohet nga Radio- Televizionet lokale, kompanitë e komunikimit nga sektori privat.

### **Shërbimet e ndihmës sociale**

Drejtoria Rajonale e Ndihmës Ekonomike merr rolin bashkërendues në lidhje me çështjet e ndihmës sociale. Për Vlerësimin e nevojave, identifikimin e të prekurve dhe hartimin e asistencës sociale të nevojshme, ajo punon ngushtë me Prefektin dhe organet e pushtetit vendor në punën e saj ajo asistohet nga Zyra e Emergjencave Civile, Dega e KKSH dhe OJF.

### **Ruajtja e sigurisë dhe rendit publik.**

Për situata të jashtëzakonshme problemet e sigurisë në Qark bashkërendohen nga Prefekti i Qarkut i mbështetur nga autoritetet e pushtetit lokal.

Në fatkeqësi të mëdha: Prefekti përgjigjet për organizimin e mbrojtjes së popullsisë dhe të pronës nga fatkeqësitë natyrore, ekologjike dhe nga dëmtimet e luftës.

### **Kërkesa për ndihmë kombëtare**

Kërkesa për aktivizimin e kapaciteteve kombëtare, drejtohen nga Prefekti i Qarkut.

Për ndihmën Kombëtare dhe të qarqeve fqinjë, rolin koordinuesit e ka Prefekti i Qarkut/Drejtuari i Operacionit të Qarkut.

### **Mbështetja financiare e emergjencës**

Fonde Rezerve për Emergjencë mund të aktivizohen duke përdorur këto burime:

- Fondin e emergjencave civile në buxhetin e bashkive dhe të Qarkut.
- Fondi i Emergjencave në buxhetin e Prefektit të Qarkut.
- Fonde të Emergjencave të akorduara institucioneve shtetërore në qark për emergjencat nga Ministritë përkatëse.
- Fonde rezerve të Këshillit të Ministrave.

Rolin drejtues për mbështetjen financiare në qark për emergjencat merret nga Prefekti Qarkut, në mbështetje dhe në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit vendore dhe të institucioneve shtetërore përkatëse, në vartësi të natyrës së emergjencës civile.

### 12.3 Shpërndarja transmetimi i informacionit publik

Informimi i publikut është element thelbësor i njoftimit të hershëm, parapërgatitjes dhe këshillimit të komunitetit. Informimi i publikut mund të luaj një rol të rëndësishëm në shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pasurisë së tyre në raste emergjencash civile. Qetësia, korrektesa dhe shpejtësia e dhënies së informacionit është mjaft e rëndësishme në Raste të emergjencave civile, e cila sigurohet në nivel vendor nëpërmjet njoftimeve periodike të QREC (Sektorit të informacionit) dhe nga drejtuesit e operacioneve në nivel qarku, bashkie e .

### 12.4 Doganat emigracioni dhe karantina

Në rast të pritjes së ndihmave ndërkombëtare institucionet shtetërore që veprojnë në portet Vlorë, Sarandë e Himarë dhe pikat kufitare, marrin detyra nga Prefekti/DOQ për zbatimin, lehtësimin e procedurave të hyrjes së personelit të ndihmës sipas dispozitave ligjore për ndihmat humanitare. Përparësi duhet të kenë grupet e kërkim- shpëtimin, dhe për qentë e kërkimit.

DOQ/ekipi i menaxhimi. të emergjencave është përgjegjës për pritjen dhe trajnimin në dogana dhe kalimin kufitar ndihmës ndërkombëtare që tutet në pikat kufitare të qarkut.

Në rast emergjence në vendet fqinje autoritetet portuale në qark duhet të jenë të përgatitura për të pritur/përcjellë njerëzit dhe gjënë e gjallë të tyre sipas planifikimit të KNE13.

### 12.5 Çështjet financiare

Situatat e emergjencave civile kërkojnë planifikim paraprak për kostot e mundshme edhe në nivel qarku, bashkie e . Problemet financiare në fazën e përgjigjes janë:

- Problemet e menjëhershme financiare:

Për veprime të menjëhershme të strukturave që kanë përgjegjësi për emergjencat civile është e nevojshme të kenë monedha kesh, për përgjigjen e pare. Duhet të merren të gjitha masat që pajisjet, mjetet e transportit, nafta dhe kostot e **komunikimit që** parashikohen të nevojshme, të jenë të disponueshme në çdo kohë për të siguruar ndërhyrje sa më të shpejtë në rajonin e prekur.

- Probleme financiare dytësore:

Zgjatja e situatës së emergjencës civile në qark, kërkon planifikimin afatgjatë të shpenzimeve buxhetore të konsiderueshme të cilat duhet të planifikohen nëpërmjet projekteve, preventivave, planeve dhe për vlerësimin e tyre duhet bashkëpunimi me organet qendrore.

- Probleme financiare tretësore:

Në fazën e përgjigjes, gjatë përpjekjeve për stabilizimin e situatës do të dalin kërkesa për shtesë të kostove, për riparimin e ndërtesave dhe infrastrukturës së dëmtuar, rikonstruksionin e shërbimeve bazë, si: te ujit të pijshëm, të energjisë elektrike dhe sigurimin e strehimeve të sigurt për një periudhë afatgjatë, për ata të cilët nuk janë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre. Gjatë kësaj faze, masat në vijim duhet të jenë të planifikuara nga të gjitha strukturat përkatëse të përfshira në zgjidhjen e heshtjeve të emergjencave civile:

- Mbajtja e një rezervë të mjaftueshme në kesh nga organet e Qeverisjes vendore për tu përdorur në përgjigje të menjëhershme ndaj situatës emergjente.
- Për të gjitha strukturat në nivel vendor, përgjegjëse për emergjencat civile duhet të ekzistojnë plane dhe marrëveshje në mënyre që të mbulojnë menjëherë kostot për matjen e mjeteve të transportit, të shofereve dhe karburantit, për vlerësimin e përgjigjeve të menjëhershme ndaj situatës emergjente.
- Duhet të ekzistojnë lehtësira, në mënyre që personeli i emergjencave civile të jetë në gjendje të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve për të mbuluar shpenzimet e bëra në fazën e pare të përgjigjes së menjëhershme.

- Kontratat e lidhura paraprakisht ose marrëveshje duhet të jenë bërë paraprakisht dhe të vihej në veprim në kohën e emergjencave civile.
- Është e nevojshme parashikimi i kostove të mundshme për përgjigje ndaj emergjencave civile duke u bazuar në përvojën e kaluar, në stërvitjet stimuluese dhe të përfshihen në planifikimet e buxhetit të strukturave vendore të interesuara. Duke u mbështetur në këto vlerësime, OQV dhe institucionet përkatëse duhet të përcaktojnë një përqindje e buxhetit vjetor për përgjigje ndaj emergjencave civile.

### **12.6 Raportimet dhe vlerësimet**

Raportimet për situatën merren nga institucionet dhe strukturat e ndryshme në qark sipas formularëve standarde:

- Formulari i njoftimit të pare.
- Raportimi i të dhënave të para për fatkeqësinë.
- Kërkesë për organet qendrore në raste emergjence.

Formulari i raportit të të dhënave të para për fatkeqësinë duhet të përgatiten nga grupet e përbashkëta të vlerësimit të ngritura në nivel qarku bashkie e .

Në situata të tejskajshme, mund të bëhen ndërhyrje të menjëhershme paraprake (si evakuim në mase të popullsisë, operacione kërkim- shpëtimi, dhënie e ndihmës mjekësore dhe aktivitete të tjera parësore, përpara ose gjatë bërjes së vlerësimit

## **13. BAZA LIGJORE, FUNKSIONET DHE DETYRAT E INSTITUCIONEVE**

### **13.1 Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Drejtoria e Ujërave, Drejtoria e Shërbimit Pyjor dhe Drejtoritë e Ujërave**

Angazhimi i Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe Ushqimit, i Drejtorisë së Ujërave, i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Pyjor, në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave bazohen në detyrat e përcaktuara, në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile, në Planin e Qarkut për emergjencat civile si dhe ne:

- Ligji 7623 datë 13. 10. 1992 “Për pyjet dhe policinë e Shërbimit Pyjor”.
- Ligji Nr. 7662, datë 19. 01. 1993 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”,
- Ligji nr. 7941, datë 31. 05 1995 “Për Ushqimin”;
- Ligji nr. 8681, datë 2. 11. 2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”,
- Ligjin nr. 7674, dt. 24. 02. 2003 “Për shërbimin veterinar”

Këto institucione kanë detyra kryesore për emergjencat civile dhe konkretisht sipas përkatësisë institucionale dhe ligjore përgjigjen për:

- Mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret.
- Mbrojtjen e shëndetit të shtetasve nga përdorimi i ushqimeve.
- Mbrojtjen e tokës nga erozioni
- Mbrojtjen e burimeve dhe rezervave ujore.
- Mbrojtjen e kafshëve nga sëmundjet dhe parandalimin e përhapjes së tyre
- Njohjen e vazhdueshme me situatën fitosanitare në kulturat bujqësore në shkallë qarku si dhe hartimi i programeve të luftimit të tyre.
- Garantimin e qëndrueshmërisë, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin sipas rregullave të rezervuarëve.
- Inspektimin e kushteve optimale të prodhimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të



produkteve ushqimore blegtorale dhe bujqësore.

- Inspektimin e kushteve të magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të preparateve të mbrojtës se bimëve.
- Ushtrimin e kontrollit në vendkalimet kufitare për parandalimin e transportimit dhe transmetimit të sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve.

Në kuadrin e zbatimi të detyrave për emergjencat civile, këto institucione bashkërendojnë veprimtarinë me strukturat e tjera të planifikuara për tu përfshire në përballimin e emergjencave civile në nivel qarku, bashkie e dhe kryesisht me:

- KESH për garantimin e ritmikës së furnizimit me energji elektrike të hidrovoreve dhe riparimin e shpejte të defekteve në to.
- Komitetin e Shtetëror për Digat, për kontrollin, inspektimin dhe ndërhyrje të kualifikuar në digat e ujëmbledhësve dhe dambat.
- Drejtorinë e Shëndetit Publik, Drejtorinë e Shërbimit Parësor, për trajtimin e zonave të infektuara me rrezik për bimët dhe kafshët dhe rrezik transmetimi në njerëz.
- Organet e qeverisjes vendore për përcaktimin e zonave të rrezikuara nga përmytjet, shpërthimet e digave të ujëmbledhësve dhe dambave, me qëllim planifikimin e evakuimit në kohe të popullsisë së kërcënuar.
- Degët e Tatim- Taksave dhe Bashkitë, për kontrollin e ushqimeve dhe garantimin e konsumit të tyre

Detyrat e tyre këto institucione i realizojnë nëpërmjet strukturave të përhershëm e dhe jo të përhershëm të krijuara në situata emergjente. Këto institucione krijojnë komisione të veçanta për përballimin e emergjencave civile dhe bashkëpunojnë me Komisionet vendore për emergjencat civile

### **13.2 Reparti Ushtarak Nr. 5570 Bunavi dhe D2D Vlorë**

Repartet Ushtarake të dislokuar në qarkun Vlorë konsiderohen kapacitete të konsiderueshme aktive dhe mbështetës në ndërmarrjen e operacioneve të parandalimit, lehtësimit, përgjigjes dhe riaftësimit të zonave të goditura nga fatkeqësi të çdo lloji si dhe kryerjen e detyrave dhe funksioneve në mbështetje të strukturave të tjera.

Roli i saj përcaktohet në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tu dhe në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile, të PQEC si dhe ne:

- Ligjin Nr. 8670 datë 26. 10. 2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit Strategjik të FARSH”,
- Ligji Nr. 7978, datë 26. 07. 1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Dokumentin e Strategjisë Ushtarake,
- Doktrinën e Përgjithshme Ushtarake,
- Direktivën e Mbrojtjes.

Forca kryesore aktive të reparteve ushtarake të dislokuara në qarkun Vlorë angazhohen në operacione direkte në zonat e dëmtuara nga fatkeqësitë dhe konkretisht kryejnë këto detyra:

- Marrin pjesë në kërkim- shpëtimin, evakuimin, trajtimin e popullsisë së dëmtuar dhe rikthimin në zonat e tyre të banimit pas qetësimit të situatës, në bashkëpunim me OQV dhe Prefektin.
- Për bashkërendimin e dhënies së ndihmës në det, nëpërmjet rojës bregdetare dhe në raste të aksidenteve ajrore, nëpërmjet shërbimit SAR.

- Për fikjen e zjarreve në pyje e kullota
- Në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga veprimet terroriste me përdorimin e lendeve helmuese, bakteriologjike e radioaktive si dhe aksidentet industriale.
- Izolimim e zonës, se infektuar si dhe pastrimin e saj nga ndotjet dhe personat e infektuar.
- Dhënien e ndihmës mjekësore.

Siguron dhe ve në dispozicion:

- Mjetë të nevojshme për transport masiv.
- Rrjetin e saj të informacionit dhe të telekomunikimit
- Logjistike të nevojshme për të ndihmuar në operacionet e zhblokimit të rrugëve etj

Në këto raste, Repartet Ushtarake bashkëpunojnë me:

- Drejtorinë Rajonale të Rrugëve,
- Organet e Qeverisjes Vendore
- Drejtorinë e Policisë të Qarkut
- Drejtorinë e Shëndetit Publik dhe të Shërbimit Parësor
- Repartin e Policisë “*Delta Forca*”

### **13.3 Institucionet shëndetësore në qark (DSHP, DSILP, Spitali Rajonal Vlorë)**

*Institucionet Shëndetësore në qark luajnë rolin kryesor për kujdesin shëndetësor dhe mjekësor në fatkeqësi të çdo lloji si dhe në situata të renduara mjekësore për parandalim in, lehtësim in, përgjigjen dhe riaftësimin e zonave të goditura.*

Funksionet dhe detyrat e Institucioneve shëndetësore realizohen në mbështetje të detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij, në Planin Kombëtar të Përballimit të Emergjencave Civile, të PQEC, si dhe:

- Ligji Nr. 7694. datë 02. 12. 1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”
- Ligji Nr. 7761, datë 19. 10. 1993 “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”,
- Ligji Nr. 9106, datë 17. 07 2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji Nr. 8032, datë 16. 11. 1995 “Për shërbimin e Transfuzionit dhe kontrollit të gjakut, produkteve të tij dhe transplantave”

Drejtoritë e Shëndetit Publik në Rrethe, garantojnë bashkëpunimin e të gjitha strukturave shëndetësore të niveleve të ndryshme si dhe me biznesin privat. Në fushën e shëndetësisë:

- ndihmën e pare mjekësore dhe të urgjencës për të dëmtuarit,
- përkujdesjen shëndetësore në të gjitha nivelet për shtetas të dëmtuar,
- krijimin e ekipeve shëndetësore të emergjencës,
- garantimin e shërbimit farmaceutik rezerve për raste të emergjencave masive,
- parandalimin e sëmundjeve infektive
- trajtimin e të kontaminuarve me materiale radioaktive
- shpalljen e karantinës shëndetësore,
- menaxhimin e operacioneve të evakuimit të pacienteve nga spitalet e dëmtuara,
- evakuimin e të dëmtuarve në spitale të tjerë jashtë zonës së dëmtuar,
- garantimin e transportit tokësor të personave të dëmtuar,
- garantimin e pajisjeve shëndetësore shtese dhe gjakut rezerve,
- trajtimin e viktimave të infektuara,
- kontrollin cilësisë se ujit të pijshëm dhe të përdorimit familjar dhe trajtimin e tij,
- fuqizimin ritmik me ushqime të pacienteve,
- kontrollin dhe ruajtjen e higjienës shëndetësore,
- trajtimin e zonave të kontaminuar,

- dhënien e asistencës për strukturat që trajtojnë popullsinë e strehuar në vendstrehime kolektive të përkohshme.
- kontrollin e bamave mjekësore në kufi, shpërndarjen dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

Në kryerjen e detyrave të tyre Institucionet Shëndetësore në qark bashkëpunon ngushte me: D2D dhe Br. Bunavi për transportin e pacienteve, ruajtjen e zonave të infektuara, aplikimin e regjimit të karantinës, trajtimin e viktimave, transportin nga ajri dhe toka, furnizimin me ushqime shtesë, si dhe fatkeqësi nga armët e dëmtimit një masë për trajtimin e specializuar të personave të kontaminuar.

- Kryqin e Kuq Shqiptar në dhënien e ndihmës së parë shëndetësore, trajtimin dhe përkujdesjen e mëtejshme ndaj të lënduarve, furnizimin me racione ushqimore dhe medikamente nga ndihmat.
- Organet e qeverisjes vendore për krijimin e kushteve të evakuimit, regjistrimin e pacienteve që do të evakohen jashtë zonës së dëmtuar.
- Drejtorin e Policisë të Qarkut dhe Repartin “Delta forca” për garantimin e shpejtte të transportit të urgjencës, garantimin e qetësisë në spitale dhe klinika të çdo lloji, si dhe për trajtimin e personave të ndaluar.
- Sektorin e Burgjeve, për ndihme mjekësore në burgje.
- Konsullatën italiane dhe MJ, për identifikimin, trajtimin e personave të lënduar apo të viktimave të cilat janë shtetas të huaj.

### **13.4 Drejtoria e policisë së qarkut dhe reparti i policisë “Delta Forca”**

Drejtoria e Policisë dhe “Delta Forca” luajnë rol parësor për emergjencat e shkaktuara nga aktet terroriste të çdo lloji.

Këto institucione angazhohet edhe në emergjenca të tjera të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore apo nga njeriu.

Detyrat, funksione dhe përgjegjësitë e organeve policore burojnë nga detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij, si dhe ne:

- Ligjin nr. 8553 datë 25. 11. 1999 “Për policinë e shtetit”,
- Rregulloren e Drejtimit Operativ dhe Emergjencave për Policinë e Shtetit nr. 1604 datë 22. 12. 2001.

Drejtoria e policisë në Qark planifikon dhe bashkërendon përdorimin e strukturave të saja me strukturat e tjera në operacionet e emergjencave civile. Drejtoria e policisë së qarkut dhe “Delta Forca” në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera, kryejnë aktivitete si:

- kërkim shpëtim;
- dhënie të ndihmës së parë;
- evakuim dhe, sigurim të zonës;
- ruajtje dhe izolim të zonës;
- ruajtjen e rendit dhe qetësisë;
- garantim të qarkullimit normal në akset rrugore;
- ruajtje dhe kontroll të kufijve;
- bashkëpunim në veprimet e mëtejshme hetimore;
- shoqërim të mjeteve evakuimit, urgjencës dhe i ndihmave humanitare;
- vënie në dispozicion të operacioneve në zonat e dëmtuara, mjetë, materiale dhe burime njerëzore;
- ndihmë në informim dhe radiokomunikim;
- organizim shërbimi të përforcuar në të gjitha objektet e rëndësisë së veçante, si dhe në pikat e kalimit kufitar, porte si dhe në institucionet qendrore në nivel vendor;

- garanton kushte normale për ekipet e huaja të ndihmës dhe mediat që ushtrojnë aktivitetin në zonën e dëmtuar.

Në përballimin e emergjencave civile Drejtoria e Policisë dhe “Delta Forca” bashkëpunojnë me:

Organet e Pushtetit Vendor, për operacionet e evakuimit dhe kërkim shpëtimin.

- D2D për operacionet e kërkim- shpëtimin në det.
- DSHP, DSHP, Spitalin Rajonal Vlorë për dhënien e ndihmës se pare shëndetësore dhe për trajtimin e mëtejshëm të te dëmtuarve, me OQV për identifikimin e viktimave.

### 13.5 Inspektorati rajonal i mjedisit

Duke qenë se fatkeqësitë natyrore të çdo lloji lenë pasoja të renda edhe në mjedis aq me tepër kur disa prej tyre shkaktohen nga materiale të rrezikshëm, Inspektorati rajonal i Mjedisit lë rol të rëndësishëm të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave.

Aktiviteti i kësaj strukture bazohet në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” dhe në akteve të tjera ligjore e nënligjore si:

Ligjin nr. 8994, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ligjin nr. 915, datë 24. 7. 2003 ”Për zonat e mbrojtura”,

Ligjin nr. 8897, datë 16 52002 ”Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”

Ligjin nr. 9010 datë 11.11.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

VKM nr. 103, datë 31. 4. 2002 ”Për monitorimin e mjedisit në RSH”.

### 13.6 Inspektorati mjedisor në qark:

- Luan rol parësor në Vlerësimin paraprak të situatave që bëhen shkak për të kaluar në një emergjence mjedisore të përmasave të mëdha, me pasoja për mjedisin në përgjithësi, jetën e shtetasve dhe gjësë se gjalle, pronës private e publike dhe trashëgimisë kulturore.
- Angazhon strukturat monitoruese informuese dhe struktura mbështetëse aktive.
- Siguron asistencë teknike për grupet e ndërhyrjes, pritjes dhe shoqërimit të tyre.
- Udhëzon punonjësit e strukturave vendore, për angazhimin e tyre në përballimin e emergjencave civile.

Bashkërendon aktivitetet me:

- Organet e qeverisjes vendore për rastet e kërkesës për evakuim të menjëhershëm, përgatitjes për evakuim,
- Drejtorinë e Shëndetit Publik, për përgatitjen dhe ndërhyrjen e strukturave shëndetësore,
- Drejtorinë e Naftës në Gorrisht për rastet e aksidenteve industriale dhe aksidenteve të tjera me prezence lëndësh të rrezikshme dhe prezence hidrokarburesh, D2D dhe QEP. Usht. Bunari, për rastet e rreziqeve nga eksplozionet, lendet helmuese të veprimit në mase,
- Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit si dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për kontaminime të mjedisit në ujërat e brendshme dhe zjarret në pyje,
- D2D, Drejtorinë e Policisë të Qarkut, Repartin “Delta Forca” dhe organet e qeverisjes vendore për ndotje masive të mjedisit në ujërat përgjatë vijës bregdetare nga derdhja e Vjosës Ksamil.
- Organet e Qeverisjes vendore dhe Policinë e Ndërtimit, në rastet e ndotjeve masive nga mbetjet urbane.

### 13.7 Drejtoria rajonale e rrugëve

Drejtoria Rajonale e Rrugëve zbaton detyrat dhe funksionet e saj në përputhje me ligjit nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “, Ligjit Nr. 8378, datë 22. 71998, ”Kodi rrugor i Republikës se Shqipërisë”.

Drejtoria rajonale e Rrugëve kryen këto detyra:

- Përballon problemet e mirëmbajtjes dhe ndërtimit të infrastrukturës rrugore.

- Në rastet e dëmtimit të infrastrukture rrugore angazhon burimet e saj njerëzore, materiale, mjetë dhe burime financiare për vënien në funksion të shpejte dhe garantimin e qarkullimit, për krijimin e kushteve të domosdoshme për veprimtarinë e strukturave të tjera që do të angazhohen në përballimin e emergjencave civile si dhe për vendosjen e sinjalistikës se nevojshme dhe shenjave të veçanta të qarkullimit.

Bashkëpunon me Organet e qeverisjes vendore, repartet ushtarake të dislokuara në qark dhe Shërbimin e qarkullimit rrugor, për realizimin e detyrave të saja.

### **13.8 OSHE (Degët e Shfrytëzimit dhe të Mirëmbajtjes)**

Detyrat:

Detyrat e OSSHE<sup>s</sup> në fushën e emergjencave civile, bazohet në ligjin nr. 8756 datë 26.4.2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e energjetikës.

Dega e shfrytëzimit dhe e mirëmbajtjes:

- Luan rol parësor në paralajmërimin, lehtësimin, përballimin e emergjencave civile të shkaktuara nga aksidentet në sistemin e energjetikës si dhe ngarkohet me detyra të tjera në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme.

- Organizon sistemin e lajmërimit dhe të ndërhyrjes se strukturave të gatshme në aksidentet në sistemin e energjetikës si dhe bashkëpunon në rastet e emergjencave civile të shkaktuara nga fatkeqësi të tjera.

- Bashkëpunon me struktura të gatshme të shërbimit zjarrfikës dhe shpëtimit, shërbimin e urgjencës shëndetësore, shërbimin e Drejtorisë të policisë së shtetit, dhe organizon teknikisht ndërhyrjen e strukturave operacionale. me struktura.

Në rastet e aksidenteve të ndodhura në miniera, rrëshqitjeve masive të tokës si dhe fundos leve tektonike, Drejtoria rajonale e Shfrytëzimit të automjeteve vepron në të njëjtën mënyrë si është përcaktuar me lart duke afruar dhe këshilla, mjete dhe teknika të specializuara për operacione të kërkim shpëtimit.

- Menaxhon sistemin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, të ruajtjes se objekteve të veçanta.

- Garanton prodhimit të pandërprere të energjisë elektrike si dhe informimin e publikut për ndërprerjet e planifikuara.

### **13.9 Drejtoria e Ujësjellës - Kanalizimeve**

Detyrat e Drejtorisë se Ujësjellës fushën e emergjencave civile, bazohet në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera të fushës se veprimtarisë se kësaj drejtorie si:

Ligji nr. 8093 datë 21.04.1996 “Për rezervat ujore”;

Ligji nr. 8030 datë 15. 11. 1995 “Për programet sociale për strehimin e banoreve te zonave urbane”;

Ligji nr. 8934 datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ligji nr. 9010 datë 11.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”

Ligji nr. 8094 datë 21.4.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”

Ligji nr. 8408 datë 25.9.1998 “Për policinë e ndërtimit”

Ligji nr. 7893 datë 22.12.1994 “Për shkencat dhe zhvillimin teknologjik”

#### **Drejtoria e Ujësjellës kanalizimeve:**

- Siguron mbështetjen dhe organizon Vlerësimin e dëmeve dhe të qëndrueshmërinë në objektet e banimit, në ujësjellës dhe kanalizime dhe në objekte publike.
- Siguron mbështetjen për garantimin e fuqizimit me ujë të pijshëm dhe cilësinë e tij.
- Planifikon riaftësimin e këtyre objekteve në zonat e dëmtuara

- Miraton planet për ndërtimet me karakter të përkohshëm. Këshillon dhe jep ndihmën e sajë në menaxhimin e mbetjeve urbane në raste të emergjencave civile.
  - Siguron informacion dhe mbështetje për turistet dhe zonat turistike gjatë situatës emergjente.
  - Bashkëpunon për sigurimin e sipërfaqeve të nevojshme për varrosjen e viktimave
- Për realizimin e detyrave, Drejtoria e Ujësjetës kanalizimeve bashkëpunon me: Drejtorin e Shërbimit Parësor, për trajtimin dhe Vlerësimin e ujit të pijshëm dhe trajtimin e viktimave.
- Inspektoratin e Mjedisit, për ndotjen e mjedisit nga mbetjet urbane, materialet inerte dhe përcaktimin e territoreve ku ato do të evadohen.

### **13.10 Drejtoria Rajonale e Arsimit + Universiteti “Ismail Qemali”**

Funksionet e Drejtorisë Rajonale të Arsimit dhe të Universitetit “Ismail Qemali”, bazohet në ligjin nr. 8756 datë 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore.

- Ligji nr. 8872, dt. 29. 04. 2002, “Për arsimin dhe formimin Professional në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 8461, dt. 251 1. 1999, ”Për arsimin e larte në republikën e Shqipërisë”

#### **Drejtoria Arsimore +Universiteti:**

- Angazhohet në përgjigjen ndaj emergjencave, si strukture mbështetëse. Harton dhe zbaton programet e edukimit, të trajnimit të dhe planet e gatishmërisë dhe vepron në bazë të tyre në situatat e emergjencave civile.

Por në të gjitha rastet strukturat shkollore të Ministrisë se Arsimit dhe Shkencës përbëjnë një precedent për t’u dëmtuar nga fatkeqësi masive dhe me pasoja tepër të rënda.

- Në bashkëpunim me Institucionet shëndetësore dhe repartet Ushtarake në qark, ndihmojnë në dhënien e ndihmës se parë mjekësore nëpërmjet *angazhimit të* institucioneve shkollore dhe universitare.

- Në bashkëpunim me Repartet Ushtarake Drejtorinë e policisë dhe institucionet Shëndetësore, biznesit privat bashkëpunon për organizimin dhe përkujdesjen për nxënësit dhe studentet gjatë operacioneve të transportit dhe të evakuimit të tyre. Me QQV dhe Degën e KKSJ bën regjistrimin e nxënësve dhe të studenteve të evokuar dhe dërgimin e tyre pranë familjeve.

- Bashkëpunon me DSHP, dhe Drejtoritë e Spitaleve, për dhënien e ndihmës se pare, për transportimin në mjedise spitalore, për krijimin e kushteve higjienosanitare të përshtatshme për persona të strehuar në mjedise shkollore /konvikte, si dhe angazhimin e grupeve të studenteve në shërbim të kujdesit shëndetësor.

- Bashkëpunon me Prefektin e Qarkut dhe organet e qeverisjes vendore, angazhon stafet pedagogjike të specializuara, studentet dhe nxënësit e viteve të larta në detyrat vlerësuese, pune publike si dhe në teste lidhur me nevojat për përballimin e emergjencave civile.

- Në bashkëpunim me Organet e Qeverisjes vendore punon për sigurimin e fondeve për riparimin e godinave shkollore, si dhe programimin e vazhdimin të mësimin në mjedise të tjera.

### **13.11 Drejtoria Rajonale e Punësimit + Drejtoria e Përkrahjes Sociale**

Funksionet e Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe Drejtorinë e Përkrahjes Sociale, bazohen në detyrat e Ligjit nr. 8756 datë 26.4.2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore si:

Ligj i nr. 69 datë 11.2. 1999 “Për programin e nxitjes se punësimit të punëkërkuesve të papune”

Ligji nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”

Ligji nr. 7995 datë 20. 9. 1995 “Për nxitjen e punësimit”

Drejtoria Rajonale e Punësimit + Drejtoria e Përkrahjes Sociale:

- Sigurojnë trajtim financiar për punësim, përkrahje dhe përkujdesje shoqërore për shtetas qe, si pasoje e emergjencës civile, masivishtë humbasin strehimin, vendin e punës.
- Ndhmon në dhënien e ndihmës se pare të dëmtuarve në objektet e vartësisë.
- Ndhmon në evakuimin e personave nga qendrat e përkujdesjes dhe shtëpitë e fëmijëve dhe krijimin e kushteve higjienosanitare në strehimet e përkohshme.
- Ndhmon në strehimin e përkohshëm të këtyre personave dhe përkujdesjen e mëtejshme të tyre
- Mbështet fillimin e operacioneve të kërkim- shtimit për persona të mbetur nën rrënoja, të humbur dhe të zhdukur.
- Benë evidentimin, organizimin dhe përfshirjen e grupeve të personave si të papune në pune publike gjatë gjendjes se emergjencave civile dhe sigurimin e financimit të tyre
- Siguron asistence sociale për persona të traumatizuar.
- Bën nxitjen e programeve të zhvillim për biznesin.
- Angazhon OJIF- te në dhënien e ndihme në zonat e dëmtuara.
- Ve në dispozicion listën e grupeve/personave të paracaktuar në pune publike dhe specialitete të ndryshme dhe se bashku me OQV përkujdeset për regjistrimin dhe trajtimin e personave që do të strehohen në familje të tjera.

### **13.12 Drejtoria Rajonale e Doganave dhe Drejtoria tatimeve**

Detyrimet e Drejtorisë se doganave dhe të tatimeve bazohen në detyrat e ligjit 8756 datë 26.4.2001 “Për emergjencat civile” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore:

Kodi doganor i Republikës se Shqipërisë, Ligji Nr 8449 datë 27. 01. 1999. Ligji nr 8017 datë 25/10/1995 “Për falimentimin”

Ligji nr 8081 datë 07. 04. 1996 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe te risigurimit”

Ligji organik i buxhetit Nr 8379, datë 29. 7. 1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në RSH”;

Ligji për procedurat tatimore nr 8560 datë 22. 12. 1999

Ligji Nr. 7928 datë 27. 04. 1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”

Ligji Nr. 7979, dt. 26. 7. 1995, “Për fondet e investimeve”

Ligji Nr. 8210, dt. 24. 04. 1997, “Për përjashtimin nga taksat dhe tatimet të ndihmave humanitare dhe të emergjencës”

Ligji nr. 8873 datë 29. 04. 2002 “Për sigurimin e depozitave”.

### **13.13 Drejtoria e Tatimeve + Dogana përgjigjen për:**

Parandalimin e importit, eksportimin, tranzitimin, depozitimin, prodhimin, tregtimin e materialeve dhe mallrave të ndaluara.

Krijimin e kushteve dhe për lehtësimin dhe përsheptimin e procedurave dhe regjimeve doganore për mallrat, materiale dhe grupeve dhe individë, si dhe pajisjeve të tyre, kur vërtetohet se ardhja e tyre është në funksion të përballimit të emergjencave civile.

Favorizimin dhe mbështetjen e krijimit dhe përdorimit me efikasitet të bazës se duhur materiale për raste e emergjencave civile, nëpërmjet heqjes se lehtësimit të procedurave doganore dhe tatimet.

### **13.14 Drejtoria e Monumenteve te Kulturës**

Detyrimet Ligjore:

Ligji Nr. 8756, dt. 26. 4. 2001 “Për emergjencat civile” si dhe Ligji nr. 9048, dt. 7. 4. 2003 “Për trashëgiminë kulturore”.

Në rastet e emergjencave civile angazhohet ne:

- Parandalimin, lehtësimin, përgjigjen dhe riaftësimin e objekteve kulturore, bibliotekave, si dhe ruajtjen e vlerave të monumenteve të kulturës të prekura nga emergjenca.
- Merr masat e nevojshme dhe përcakton standardet dhe normat për ndërtimin dhe pajisjen e objekteve me sistemet e mbrojtjes nga fatkeqësitë
- Gjatë emergjencave civile në bashkëveprim me strukturat aktive vepruese, në qark dhe organet e qeverisjes vendore organizon evakuimin, sistemimin dhe ruajtjen e materialeve të rëndësishme nga institucionet e saj të vlerave kulturore dhe objekteve monumentale, ruajtjen e objekteve muzeale.
- Organizmin e aktiviteteve për largimin e stresit të shtetasve të dëmtuar
- Pas mbarimit të emergjencës, merr masa për rindërtimin e objekteve socialkulturore.

### **13.15 Dhoma e Tregtisë**

Në situata të emergjencave civile angazhohet ne:

- Evidentimin Kompanive private dhe të burimeve të tyre njerëzore e materiale që mund të vihen në dispozicion për përballimin e emergjencës civile.
- Në bashkëpunimin me Prefektin dhe OQV për përcaktimin e nevojave parësore për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar dhe përfshirjen e tyre në programet e emergjente të riaftësimin.

### **13.16 Dega Kryqit të Kuq Shqiptar**

Veprimtaria e Dega e KKSJ bazohet nr. Ligjin nr. 7894, dt. 29. 9. 1994, “Për Kryqin e Kuq Shqiptar” dhe në akt marrëveshjen e kësaj dege me Prefektin e Qarkut Vlorë të Korrikut 2004. Në raste të emergjencave, Dega e KKSJ:

- Bashkërendon aktivitetin për parandalimin, lehtësimin dhe përgjigjen ndaj emergjencave me Prefektin dhe OQV.
- Bashkëpunon me MZSH, Drejtorinë e Policisë të Qarkut dhe DSHP për të dhënat për aksidentet dhe jep kurset e ndihmës së parë, në përbërje të kurseve të licencimit për drejtimin e automjeteve.
- Ngre qendra informacioni, vlerësimi dëmsh, dhe nevojash, jep ndihmën e parë dhe asistencë psikologjike, shpërndan ndihma dhe siguron kushte për jetese, gjen persona të humbur. Atje ku është e nevojshme, bën aktivitete me komunitetin në fushën e edukimit, të informimit, të këshillimit për lloje të ndryshme emergjencash e sidomos për çështjet shëndetësore dhe të mjedisit.
- Mbi bazën e nevojave në ushqime, veshmbathje e materiale fjetje, që paraqiten nga OQV, kërkohet mbështetje nga KKSJ.

## **14. STRUKTURAT E GADISHMERISE DHE SKEMAT E GRUMBULLIMIT TE INFORMACIONIT DHE LAJMERIMIT NË RASTET E EMERGJENCAVE CIVILE**

14.1 Organizimi dhe funksionimi i strukturave të gatishmërisë për emergjencat

Strukturat e gatishmërisë për emergjencat janë strukturat monitoruese, informuese dhe reaguese të cilat kanë shërbim 24 orësh ose mund të jenë të disponueshëm në çdo kohe.

Këto struktura me informacionet që japin, njoftimin e parë që bëjnë si dhe reagimin e shpejte në aktivizimin e sistemit bëjnë të mundur Vlerësimin e situatës dhe ndërhyrjen e shpejte të strukturave të tjera.



Shërbimi i këtyre strukturave është mjaft i vlershëm jo vetëm në fazën e paralajmërimit por edhe atë të reagimit për arsye se një pjese e tyre kanë mjetet dhe kapacitete për të vepruar dhe ndërhyre në një kohë të shkurtër dhe në fazën e reagimit.

Informacionit në Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile Rajonale (QOREC) nuk do të thotë që strukturat përkatëse nuk komunikojnë me instancat e tyre eprore por pre shkak se në emergjence kërkohet kontributi i shume strukturave është e nevojshëm që të informacioni të shkojë në qendrën e koordinimit të këtyre strukturave.

#### **14.2 Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të gatishmërisë për emergjencat**

Repartet ushtarake, Drejtoria e policisë së qarkut, urgjenca mjekësore, MZSH dhe forca të tjera operacionale:

- Në përputhje me misionin dhe detyrat e tyre në rajonin e dislokimit dhe te veprimin, në momentin që marrin informacion rreth një ngjarje e cila ka sjelle një situatë emergjence civile ose bëhet shkak për një ngjarje të tillë, vendoset në gjendje gatishmërie.
- Në vartësi të nivelit të situatës dhe llojit të emergjencës, ato mund të filloj veprimet e tyre në bazë të kërkesë se Prefektit të Qarkut dhe të urdhëruara nga strukturat e tyre drejtuese në vartësi të te cilave janë. Informacioni i dhënë nga QOQ pranë strukturave të gatishmërisë, duhet vlerësuar prej tyre duke marrë masa për hapat e mëtejshme.
- Kur këto struktura përfshihen në përballimin e situatave te emergjencës, ato vendosin, mbajnë kontakte dhe shkëmbejnë informacione me komandat dhe strukturat e tyre përkatëse, si dhe me QKOE- e, e cila, nga ana e sajë, gjithashtu bashkërendon veprimet me strukturat e tjera dhe OQV.

Strukturat monitoruese dhe njoftuese; stacioni meteorologjik, inspektoratit veterinar, inspektoratit të ushqimit, shërbimi gjeologjik, inspektorati i karburanteve, enët nën presion: Së bashku dhe me zyrën e emergjencave civile të Prefektit të qarkut dhe inspektoratit të emergjencave civile të OQV, marrin dhe japin informacion për QKOE në rreth rreziqeve apo

kërcënimeve të mundshëm edhe, në raste të një emergjence, bashkërendojnë aktivitetet për vlerësimin e situatës dhe të nevojave. Sigurojnë informacion të vazhdueshme dhe bashkëpunojnë me strukturat e tjera të emergjencave civile, bëjnë analiza dhe monitorim të situatës në progres dhe japin informacion të freskët institutit të Sizmologjisë, Hidrometeorologjisë, Fizikës Bërthamore etj, nëpërmjet sistemit të tyre japin dhe marrin informacion për rreziqet ose kërcënimet e mundshme në QKOE dhe kur ndodh ngjarja koordinojnë për vlerësimin e gjendjes dhe nevojave japin informacion të vazhdueshëm si dhe bashkëpunojnë me strukturat e emergjencave civile në nivel vendor, për Vlerësimin e gjendjes dhe informimin periodik të tyre.

Strukturat e gatishmërisë të furnizimit me ujë të pijshëm, telekomunikimit dhe të energjisë elektrike:

- Mbajnë kontakte të vazhdueshme me QOQ për emergjencat civile japin informacione për ngjarje emergjente që kanë ndodhur ose mund të ndodhin në fushat e tyre të veprimin. Gjithashtu kërkojnë prej atyre asistencë për përfshirjen e strukturave të tjera rajonale e lokale të cilat veprojnë në rajonet e tyre, për menaxhimin e situatave emergjente.
  - Strukturat e disponueshme dhe në kontakt 24 ore, janë personeli i strukturës së Sistemit në nivel Qarku të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile si dhe ai i MZSH. Ky personel mban kontakte me strukturat e gatishmërisë për emergjencat si dhe këshillon drejtuesit e niveleve të ndryshme për masat dhe veprimet që duhen ndërmarre.
- Për emergjencat civile me poshtë shpjegohet me skeme mënyrat e grumbullimit dhe shpërndarjes së informacionit. Zyra e emergjencave civile dhe të gjitha strukturat që lidhën

me emergjencat civile hartojnë skema dhe tabela me pikat e kontaktit të strukturave për emergjenca të ndryshme dhe i freskojnë ato në mënyrë periodike.

## **15. STRUKTURAT BAZË OPERATIVE NE NIVEL QARKU MONITORUESE, VEPRUESE AKTIVE, VEPRUESE MBESHTETESE**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 531, dt. 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencës civile” në Qarkun Vlorë, pranë Institucionit të Prefektit organizohet shërbimi i emergjencave civile në nivel qarku. Shërbimi i emergjencave civile për Qarkun Vlorë përbëhet nga këto struktura:

### **a) Struktura monitoruese e njoftuese**

- Sektori i emergjencave në administratën e Prefektit.
- Inspektoret e emergjencave në rrethet Sarandë e Delvinë
- Drejtorët/përgjegjësit e emergjencave civile në bashki
- Stacioni i hidrometeorologjisë
- Stacioni sizmologjik
- DBU
- Agjencia e Mbrojtjes së Bregdetit
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit
- Drejtoria e Shëndetit Publik
- Shërbimi gjeologjik

### **b) Struktura vepruese aktive**

- Reparti Ushtarak Nr. 2240 (D2D) Vlorë
- Reparti Ushtarak Nr. 5510 Gjirokastër
- Rep. Usht. 5010 Bunavi Vlorë
- Drejtoria e Policisë të Qarkut Vlorë
- Reparti Antitrafik “Delta Forca” Vlorë
- Shërbimet e MZSH në bashkitë e Qarkun Vlorë
- Stacioni zjarrfikës të Portit Vlorë
- Shërbimi i urgjencës mjekësore Vlorë, Sarandë dhe Delvinë.
- Drejtoritë e Shëndetit Publik Vlorë, Sarandë dhe Delvinë
- Policia Elektrike Rajonale Vlorë
- Skuadrat e likuidimit të avarisë të rrjetit elektrik

### **c) Struktura vepruese mbështetëse.**

- Drejtoria Rajonale e Arsimimit, Universitet “I Qemali”
- Rezervat e Shtetit Vlorë
- Shërbimi Pyjor në Bashkitë e Qarkut Vlorë
- Ndërmarrjet e Mirëmbajtjes të Rrugëve urbanë Vlorë, Sarandë
- Ndërmarrjet Rajonale të Rrugëve Nacionale Vlorë e Sarandë
- Policia Ndërtimore e Qarkut Vlorë
- Grupet e avarive të Telekomit Vlorë, Sarandë e Delvinë
- Policia Tatimore Vlorë, Sarandë e Delvinë
- Policia Doganore Vlorë e Sarandë
- Kryqi i Kuq Shqiptar me degët në Vlorë e Sarandë

## KËRKËSË

Nr. 1

Urgjent

Për: z./znj. \_\_\_\_\_  
Kryeministër/Ministër i Mbrojtjes i RSh  
Tiranë

Nga: \_\_\_\_\_

z.znj. Kryeministër/Ministër

Më datën \_\_\_\_\_, në Bashkinë \_\_\_\_\_, e Qarkut Vlorë, në zonën \_\_\_\_\_, deri në zonën, \_\_\_\_\_, si pasojë e reshjeve intensive të rëna nga data \_\_\_\_\_ deri në datën \_\_\_\_\_, është përmbytur një territor i konsiderueshëm sipërfaqeje toke bujqësore si dhe fshatrat;

\_\_\_\_\_  
Niveli i ujit është arritur deri \_\_\_\_\_ m

Nisur nga vështirësitë e konsiderueshme nga grupi i vlerësimit, i ngritur me urdhër të \_\_\_\_\_, nga vazhdimi i pa ndërprerë i reshjeve dhe në këto çaste si dhe nga parashikimi i motit për ditët në vazhdim, gjendja e konstatuar konsiderohet tepër e vështirë, sipër banorët, gjënë e gjallë, të mbjellat si dhe bizneset që kryejnë aktivitetet në këtë zonë.

Grupi i vlerësimit i ngarkuar për këtë qëllim konstaton se:

Rrezik emergjent paraqet zona e fshatrave \_\_\_\_\_, banorët e të cilëve kërkohet të evakohen jo më vonë se 12 orët e ardhshme.

Numri i banorëve në këtë zonë me rrezik \_\_\_\_\_ banorë.

Numri i bagëtive në këtë zonë \_\_\_\_\_, bagëti (të imta dhe të trasha)

Kemi vendosur vendin e të evokuarve, por në pa mundësi të mjeteve të posaçme të përshtatshme për ndërhyrje në këtë zonat e përmbytura dhe mjediseve të përshtatshme për strehim kërkohet:

Ndërhyrje me forca, mjetë, personel mjekësor si dhe për strehim të përkohshëm për rreth \_\_\_\_\_, njerëz. Efektiviteti dhe mjetet e ndërhyrjes llogariten në bazë të numrit të banorëve dhe bagëtive të evidentuara më sipër.

Jemi në pritje të ardhjes sa më shpejt të forcave dhe mjeteve të kërkuara.

Numri i kontaktit \_\_\_\_\_

Më poshtë po ju paraqesim disa të dhëna dhe kërkesa të detajuara rreth zonës së përmbytur.

**Raporti i njoftimit të parë  
FORMULARI I**

**NJOFTIMI I PARË  
PËR KONSTATIMIN E FATËKEQËSIVE**

Karakteri i njoftimit

**URGJENT**

Nr. i qendrës operacionale \_\_\_\_\_

Koha e plotësimit të formularit: Në çastin që njoftoni apo konstatooni ndodhjen e një fatkeqësie.

Qëllimi: Verifikimi i njoftimit, karakteri dhe lloji i fatkeqësisë, përmasat si dhe ndikimet e saj.

Plotësohet nga: Persona përgjegjës, bazuar në vëzhgimin personal apo marrjes dijeni nga persona të përgjegjshëm.

Lloji i fatkeqësisë konstatuar / njoftuar:

Tërmet  Përmytje  Zjarr në banesa

Shkat. dige  Rrëshqitje masive  Aksidente

Zjarr në pyje  Bllokime nga bora  Të tjera \_\_\_\_\_

Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora \_\_\_\_\_ data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Në territorin e \_\_\_\_\_

(Qarku, Bashkia), fshati \_\_\_\_\_

Cili është burimi i informacionit \_\_\_\_\_

Ka njoftim për viktime të plagosur të humbur? PO  JO

Keni informacion për dëme materiale/Infrastrukturë PO  JO

Kërkohe ndihmë urgjente e specializuar PO  JO

Keni njoftuar eprorin tuaj PO  JO

Koha e plotësimit të formularit: Ora \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_

Personi informues: \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_ (institucioni)

Vendndodhja e institucionit, qarku \_\_\_\_\_, rrethi \_\_\_\_\_ bashkia \_\_\_\_\_ fshati \_\_\_\_\_

Numri i ndodhjes së telefonit tuaj apo mënyrë tjetër komunikimi \_\_\_\_\_

Njoftuesi \_\_\_\_\_

## Raporti i të dhënave të para për fatëkeqësinë

Karakteri i njoftimit

### I RËNDËSISË SË VEÇANTË

Rëndësia e plotësimit të formularit: bëhet përcaktues për njohjen e më në detaje të llojit të fatkeqësisë dhe shërben për marrjen masave urgjente, apo për plotësimin e kushteve për shpalljen e gjendjes së emergjencave civile.

Koha e plotësimit: jo më vonë se 24 orë nga çasti i ndodhjes së fatkeqësisë.

Vëmendja kryesore: Vërtetësia e informacionit të parë për ndodhjen e fatkeqësisë, vendndodhjen e saktë të saj, shtrirjen territoriale, si dhe pasojat.

Lloji i fatkeqësisë së konstatuar:

Tërmet	<input type="checkbox"/>	Përmytje	<input type="checkbox"/>	Zjarr në banesa	<input type="checkbox"/>
Shkat. dige	<input type="checkbox"/>	Rrëshqitje masive	<input type="checkbox"/>	Aksidente	<input type="checkbox"/>
Zjarr në pyje	<input type="checkbox"/>	Blokime nga bora	<input type="checkbox"/>	Të tjera _____	<input type="checkbox"/>

Koha e ndodhjes së fatkeqësisë: ora \_\_\_\_\_ data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Në territorin e \_\_\_\_\_ -  
(*Qarku, Bashkia, fshati*)

Cili është burimi i informacionit \_\_\_\_\_

Saktësia e informacionit \_\_\_\_\_ (i saktë, ndoshta i saktë, i dyshimtë)

Cilat janë aktivitetet e ndërmarra nga strukturat lokale deri në çastin e raportimit?

Dëmtime në njerëz:

Numri i viktimave: i vërtetuar \_\_\_\_\_ i pavërtetuar \_\_\_\_\_

Numri i të zhdukurve: i vërtetuar \_\_\_\_\_ i pavërtetuar \_\_\_\_\_

Numri i të plagosurve rëndë: i vërtetuar \_\_\_\_\_ i pavërtetuar \_\_\_\_\_

Dëmtime në objekte

Të shkatërruara:

Objekte banimi PO  JO

Shtëpi individuale PO  JO

Spitale PO  JO

Konvikte PO  JO

Të dëmtuara rëndë:

Objekte banimi PO  JO

Shtëpi individuale PO  JO

Spitale PO  JO

Konvikte PO  JO

Dëmtime në infrastrukturë

Rrjeti i furnizimit me ujë, \_\_\_\_\_ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta), me/ pa ndërprerja me ujë.

Rrjeti i furnizimit me energji: \_\_\_\_\_ (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta), me/ pa ndërprerja të furnizimit me energji elektrike.

Ura \_\_\_\_\_ në rrugë nacionale (shkatërruar, dëmtime të rënda, dëmtime të lehta) me pa ndërprerje të qarkullimit

Kërkohet ndihmë: \_\_\_\_\_ urgjente / e menjëhershme) në zonën e

Me / për \_\_\_\_\_

Shënime të veçanta

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Njoftimi bahet sot:, më ora \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_,

Nga \_\_\_\_\_, me detyrë \_\_\_\_\_

Vendndodhja institucionit, Qarku \_\_\_\_\_, rrethi \_\_\_\_\_ Bashkia \_\_\_\_\_ fshati \_\_\_\_\_

Numri i ndodhjes së telefonit tuaj apo mënyrë tjetër komunikimi \_\_\_\_\_

Informoi

(Firma, vula e institucionit)

\_\_\_\_\_

**Shtesa A**

**Shtabi i Emergjencave Civile dhe përkatësia institucionale**

(të dhëna të datës 18 dhjetor 2017)

<b>Detyra</b>	<b>Emri Mbiemri</b>	<b>Telefona</b>	<b>E-Mail</b>
<b>Pref. E Prefek. Së Qarkut Vlorë</b>	<b>Flamur Mamaj</b>	<b>0692084963</b>	
<b>Kr. Këshill. Qarkut Vlorë</b>	<b>Ervis Mocka</b>	<b>0693703636</b>	
<b>Kr. Bashkisë Vlorë</b>	<b>Dritan Leli</b>	<b>0692310023</b>	
